



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

MIRATOI
DREJTOR
EUGENA TOMINI



RREGULLORE E BRENDSHME PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ISHP

PËRMBAJTJA:

KREU I: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Objekti i Rregullores

Neni 2. Baza Ligjore

Neni 3. Etapat Historike

Neni 4. Misioni i ISHP

4.1. Përgjegjësitë e ISHP-së

Neni 5. Financimi i ISHP-së

Neni 6. Organigrama e ISHP-së

KREU II: FUNKSIONET E LARTA TË MENAXHIMIT

Neni 7. Drejtori i ISHP-së

7.1. Funksionet e Drejtorit

Neni 8. Asistenti i Drejtorit të Përgjithshëm

Neni 9. Zëvendëstitullarët (Teknik dhe Ekonomik)

9.1. Zëvendëstitullari Teknik

9.2. Zëvendëstitullari Ekonomik

Neni 10. Përgjegjësi i Njesisë Bazë (Departamentit)

Neni 11. Këshilli Drejtues i ISHP-së

Neni 12. Këshilli Shkencor i ISHP-së

Neni 13. Funksionet e ISHP-së

13.1. Veprimtari bazë të Shëndetit Publik

13.2. Paketa e Shëndetit Publik

13.3. Shërbimet bazë të Shëndetit Publik

KREU III: RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 14. Marrëdhënia e ISHP-së me Strukturat Rajonale të Shëndetit Publik

Neni 15. Koordinatori për të Drejtën e Informimit

Neni 16. Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve

Neni 17. Mbrojtja e të Dhënave Personale

Neni 18. Parandalimi i Konfliktit të Interesave

Neni 19. Koordinator i Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit

Neni 20. Dhënia e Masave Disiplinore

KREU IV: ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I NJËSIVE PËRBËRËSE TË ISHP

Përshkrimet e Punës

Neni 21. Njësia Bazë (Departamenti) i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive

22.1. Sektori i Survejancës dhe Shërbimit të Inteligjencës Epidemike

21.2. Sektori i Programit Kombëtar të Vaksinimit

21.3. Sektori i Programit Kombëtar të Kontrollit të HIV/AIDS/SST

21.4. Sektori i Programit Kombëtar të Kontrollit të Turbekulozit

21.5. Sektori i Programit të Kontrollit të Infeksioneve Spitalore

21.6. Sektori i Kontrollit të Vektorëve

21.7. Sektori i Survejancës Laboratorike të Sëmundjeve Emergjente Virale

Neni 22. Njësia Bazë (Departamenti) i Laboratorëve të Referencës Kombëtare

22.1. Sektori i Laboratorëve të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive

22.2. Sektori i Laboratorëve të Referencës Kombëtare të Shëndetit dhe Mjedisit

22.3. Sektori i Vivarium

Neni 23. Njësia Bazë (Departamenti) i Vlerësimit dhe Trajtimit të Risqeve të Shëndetit Publik

23.1. Sektori i Ujit dhe Sanitetit

23.2. Sektori i Epidemiologjisë Ambientale dhe Kontrollit të Cilësisë së Ajrit

23.3. Sektori i Fizikës Sanitare

23.4. Sektori i Shëndetit në Punë dhe Toksikologjisë

23.5. Sektori i Sigurisë Ushqimore

Neni 24. Njësia Bazë (Departamenti) i Përformancës së Shëndetit Publik dhe Sëmundjeve Kronike

24.1. Sektori i Sëmundjeve Kronike

24.2. Sektori i Sistemeve Shëndetësore

24.3. Sektori i Monitorimit dhe Vlerësimit të Shëndetit Publik

24.4. Sektori i Sistemit të Integruar të Informacionit Shëndetësor dhe Funksionalitetit të Sistemit

24.5. Sektori i Promocionit/Ndërgjegjësimit Shëndetësor

Neni 25. Drejtoria (Zyra) e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Neni 26. Zyra e Sistemit Kombëtar të të Dhënave për Drogën

KREU V: ADMINISTRATA E ISHP

Neni 27. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

27.1. Sektori i Administratës

27.2. Sektori i Burimeve Njerëzore

Neni 28. Drejtoria e Financave

28.1. Sektori i Buxhetit dhe Financës

28.2. Sektori i Prokurimeve dhe Çështjeve Juridike

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK.

KREU I: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i Rregullores

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe detyrave të hollësishme të organizimit, mbarëvajtjes dhe marrëdhënieve ndërmjet niveleve të ndryshme të Njësive Bazë (Departamenteve) dhe Administratës së Institutit të Shëndetit Publik, gjatë veprimtarisë së tyre për rritjen e efikasitetit dhe eficiencës në përmbushje të funksioneve dhe kompetencave të saj, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Baza Ligjore

Instituti i Shëndetit Publik organizohet dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr.10 138, date 11.5.2009, "Për Shëndetin Publik", Ligjit 15/2016 "Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", Ligji nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr.327 dt.28.05.2014 "Për përcaktimin e formatit dhe mënyrës së mbledhjes së informacionit shëndetsor" si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 3

Etapat Historike

- 1934: Laboratori Bakteriologjik i Shtetit (LBSh)** (vendosje në ndërtesën aktuale të Fakultetit të Mjekësisë)
- 1946: LBSh emërtohet Laboratori i Bakteriologjisë Humane (LBH)** (vendosje në ndërtesën aktuale të Fakultetit të Mjekësisë, kati i dytë, së bashku me Laboratorin e Bakteriologjisë Veterinare, kati i parë).
- 1952: Mbi bazën e LBH krijohet Laboratori Qendror i Mikrobiologjisë Mjekësore (LQMM)** (vendosje në ndërtesën aktuale të Drejtorisë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" [QSUT]).
- 1954: Krijohet Laboratori Qendror i Higjienës Mjekësore** (vendosje në të njëjtën ndërtesë të LQMM).
- 1969: Mbi bazën e bashkimit të LQMM dhe LQMH krijohet Instituti i Higjienës dhe Epidemiologjisë (IHE)** (ndërtesa aktuale me anekset përkatëse të ISHP-së).

1983: IHE emërtohet Instituti Kërkimor i Higjienës e Epidemiologjisë dhe Prodhimeve Immunobiologjike (IKHEPI) për të përligjur “*de jure*” tiparin thelbësor kërkimor-shkencor të Institutit (VKM Nr. 152, datë 15.04.1983).

1994: IKHEPI, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.313, datë 19.06.1995, transformohet në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), që thelbësisht përmban jo thjesht ndryshim emri, por ndryshim tërësor të vizionit-misionit-strukturës së Institutit, duke pasur krahas tiparit kërkimor-shkencor edhe atë universitar.

Me VKM Nr.178, datë 30.03.2001, Qendra Kombëtare e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit bashkohet me Institutin e Shëndetit Publik.

Neni 4

Misioni i ISHP

ISHP-ja ka detyrë të mbrojë shëndetin e popullatës duke udhëhequr kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve, studimin e efekteve të mjedisit në shëndetin e komuniteteve nëpërmjet:

- (i) Veprimtarisë së gjerë kërkimore e shkencore dhe studimeve në fushën e epidemiologjisë, imunologjisë, mikrobiologjisë, mjedisit, promocionit të shëndetit, ekspertizës etj., për të ofruar zgjidhje inovative të problemeve shëndetësore dhe për ndërtimin e strategjive efektive për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve.
- (ii) Survejancave të sëmundjeve dhe monitorimit të gjendjes shëndetësore për të identifikuar, analizuar shkaqet dhe zgjidhur në kohë problemet dhe rreziqet për shëndetin e popullatës.
- (iii) Informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit për problemet shëndetësore dhe rrugët e zgjidhjes së tyre.
- (iv) Nxitjes dhe mbështetjes së projektligjeve, rregulloreve dhe standardeve të cilat synojnë mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë shëndetësore.
- (v) Sigurimit të edukimit të vazhdueshëm, kualifikimit dhe mbështetjes profesionale për specialistët që punojnë në fusha të ndryshme të shëndetit publik.
- (vi) Vlerësimit të efektivitetit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore duke synuar arritjen e standardeve bashkëkohore.
- (vii) Bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare analoge duke shkëmbyer përvojë të përparuar, si dhe duke specializuar e trajnuar specialistë në fusha të ndryshme të shëndetit publik.

4.1. Përgjegjësitë e ISHP-së

(neni 14, ligji nr.10138, datë 11.05.2009)

Instituti i Shëndetit Publik është përgjegjës për:

- Informimin, këshillimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në hartimin e politikave dhe strategjive në fushën e shëndetit publik.
- Sigurimin e udhëzimeve dhe ekspertizave në shëndet publik.
- Realizimin e vlerësimeve dhe studimeve të pavarura dhe prodhimin e informacioneve bazuar në fakte.

- Pjesëmarrjen në formimin e burimeve njerëzore në shëndet publik.
- Pjesëmarrjen në veprime të parandalimit të sëmundjeve në terren.
- Diagnozën e sëmundjeve emergjente, të rrezikshme.

Instituti i Shëndetit Publik mbështet Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, strukturat qendrore, rajonale dhe lokale të shëndetit publik për realizimin e funksioneve dhe shërbimeve të shëndetit publik.

Neni 5 Financimi i ISHP

Instituti i Shëndetit Publik organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit Nr.10 138, datë 11.5.2009, “Për Shëndetin Publik” dhe ligjit 15/2016 “Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”.

Organizimi, misioni, përgjegjësitë, funksionet dhe financimi i ISHP-së përcaktohen në ligjin Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”.

Instituti i Shëndetit Publik bazuar në nenin 16, Ligji Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”, financohet nga:

1. Buxheti i Shtetit
2. Të ardhura nga veprimtari shkencore apo edukative
3. Grante, fonde për veprimtari shkencore, programe zhvillimi
4. Donacione
5. Burime të tjera të ligjshme

Neni 6 Organigrama e ISHP

ISHP-ja funksionon në bazë të organikës dhe strukturës së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, (shih më poshtë Organigramën e ISHP-së).

ISHP ËSHTË ORGANIZUAR NË 4 (KATËR) NJËSI BAZË (DEPARTAMENTE):

- I. NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE INFEKTIVE
- II. NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I LABORATORËVE TË REFERENCËS KOMBËTARE.
- III. NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I VLERËSIMIT DHE TRAJTIMIT TË RISQEVË TË SHËNDETIT PUBLIK
- IV. NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I PERFORMANCËS SË SHËNDETIT PUBLIK DHE SËMUNDJEVE KRONIKE

ISHP-ja gjithashtu ka në përbërje të tij edhe:

- V. DREJTORIA E MBROJTJES NGA RREZATIMET**
- VI. ZYRËN E SISTEMIT KOMBËTAR TË TË DHËNAVE PËR DROGËN**
- VII. DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**
- VIII. DREJTORIA E FINANCAVE**

Secili departament drejtohet nga Përgjegjësi.

Secili departament është i përbërë nga sektorë në varësi të specifikës së vet edhe nga laboratorë. Në krye të sektorëve janë përgjegjësit përkatës; në krye të seksioneve, njërive, laboratorëve janë përgjegjësit përkatës.

Organigrama e ISHP-së jep skematikisht, në mënyrë të detajuar:

- Strukturën përbërëse të ISHP-së;
- Strukturën përbërëse të secilit Departament;
- Vartësitë hierarkike dhe ndërlidhjet organike dhe funksionale ndërmjet tërë pjesëve përbërëse të strukturës.
- Marrëdhëniet e punës për punonjësit e ISHP-së rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.
- Procedura e rekrutimit të stafit të ISHP-së përcaktohet sipas Udhëzimit të miratuar nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë me propozim të Drejtorit të ISHP-së.

Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) është institucion publik, buxhetor, në varësi administrative nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (neni 12, Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”).

Organet drejtuese të ISHP-së janë:

- **Drejtoria**
- **Këshilli Shkencor**
- 1. Veprimtaria dhe aktiviteti i përditshëm i ISHP-së drejtohet nga **Drejtori, Zëvendëstitullarët, përkatësisht dy Zëvendëstitullarë Teknik dhe një Zëvendëstitullar Ekonomik**, si dhe **Përgjegjësat e Departamenteve dhe Shefat e Sektorëve**.
- 2. Struktura organizative e ISHP-së përmban edhe Këshillin Drejtues në përbërje të saj. **Këshilli Drejtues i ISHP-së** është organ këshillimor i drejtorit të ISHP-së. Ai përbëhet nga tre Zëvendëstitullarët, përgjegjësit e Njësive Bazë, përgjegjësi i sektorit të Burimeve Njerëzore dhe përgjegjësi i sektorit të Administratës. Në mbledhjet e tij, Këshilli Drejtues shqyrton dhe diskuton mbi aktivitetin periodik të ISHP-së dhe problemet përkatëse të shtruara për zgjidhje.

KREU II: FUNKSIONET E LARTA TË MENAXHIMIT

Neni 7

DREJTORI I ISHP

Emërimi

1. Emërimi dhe lirimi i Drejtorit të ISHP-së bëhet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas akteve ligjore në fuqi.
2. Kriteret për emërimin e Drejtorit të ISHP-së janë në përputhshmëri të plotë me funksionet e ISHP-së të përcaktuara ligjërisht: *“Instituti i Shëndetit Publik është qendër e kërkimit shkencor në shëndet publik, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare e trajnimit në shëndet publik dhe qendër e informacionit në shëndet publik”* (neni 12, Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”). Kriteret minimale për emërimin e Drejtorit të ISHP-së janë:
 - (i) Të ketë të paktën Gradën Shkencore “Doktor” në mjekësi, (me përparësi prania e Titujve Shkencorë “Profesor” apo/dhe “Profesor i asociuar”,
 - (ii) Të ketë eksperiencë në aktivitetin shkencor, kërkimor dhe akademik në fusha të Shëndetit Publik duke patur publikime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare,
3. Të ketë aftësi dhe eksperiencë menaxheriale në fushën e kërkimit dhe zhvillimit shkencor dhe profesional dhe fusha të shëndetit publik.

7.1. Funksionet e Drejtorit

Drejtori i ISHP-së:

- Është titullari i ISHP-së.

- E ushtron veprimtarinë e tij konform ligjeve në fuqi, vendimeve të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe detyrave të përcaktuara nga kjo rregullore.
- Siguron realizimin e objektivave dhe detyrave profesionale dhe ekonomike dhe përgjigjet periodikisht para Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjithë veprimtarinë e ISHP-së.
- Organizon, bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e përgjithshme, shkencore, të edukimit dhe punës në terren të ISHP-së dhe e përfaqëson atë.
- Është kryetar i Këshillit Shkencor të ISHP-së.
- Është kryetar i Këshillit Drejtues të ISHP-së.
- Është personi zyrtar, i autorizuar i cili ushtron detyrën e tij drejtpërdrejt duke drejtuar e kontrolluar aktivitetin e ISHP-së, nëpërmjet aktiviteteve zbatuese e administrative, duke u dhënë detyra dhe udhëzime vartësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.
- Miraton politika, strategji, plane, programe dhe prioritet shëndetësorë të diskutuara në Këshillin Shkencor, në bazë të politikës dhe strategjisë kombëtare shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Menaxhon, mbikëqyr dhe koordinon shërbimet, departamentet, sektorët e ISHP-së.
- Miraton projektbuxhetin e përgatitur, e hartuar nga Drejtoria e Financës; ndarjen dhe destinacionin e fondeve buxhetore të financuara; mënyrat, format e evidentimit dhe kontrollit të administrimit të këtyre fondeve sipas legjislacionit në fuqi për buxhetin e shtetit dhe udhëzime të ndryshme në zbatim të tyre.
- Miraton dhe ndjek zbatimin mbi planet dhe programet për zhvillimin, kualifikimin, dhe administrimin e burimeve njerëzore në përputhje me politikat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Në përputhje dhe zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshme, të detyrueshme për zbatim.
- Miraton të gjitha programet dhe materialet e ISHP-së, që i paraqiten Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe organeve të tjera të larta shtetërore, si dhe institucioneve të tjera analoge vendase ose të huaja.
- Miraton planet e punës, objektivat dhe projektet e njësive bazë (Departamenteve) të ISHP-së.
- Miraton propozimet për lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e shëndetësisë, në përputhje me qëllimin dhe misionin e ISHP-së, si dhe përgjigjet për realizimin e detyrimeve kontraktore që rrjedhin prej tyre.
- Emëron dhe shkarkon punonjësit e ISHP-së, bazuar legjislacioni në fuqi . 4
- Miraton përbërjen e të gjitha komisioneve konsultative&ad hoc (të përkohshme) të ISHP-së.
- Mbikëqyr aktivitetin e burimeve njerëzore sipas legjislacionit në fuqi.
- Në përputhje me aktet ligjore, jep masa administrative dhe ndëshkuese ndaj punonjësve që shkelin disiplinën në punë.
- Kontrollon, ndan detyra dhe merr informacion lidhur me aktivitetin e ISHP-së nëpërmjet mbledhjeve periodike të Këshillit Drejtues, të përcaktuar në nenin 11

- Në rastet kur Drejtori largohet për punë jashtë shtetit ose merr lejen vjetore, ngarkon Zëvendëstitullarin Teknik/ekonomik si Zëvendës, për atë kohë sa do të zgjasë largimi i tij.

Neni 8

ASISTENT I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Mban evidencën e detyrave që merr prej Drejtorisë për punonjësit dhe ndjek përfundimin e dhënies së përgjigjes.

Mban protokollin në takimet që Drejtoria bën me Shefat e Departamenteve, ose me persona të tjerë.

Koordinon takimet e planifikuara për Drejtorinë dhe pret personat që kërkojnë takim me Titullarin (punonjësit e ISHP-së ose persona të jashtëm).

Evidenton problemet dhe detyrat kryesore të dala nga dosja e shqyrtuar nga Drejtori dhe i protokollon ato (ose i dërgon në zyrën e protokollit për shpërndarje).

Neni 9

ZËVENDËSTITULLARËT (TEKNIK DHE EKONOMIK)

9.1. ZËVENDËSTITULLAR TEKNIK

Emërimi dhe lirimi i zëvendëstitullarit teknik bëhet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të ISHP-së.

Kriteret për emërimin e Zëvendëstitullarit Teknik janë në përputhshmëri të plotë me funksionet e ISHP-së të përcaktuara ligjërisht: “*Instituti i Shëndetit Publik është qendër e kërkimit shkencor në shëndet publik, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare e trajnimit në shëndet publik dhe qendër e informacionit në shëndet publik*” (neni 12, Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”), dhe në legjislacionin në fuqi për pagat e Institutit të Shëndetit Publik.

Rrjedhimisht, kriteret minimale për emërimin e Zëvendëstitullarëve Teknikë të ISHP-së janë:

Zëvendëstitullar teknik

- Të ketë diplomë universitare si Mjek/Biolog/Kimist/Shëndet Publik, ku të paktën njëri nga Zëvendës titullarët duhet të jetë me studimet universitare Mjek. Eksperiencë në aktivitetin shkencor, kërkimor dhe akademik në fusha të Shëndetit Publik duke patur publikime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të ketë të paktën Gradën Shkencore “Doktor” ;
- Të ketë aftësi dhe eksperiencë menaxheriale në fushën e shëndetit publik;

Detyrat/funksionet e Zëvendëstitullarëve Teknik

I. Zëvendëstitullari Teknik:

- Planifikon aktivitetin shkencor të ISHP-së nëpërmjet bashkërendimit të punës ndërmjet departamenteve të ISHP-së, ushtron kontroll dhe kërkon llogari nga shefat përkatës dhe i ndihmon në zgjidhjen e problemeve ku nevojitet autoriteti i postit drejtues të tij.

- Mban përgjegjësi për mbarëvajtjen e punës dhe raporton para Drejtorit për departamentet që mbulon në lidhje me realizimin e detyrave të ngarkuara.
- Përgatit materialet shkencore që do të bëhen të njohura publikisht, sigurohet për saktësinë e informacioneve të nevojshme në masmedia lidhur me veprimtarinë e ISHP-së.
- Është përgjegjës për promovimin shkencor të stafit teknik të ISHP-së, në përputhje të plotë me objektivat teknike institucionale dhe dakordësi paraprake nga Përgjegjësit e Departamenteve.
- I propozon Titullarit kandidaturat për promovimin shkencor, duke paraqitur në bashkëpunim me sektorin e Burimeve Njerëzore dosjet e plotësuara të kandidatëve, sipas kriterëve të miratuara në Këshillin Shkencor.
- Propozon kalendarin vjetor të Konferencave, forumeve workshop-eve të ISHP-së.
- Asiston/ndihmon për përmbajtjen e Platformave elektronike, web, Facebook, Instagram etj., në bashkëpunim me Njësitë bazë (Departamentet).

Drejtori i ISHP-së i delegon Zëvendëstitullarëve Teknikë edhe detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit.

9.2. ZËVENDËSTITULLARI EKONOMIK

Emërimi dhe lirimi i zëvendëstitullarit ekonomik bëhet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të ISHP-së.

Kriteret minimale për emërimin e Zëvendëstitullarëve Teknikë të ISHP-së janë:

- (i) Të ketë diplomë universitare të nivelit "Mastër shkencor" në shkenca ekonomike.

Zëvendëstitullari Ekonomik ka për detyrë:

- Të mbështesë Drejtorin e ISHP-së dhe Njësitë bazë përkatëse për strategjitë institucionale, në lidhje me vlerësimin e mundësive financiare dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare.
- Të funksionojë si anëtar i ekipit të menaxhimit, nëpërmjet pjesëmarrjes në diskutime dhe kontributit krijues në proceset e menaxhimit dhe kryesisht në mbështetjen e ofruar për Njësitë bazë brenda ISHP-së.
- Të asistojë dhe të administrojë fondet buxhetore së bashku me Drejtorin e Financave, bazuar në analizën e nevojave të departamenteve të institutit.
- Të drejtojë procesin e hartimit të buxhetit vjetor për ISHP-në, në bashkëpunimin me Drejtorin e financave dhe të mbështesë Drejtorin e ISHP-së në argumentimin e tij pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke ndjekur në vazhdimësi realizimin e tij.
- Të përgatisë raporte për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë etj., dhe të garantojë përputhshmëri me ligjshmërinë financiare.
- Të drejtojë procesin e analizës financiare vjetore në bashkëpunim me drejtorinë e financave, duke garantuar saktësinë e të dhënave financiare dhe rregullimet në buxhetin e vitit, duke hartuar raporte financiare.
- Të mbështesë Drejtorin në menaxhimin e burimeve financiare (fondet e buxhetit të shtetit dhe donatorëve), sipas legjislacionit në fuqi.

Drejtori i ISHP-së i delegon Zëvendëstitullarit Ekonomik edhe detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit.

Neni 10

PËRGJEGJËSI I NJËSISË BAZË (NJËSISË BAZË DEPARTAMENTIT)

Përgjegjësi i Njesisë Bazë (Departamentit) emërohet nga Drejtori i ISHP-së.

Kriteret për emërimin e Përgjegjësit të Njesisë Bazë (Departamentit) të ISHP-së janë në përputhshmëri të plotë me funksionet e ISHP-së të përcaktuara ligjërisht: *"Instituti i Shëndetit Publik është qendër e kërkimit shkencor në shëndet publik, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare e trajnimit në shëndet publik dhe qendër e informacionit në shëndet publik"* (neni 12, Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik") dhe në legjislacionin në fuqi për pagat e Institutit të Shëndetit Publik. Rrjedhimisht, kriteret për emërimin e të ISHP-së janë:

- (i) Të ketë diplomë universitare në degët Mjekësi/Biologji/Kimi;
- (ii) Specializim apo kërkime pas universitare në fusha të shëndetit publik;
- (iii) Të ketë të paktën Gradë Shkencore "Doktor";
- (iv) Eksperiencë në aktivitetin shkencor dhe akademik në fusha të Shëndetit Publik;

Detyrat/Funksionet e Përgjegjësit të Njesisë Bazë (Departamentit):

- (i) Është përgjegjës për sigurimin e normalitetit të aktivitetit të proceseve administrative/menaxheriale dhe studimore.kërkimore të njesisë bazë përkatës. Ai është epror i drejtpërdrejtë për punonjësit e Njesisë bazë (Departamentit)
- (ii) Është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e vizionit, misionit, strategjisë dhe objektivave të Njesisë bazë (Departamentit) dhe sektorëve që drejton.
- (iii) Drejton dhe kontrollon në vazhdimësi zbatimin e detyrave të Njesisë bazë (Departamentit) konform planit strategjik-operacional afatshkurtër e afatmesëm, të hartura nën drejtimin e tij në bazë të vizionit, misionit, strategjisë dhe objektivave të Njesisë bazë (Departamentit) dhe të miratuar nga Drejtori. Ai mund t'ia delegojë kompetencat e veta shëfave të Sektorëve, , Laboratorëve, apo specialistëve të caktuar për plotësimin e detyrave funksionale.
- (iv) Vlerëson planet e punës kërkimore-shkencore të Njesisë bazë (Departamentit) në bazë të planeve të paraqitura nga vartësit e tij në përputhje me vizionin/misionin dhe strategjinë/objektivat, duke bashkërenduar planifikimin e punës edhe në bashkëpunim me atë të njësive bazë (departamenteve) sektorëve të tjerë të ISHP-së. Planet e punës i dorëzohen Drejtorisë së ISHP-së për miratim.
- (v) Siguron zbatimin në kohë dhe me cilësi të planeve të punës në Njësinë bazë (departament), duke mundësuar kushtet objektive për realizimin e tyre.
- (vi) Mban lidhje të drejtpërdrejta me Drejtorin e ISHP-së, merr prej tij urdhra dhe raporton për zbatimin e tyre.
- (vii) Merr detyra nga Drejtori i ISHP-së dhe ua përcakton e ndan ato për zbatim Sektorëve përkatës të Njesisë bazë (Departamentit)
- (viii) Përgjigjet për punën e vartësve të tij para Drejtorit të ISHP-së.

- (ix) Kujdeset për disiplinën e punës në departament dhe për mirëmbajtjen e bazës materiale ekzistuese.
- (x) Ai vetë ose dhe në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore, i bën Drejtorit të ISHP-së propozime me shkrim, për kriteret për emërim apo zëvendësime brenda për brenda Njesisë bazë (Departamenti), për masa ndëshkimore deri shkarkim të punonjësve me argumentimet përkatëse.
- (xi) Analizon në vazhdimësi veprimtarinë e Njesisë bazë (Departamentit) dhe vlerëson punën dhe edukimin e vazhduar të punonjësve të tij.
- (xii) Mban lidhje me të gjithë sektorët e shërbimit shëndetësor, arsimor, shoqatat e ndryshme, organet dhe institucionet e medias.
- (xiii) Organizon dhe drejton veprimtarinë për edukimin e vazhdueshëm profesional në fushat që mbulon departamenti.
- (xiv) Koordinon dhe përgatit planet studimore dhe kërkimore të Njesisë bazë (Departamentit) në bashkëpunim me shefat e sektorëve.
- (xv) Kontrollon të dhënat dhe përgatitjen dhe cilësinë e raporteve javore, mujore, tremujore dhe vjetore të Njesisë bazë (Departamentit).

Kriteret për emërimin e **Përgjegjësve të Sektorëve** janë në përputhshmëri të plotë me funksionet e ISHP-së të përcaktuara ligjërisht: *“Instituti i Shëndetit Publik është qendër e kërkimit shkencor në shëndet publik, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare e trajnimit në shëndet publik dhe qendër e informacionit në shëndet publik”* (neni 12, Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”), dhe në legjislacionin në fuqi për pagat e Institutit të Shëndetit Publik

Rrjedhimisht, kriteret për emërimin e shefave të Sektorëve janë:

- (i) Të ketë diplomë specializimi apo kërkime pasuniversitare në fushën përkatëse apo fusha të lidhura me shëndetin publik (epidemiologji, mikrobiologji, etj.);
- (ii) Të ketë të paktën Gradë Shkencore “Doktor”;
- (iii) Të ketë eksperiencë në aktivitetin shkencor dhe akademik në fushën e Shëndetit Publik.

Përgjegjësit e Sektorëve përbërës të Njesisë bazë (Departamentit), Shefat/Përgjegjësit e Seksioneve përbërës të Sektorëve të Njesisë bazë (Departamentit), Shefat/Përgjegjësit e Laboratorëve përbërës të Njesisë bazë (Departamentit), kanë për detyrë të ndihmojnë Përgjegjësin e Njesisë bazë (Departamentit) dhe të bashkëpunojnë me të për realizimin në kohë, në sasinë dhe cilësinë e duhur të detyrave të Njesisë bazë (Departamentit) konform planeve të punës të miratuara nga Këshilli Shkencor dhe Drejtori i ISHP-së. Detyrat/funksionet e tyre përcaktohen në detaje në Rregulloren e Brendshme të Njesisë bazë (Departamentit) përkatës.

Neni 11

KËSHILLI DREJTUES I ISHP

- (i) **Këshilli Drejtues i ISHP-së** është organ këshillimor i drejtorit të ISHP-së.
- (ii) Ai përbëhet nga:
 - Tre Zëvendëstitullarët (dy Teknik dhe një Ekonomik);
 - Shefat e Departamenteve;

- Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore;
 - Përgjegjësi i Sektorit të Administratës;
 - Përgjegjësi i Sektorit të Financës.
- (iii) Drejtori i ISHP-së (dhe në mungesë të tij, Zëvendëstitullari Teknik i caktuar nga Drejtori), organizon dhe drejton mbledhjet e rregullta javore të Këshillit Drejtues.
 - (iv) Në mbledhjet e tij, Këshilli Drejtues shqyrton dhe diskuton mbi aktivitetet e ISHP-së dhe problemet përkatëse të shtruara për zgjidhje.
 - (v) Për probleme të veçanta, Drejtori thërret për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues edhe specialist/e përkatës të ISHP-së.
 - (vi) Asistenti i Drejtorit të ISHP-së luan rolin e sekretarit të Këshillit Drejtues.

Neni 12 KËSHILLI SHKENCOR I ISHP

Këshilli Shkencor i ISHP-së organizohet dhe funksionon në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave, VKM nr. 380, datë 18.5.2011 "Për Ngritjen, Organizimin dhe Mënyrën e Funksionimit të Këshillit Shkencor të Institutit të Shëndetit Publik", përpiluar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 13, të Ligjit nr. 10 138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik".

Neni 13 FUNKSIONET E ISHP

Funksionet bazë të Institutit të Shëndetit Publik, bazuar në nenin 15, Ligji Nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik", janë:

- 1) Mbikëqyrja, vlerësimi dhe përsosja e veprimtarisë profesionale të strukturave lokale në fushën e shëndetit publik.
- 2) Observatori Epidemiologjik Kombëtar.
- 3) Prodhimi i indikatorëve të shëndetit.
- 4) Survejanca e integruar e sëmundjeve infektive.
- 5) Programit Kombëtar i Vaksinit.
- 6) Mbikëqyrja dhe vlerësimi i infeksioneve spitalore dhe menaxhimit të mbetjeve spitalore (në bashkëpunim me Strukturat Rajonale të Shëndetit Publik).
- 7) Qendër e sigurimit dhe kontrollit të cilësisë të laboratorëve të shëndetit publik.
- 8) Programi Kombëtar i HIV/AIDS dhe qendër reference në fushën e shëndetit publik për HIV/AIDS dhe IST.
- 9) Programi i Kontrollit të Tuberkulozit.
- 10) Programi i koordinimit të luftës kundër vektorëve.
- 11) Qendër e laboratorëve të referencës për sëmundjet infektive me rrezikshmëri të lartë dhe qendër reference në fushën e shëndetit publik për sëmundjet zoonotike me transmetim vektorial.
- 12) Qendra kombëtare për koordinimin dhe zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit.

- 13) Qendër referente në fushën e shëndetit publik për promovimin dhe edukimin shëndetësor.
- 14) Observatori kombëtar i faktorëve të riskut për sëmundjet jo të komunikueshme dhe barrës së sëmundjeve jo të komunikueshme. Qendër administrimi e regjistrave të sëmundjeve jo të komunikueshme.
- 15) Qendra Kombëtare e Sistemit të Informacionit për Drogën.
- 16) Qendër referente për vlerësimin e ndikimit të mjedisit në shëndet.
- 17) Qendër referente laboratorike në monitorimin e ujit, ajrit, zhurmave.
- 18) Qendër referente e vlerësimit të faktorëve të dëmshëm për shëndetin në punë.
- 19) Qendër e analizës së politikave dhe praktikave ndërkombëtare në shëndet publik.
- 20) Qendër referente e kërkimit shkencor në shëndet publik.
- 21) Trajnimin dhe edukimin Universitar në Shëndetin Publik Qendër operative dhe implementuese e programeve të shëndetit publik në raste të përcaktuara nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

13.1. Veprimtari bazë të shëndetit publik

Monitorimi i gjendjes shëndetësore të popullatës për të identifikuar problemet e saj.

- (i) Diagnostikimi dhe hulumtimi i problemeve shëndetësore dhe faktorëve risk në popullatë.
- (ii) Vlerësimi i efektivitetit, përdorimit dhe cilësisë së shërbimeve të shëndetit publik ndaj individit dhe komunitetit.
- (iii) Zhvillimi i politikave dhe planeve që mbështesin përpjekjet shëndetësore të individit dhe komunitetit.
- (iv) Përforcimi i ligjeve dhe rregulloreve që mbrojnë shëndetin publik dhe e sigurojnë atë, si dhe kapacitetet zbatuese.
- (v) Hulumtimi për njohuri dhe zgjidhje të reja të problemeve shëndetësore.
- (vi) Promovimi dhe mbështetja e aksesit të barabartë në shërbime të shëndetit publike.
- (vii) Sigurimi dhe zhvillimi nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm i burimeve njerëzore në shëndetin publik.
- (viii) Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës rreth çështjeve shëndetësore.
- (ix) Mobilizimi i popullatës për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve shëndetësore, si dhe promovimin e shëndetit.
- (x) Përgatitja, planifikimi dhe marrja e masave zbutëse për përballimin e emergjencave civile, si dhe fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu.

13.2. Paketa e shërbimeve të shëndetit publik

1. Paketa e shërbimeve të shëndetit publik përfshin shërbimet bazë dhe shërbimet ndihmëse të shëndetit publik, që janë në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe nevojave të shëndetit të popullatës.
2. Paketa e shërbimeve ndihmëse të shëndetit publik miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

13.3. Shërbimet bazë të shëndetit publik

I. Shërbimet bazë të shëndetit publik janë:

- (i) promovimi i shëndetit;
- (ii) edukimi shëndetësor;
- (iii) parandalimi i sëmundjeve, përfshirë imunizimin, depistimin;
- (iv) siguria ushqimore;
- (v) shëndeti në punë;
- (vi) shëndeti mjedisor, përfshirë monitorimin e mbetjeve urbane;
- (vii) shëndeti riprodhues, përfshirë shëndetin e nënës, të fëmijës dhe shëndetin seksual;
- (viii) parandalimi dhe kontrolli i përdorimit abuziv të substancave (produktet e duhanit, alkoolit, lëndëve narkotike dhe psikotrope etj.);
- (ix) shëndeti mendor;
- (x) sistemi i informacionit në shëndetin publik;
- (xi) survejanca epidemiologjike në shëndetin publik;
- (xii) laboratorët e shëndetit publik;
- (xiii) monitorimi i shërbimeve të shëndetit publik në kujdesin shëndetësor parësor;
- (xiv) kërkimi shkencor në shëndetin publik;
- (xv) trajnimet në shëndetin publik.

Instituti i Shëndetit Publik bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të pikës 14 "Strukturë Shëndetësore Universitare është edhe Instituti i Shëndetit Publik, i cili ofron shërbim shëndetësor parandalues dhe funksione mësimore e kërkimore shkencore....." mbështet me ekspertizë, me pedagogë dhe ambiente për praktikë dhe mësimdhënie Universitetin e Mjekësisë dhe jo vetëm, por në kuadër të biapartinencës me Fakultetin e Mjekësisë Tiranë, mbështetur në Pikën 10/2 të VKM-së 1076, datë 24.12.2020 "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin nr. 555, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave....." të ndryshuar, pedagogë të brendshëm të Fakultetit të Mjekësisë njëherazi, kanë angazhim maksimal dhe kontribut të vyer në mbështetje të qëllimit, objektivave dhe misionit të Institutit të Shëndetit Publik.

KREU III: RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 14

MARRËDHËNIA E ISHP ME STRUKTURAT RAJONALE TË SHËNDETIT PUBLIK

1. Strukturat qendrore, rajonale dhe lokale të shëndetit publik që përfshihen në strukturat e operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe më tej pranë strukturave të tjera si ato të pushtetit lokal etj., i referohen Institutit të Shëndetit Publik për ekspertizë, shërbime të specializuara dhe zhvillim profesional në fushën e shëndetit publik.

2. Strukturat rajonale të shëndetit publik dërgojnë informacion në Institutin e Shëndetit Publik. Mënyra e informimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bazuar në nenin 23, të Ligjit 10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin Publik" dhe në Ligjin 15/2016 "Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive".

Neni 15

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Bazuar në Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", pika 1, neni 19 dhe shkresës nr. 1077, datë 16.06.2021 "Mbi detyrimet sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe të urdhërave 187 dhe 188 të KDIMDHP "Mbi miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuara", i ndryshuar.

Neni 16

PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE

Bazuar në Ligjin Nr. 60/2016 "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve", Ligjit nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik" dhe Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", VKM-së nr. 816, datë 16.11.2016 "Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të Njësisë Përgjegjëse në Autoritetet Publike".

Neni 17

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Bazuar në Ligjin nr.9887/2008, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Udhëzimit nr.47, datë 14.09.2018 "Për përcaktimin e rregullave të mbrojtjes së sigurisë të të dhënave të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha".

Neni 18

PARANDALIMI I KONFIKTIT TË INTERESAVE

Bazuar në nenin 41, pika 2, gërma "b", si dhe nenit 42, pika 3 e Ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar.

Neni 19

KOORDINATORI I RRJETIT TË KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT

Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion është një strukturë nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar kundër korrupsionit, Ministrit të Drejtësisë, me urdhrin nr. 106, datë 25.07.2019 të Kryeministrit, "Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion". të ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 86, datë 25.06.2020, përcaktohet krijimi dhe funksionimi i kësaj strukture. Objektivi i kësaj strukture është lufta kundër çdo lloj forme të korrupsionit dhe forcimi i besimit të qytetarët për një administratë publike. eficiente dhe me integritet të lartë në shërbim të qytetarit.

Koordinatori i Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit mbledh, analizon dhe koordinon të gjithë informacionin për rastet korruptive të referuara nga burime të ndryshme përmes bashkëpunimit me strukturën përgjegjëse për Anti-Korrupsionin në Ministrinë e Drejtësisë, Task Forcën Ndërinstitucionale Antikorrupsion dhe strukturat e tjera antikorrupsion, me qëllim parandalimin, goditjen dhe rritjen e ndërgjegjes publike kundër korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore dhe tek qytetarët.

Risia që sjell kjo strukturë është shpejtësia dhe efikasiteti në trajtimin e ankesës apo denoncimit nga qytetarët. Përmes këtij mekanizmi kombëtar të referimit të korrupsionit të të gjitha niveleve, çdo qytetar mund t'i qaset edhe direkt koordinatorit për të denoncuar apo raportuar çdo parregullsi nga më të lehtat deri te rastet korruptive.

Koordinatori i rrjetit Antikorrupsion do të jetë avokati i çdo denoncuesi në luftën kundër korrupsionit, duke marrë dhe verifikuar denoncimet për veprimet korruptive. Pjesë e rregullimeve të proceseve të punës është dhe ruajtja e anonimatit të çdo denoncuesi, si dhe garancia në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe përpunimit të informacionit.

Neni 20

DHËNIA E MASAVE DISIPLINORE

1. Drejtori ka të drejtë të japë masën disiplinore “Tërheqje vëmendjeje”, “Vërejtje me shkrim” dhe masën administrative “Vërejtje me paralajmërim” dhe “Largim nga puna”, në zbatim të legjislacionit përkatës
2. Përgjegjësi i Njesisë bazë (Departamentit) ka të drejtë të propozojë masa disiplinore për personelin të njesisë që ai drejton.

Si rregull, masat disiplinore merren sipas radhës së mësipërme, përveçse kur punëmarrësi ka kryer shkelje të rëndë të normave ligjore dhe nënligjore.

Masa disiplinore jepet pasi bëhen verifikimet e nevojshme për shkeljen dhe dëgjohen paraprakisht pretendimet e punëmarrësit, duke mbajtur procesverbal me shkrim me të. Masa disiplinore i komunikohet punëmarrësit brenda 3ditëve pune nga marrja e saj, duke u mbajtur procesverbal me nënshkrimin e të gjitha palëve pjesëmarrëse, detyrimisht edhe të punëmarrësit. Nëse ai nuk pranon të nënshkruajë, atëherë procesverbali i cili pasqyron këtë fakt, me firmat e anëtarëve të pranishëm, i dërgohet zyrtarisht punëmarrësit ndaj të cilit është marrë masa.

Masa disiplinore “tërheqje vëmendjeje” shlyhet brenda 3 muajve, nëse punëmarrësi ndaj të cilit është marrë ajo, nuk kryen shkelje tjetër. Masat disiplinore “vërejtje me shkrim”, “vërejtje me paralajmërim” shlyhen brenda gjashtë muajve, nëse punëmarrësi ndaj të cilit është marrë ajo, nuk kryen shkelje tjetër. Pas shlyerjes së masës, punëmarrësi konsiderohet pa masë disiplinore.

Po ashtu, përgjegjësi i Njesisë bazë (Departamentit) ka të drejtë të propozojë ndërprerje të pagesës kur punonjësi nuk plotëson objektivat e përcaktuara për njësinë/sectorin që ai punon.

Drejtori ka të drejtë të ndërpresë pagesën kur punonjësi nuk plotëson objektivat e përcaktuara në njësinë/sectorin që ai punon.

KREU IV: ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I NJËSIVE PËRBËRËSE TË ISHP

PËRSHKRIMET E PUNËS

Neni 21

NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE INFEKTIVE

Njësia Bazë (Departamenti) është i organizuar në shtatë sektorë:

1. Sektori i Survejancës dhe Shërbimit të Inteligjencës Epidemike
2. Sektori i Programit Kombëtar të Vaksinimit
3. Sektori i Programit Kombëtar të Kontrollit të HIV/AIDS/SST
4. Sektori i Programit Kombëtar të Kontrollit të Tuberkulozit
5. Sektori i Programit të Kontrollit të Infeksioneve Spitalore
6. Sektori i Kontrollit të Vektorëve
7. Sektori i Survejancës Laboratorike të Sëmundjeve Emergjente Virale

21.1. Sektori i Survejancës dhe Shërbimit të Inteligjencës Epidemike

Misioni

Përmirësimi i shëndetit të popullatës përmes përforcimit të survejancës dhe shërbimit të inteligjencës epidemike për të zvogëluar sëmundshmërinë, gjymtimin dhe vdekjen nga infeksionet apo sëmundje që transmetohen nga agjentë infektivë, si dhe ndodhi jo të zakonshme duke koordinuar këtë shërbim për të gjithë vendin dhe duke siguruar cilësinë e përgjigjes ndaj çdo shpërthimi epidemik apo ndodhive jo të zakonshme.

Vizioni

Përmirësim i parandalimit, kontrollit dhe përgjigjes ndaj sëmundjeve infektive, shpërthimeve epidemike dhe ndodhive jo të zakonshme duke përforcuar sistemin kombëtar të survejancës të sëmundjeve infektive dhe agjentëve shkaktarë të tyre dhe koordinimit të shërbimit të inteligjencës epidemike, analizës dhe vlerësimit të riskut dhe aplikimit në kohë të mënyrave të reja të kontrollit.

Përmbyllja e këtij misioni realizohet nëpërmjet arritjes së qëllimit kryesor të veprimtarisë së Sektorit në luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive, minimizimin deri në zhdukjen e tyre.

Baza ligjore:

-Ligji nr. 15/2016 "Për Parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive".

-Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik",

-Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit

Sektori koordinon shërbimin Kombëtar të Inteligjencës Epidemike i cili është një shërbim shëndetësor i specializuar, që realizohet dhe monitorohet nën përgjegjësinë e Institutit të Shëndetit Publik, që evidenton, në kohë reale çdo ngjarje jo të zakonshme, ndërhyr për parandalimin, kontrollin apo eliminimin e tyre dhe koordinon e kontrollon zbatimin e ligjshmërisë së fushës në: a) institucionet e shërbimit shëndetësor, në të gjitha nivelet publike ose jopublike; b) strukturat e shërbimit shëndetësor në varësi të ministrive të tjera; c) strukturat e qeverisjes qendrore dhe vendore; ç) sektorët publikë ose jopublikë dhe veprimtaritë e personave fizikë e juridikë të të gjitha llojeve, ku rrezikohet përhapja e sëmundjeve infektive; d) popullatën apo mjedisin, ku rrezikohet përhapja e sëmundjeve infektive.

Shërbimi Kombëtar i Inteligjencës Epidemike e kryen veprimtarinë e tij përmes rrjetit të inteligjencës epidemike i cili përbëhet nga punonjës të kualifikuar në strukturat lokale të shëndetit publik.

Personeli, i cili bën pjesë në rrjetin kombëtar të inteligjencës epidemike, duhet të jetë i specializuar në kontrollin e sëmundjeve infektive, në epidemiologjinë e aplikuar të terrenit e në mikrobiologji dhe përzgjidhet në bazë të formimit, aftësive dhe kriterëve të miratuara, me urdhër nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

Mënyra e funksionimit të këtij shërbimi përcaktohet me urdhër nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

Qëllimi i aktivitetit të sektorit qëndron në kryerjen e survejancës epidemiologjike të sëmundjeve infektive, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe rolin në parandalimin, zbulimin në kohë, kontrollin dhe monitorimin e sëmundjeve infektive dhe ngjarjet e papritura me rëndësi për shëndetin publik. Sektori i Survejancës dhe Shërbimit të Inteligjencës Epidemike ushtron aktivitetin e tij dhe është nën drejtimin e Njesisë bazë (Departamentit) të Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive. Ka një bashkëpunim të ngushtë me sektorët e tjerë të Njesisë bazë (Departamentit), departamentet e tjera të ISHP-së, me Shërbimet Epidemiologjike dhe Shëndetit Mjedisor në NJVKSH, Operatorin shëndetësor qendror dhe rajonal, si dhe me struktura të tjera të linjës.

Ojektivat e Sektorit

Arritja e qëllimit të Sektorit të Survejancës dhe Shërbimit të Inteligjencës Epidemike realizohet nëpërmjet përmbushjes së objektivave të tij parësore që janë:

- Grumbullon, përpunon, analizon në kohë reale dhe në vijueshmëri të dhënat mbi sëmundshmërinë infektive të dërguara në ISHP) nga Shërbimet Epidemiologjike dhe të Shëndetit Mjedisor të të gjithë NJVKSH-ve të vendit, dhe ndërhyr apo vepron në bazë të këtyre të dhënave. Burimi i të dhënave përfshin kujdesin parësor, spitalor dytësor dhe spitalor tretësor, si në shërbimin publik dhe atë privat.
- Vlerëson çdo ngjarje të pazakontë në vend dhe në bashkëpunim edhe me departamentet e tjera të ISHP-së apo struktura të tjera, njofton menjëherë drejtorinë e ISHP-së, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), OBSH-në dhe realizon të gjitha ndërhyrjet ndaj shpërthimeve epidemike apo situatave jo të zakonshme në vend e rajon, duke përmbushur funksionet e tij si qendër e koordinimit për Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit.

- Koordinon survejancën e integruar të sëmundjeve infektive në vend dhe hetimin epidemiologjik të sëmundjeve infektive dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme në kuadër të ligjeve në fuqi dhe Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit apo organizmave të tjerë ndërkombëtare e të tjerë sipas detyrimit të vendit.
- Kryen kërkime shkencore në këto fusha dhe merr pjesë në edukimin e vazhduar në fushën përkatëse.
- Kryen studime epidemiologjike në fushën e sëmundjeve infektive për përcaktimin e trendit të tyre sipas triadës klasike "person-vend-kohë" dhe identifikimin e faktorëve rrezikues të hasjes së tyre.
- Kryen konsulencën kombëtare për survejancën e sëmundjeve infektive në vend, si dhe ndërkombëtare, kur i kërkohet sipas detyrimeve që ka vendi.
- Organizon dhe koordinon takimet dhe bashkëpunimet me shërbimet epidemiologjike dhe shëndetit mjedisor në NJVKSH.
- Përgatit raporte dhe buletine kombëtare për survejancën epidemiologjike të sëmundjeve infektive.
- Kryen shërbimin javor të rojeve 24/24 "on call" për t'u përgjigjur dhe koordinuar përgjigjen ndaj ngjarjeve jo të zakonshme, apo shpërthimeve epidemike.
- Kryen kërkim shkencor në fushën e epidemiologjisë të sëmundjeve infektive, duke marrë pjesë në procesin e edukimit të vazhduar në fushën përkatëse.
- Përgatit dhe menaxhon sistemet e databazës të sëmundjeve infektive në vend.
- Kryen raportime sistematike pranë organizmave ndërkombëtare sipas sëmundjeve përkatëse.
- Kryen rolin e një qendre referente për mjekësinë e udhëtarëve.
- Përmban qendrën e zbatimit dhe koordinimit të veprimeve për Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit.
- Kryen dhe koordinon raportimin e sëmundjeve përkatëse infektive prane ECDC në kuadër të integritetit evropian si dhe pranë EHO sipas çështjeve të përcaktuara më parë.
- Raporton pranë shefit të Njesisë bazë

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Koordinon survejancën e sëmundjeve infektive në vend dhe hetimin e sëmundjeve infektive dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme në kuadër të ligjeve në fuqi dhe rregullores ndërkombëtare të shëndetit apo organizmave të tjerë ndërkombëtare e të tjerë sipas detyrimit të vendit. Kryen kërkime shkencore në këto fusha dhe merr pjesë në edukimin e vazhduar në fushën përkatëse. Kryen konsulencën kombëtare për survejancën e sëmundjeve infektive në vend, si dhe ndërkombëtare kur i kërkohet sipas detyrimeve që ka vendi. Organizon dhe koordinon takimet dhe bashkëpunimet me shërbimet epidemiologjike të njësive vendore përkatëse. Koordinon dhe monitoron punën e skuadrave përkatëse për kontrollin e sëmundjeve infektive dhe shpërthimeve epidemike dhe përcakton detyrat e tyre si dhe koordinon, drejton dhe monitoron punën e tyre në terren. Përgatit raportin kombëtar për survejancën epidemiologjike të sëmundjeve infektive, si dhe drejton përgatitjen e raporteve të tjera lidhur me objektivat e njesisë Kryen raportime ndërkombëtare dhe kombëtare apo koordinon këto raportime për sektorin që mbulon. Raporton pranë shefit të Njesisë bazë (Departamentit) për veprimtarinë e sektorit në mënyrë periodike.

Përshkrimi i punës: Specialist/ Me Titull/ Gradë

Kryejnë hetimet epidemiologjike, marrin pjesë në zbatimin e survejancës epidemiologjike në vend, kryejnë raportimin dhe përgatisin raportet përkatëse sipas ligjeve në fuqi, përgatisin buletinet përkatëse të survejancës epidemiologjike (ALERT, 14-SH, Gripit etj.). Kryejnë njoftimin e hershëm. Kryejnë shërbimin javor të rojeve për t'iu përgjigjur dhe koordinuar ndaj ngjarjeve jo të zakonshme apo shpërthimeve epidemike. Kryejnë kërkim shkencor në fushën e epidemiologjisë të sëmundjeve infektive dhe marrin pjesë në procesin e edukimit të vazhduar në fushën përkatëse. Përgatisin dhe menaxhojnë sistemet e databazës për këto sëmundje në vend. Raportojnë pranë OBSH-së dhe ECDC-së sipas sëmundjeve përkatëse. Raportojnë pranë shefit të sektorit dhe të Njesisë bazë (Departamentit))

Kryen komunikimin e të dhënave dhe ruan korrespondencën me vendet e Europës Juglindore, lehtëson komunikimin në lidhje me këto vende për sëmundjet infektive, koordinon informacionin në lidhje me aktivitetet e përbashkëta, si dhe këto aktivitete në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Përgatit raporte 6-mujore dhe vjetore në lidhje me koordinimin e aktiviteteve me këto vende. Kryen kërkime në fushën e zhvillimit të kontrollit të sëmundjeve në rajonin e Europës Juglindore.

Specialist (Redaktor letrar)

Kryen redaktimin letrar dhe korrekton të gjitha materialet e prodhuara nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive, përkatësisht: Redaktim i Buletinit javor, mujor, tremujor dhe vjetor të Sëmundshmërisë Infektive dhe i Epitëlit. Raportin vjetor të: AIDS, Tuberkulozit, COVID-19 dhe të Gripit. Raportet tremujore dhe vjetore të Vaksinit, raportet e infeksioneve spitalore, entomologjike dhe të tjerë. Po ashtu, redakton udhëzues, protokolle dhe rregullore të ndryshme që hartohen nga departamenti. Materiale të ndryshme për tematika të caktuara të shëndetit (HIV/AIDS etj.). Raporte të mbledhjeve dhe konkluzioneve vjetore.

Hartimi i planit të punës, i prioritetëve duke pasur në konsideratë kohën dhe rëndësinë e materialeve të paraqitura, dorëzimin e dorëshkrimit brenda afateve të përcaktuara.

Respektimi ndaj autorit, por dhe kërkimi i shpjegimeve, argumenteve dhe qartësisë duke ruajtur vlerën autentike të artikullit për përmirësimin e performancës dhe vlerës shkencore të produktit përfundimtar.

Rishikimi për një vlerësim të dytë të punës së kryer për të eliminuar çdo gabim të mundshëm.

Ngritje profesionale, përfshirja dhe angazhimi në trajnime në fushën e shëndetit publik dhe shkrimeve për shëndetin publik për t'u përditësuar me të rejat e fundit.

21.2.Sektori i Programit Kombëtar të Vaksinit

Misioni

Përmirësimi i shëndetit të popullatës përmes vaksinimit për të zvogëluar sëmundshmërinë, gjymtimin dhe vdekjen nga infeksione apo sëmundje të parandalueshme, duke ofruar një program kombëtar koordinues, cilësor të vaksinimit i cili përmirëson vazhdimisht kalendarin kombëtar të imunizimit.

Baza ligjore:

- Ligji nr. 15/2016 datë 10.3.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”,
- Ligji nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”.

Vizioni:

Përmirësim i menaxhimit të programit kombëtar të vaksinimit për të arritur një mbulesë vaksinale mbi 95% për çdo antigen në çdo nivel (kombëtar, bashki, komuna, qendra shëndetësore) duke ofruar vakcina cilësore dhe të sigurta nëpërmjet shërbimeve të ndryshme shëndetësore dhe sa më afër komuniteteve.

Sektori menaxhon programin kombëtar të vaksinimit duke:

- Përgatitur dhe propozuar strategjitë dhe planet kombëtare për vaksinimin dhe imunizimin për çdo antigen (vaksinë) specifik.
- Përgatitur dhe propozuar kalendarin kombëtar të vaksinimit për fëmijë, adoleshentë dhe grupe të tjera të popullatës sipas çdo antigeni (vaksine).
- Përgatitur dhe propozuar standardet kombëtare të vaksinimit dhe përmirësimin e tyre në çdo nivel.
- Përgatitur rekomandime dhe udhëzime në lidhje me vaksinat, imunizimin, vaksinimin, zinxhirin ftohës, sigurinë e injeksioneve, administrimin dhe shërbimin e vaksinimit.
- Kryer parashikimin, sigurimin në kohë dhe sasinë e duhur të të gjitha vaksinave (antigeneve) të Kalendarit Kombëtar të Vaksinimit.
- Shpërndarë në mënyrë periodike (çdo tremujor) vaksinat në tërë NJVKSH-të e vendit mbështetur në rregullat përkatëse që lidhen me shpërndarjen.
- Monitoruar ecurinë e Programit Kombëtar të Vaksinimit, menaxhimit dhe standardeve të tij në çdo nivel.
- Monitoruar nivelin kombëtar të mbulesës me vaksinë dhe të mbulesës me vaksinë për secilin antigen të Kalendarit Kombëtar të Vaksinimit çdo tre muaj dhe përgatitur raportet kombëtare vjetore të mbulesës vaksinale.
- Parashikuar mjetet bazë të zinxhirit ftohës dhe duke kryer monitorimin e performancës së tij.
- Propozuar dhe ndihmuar në organizimin apo zhvillimin e fushatave të vaksinimit për të siguruar mbulesë të lartë me vakcina në çdo komunitet.
- Nxitur përdorimin e teknologjisë së informacionit apo mënyra të tjera për të siguruar një nivel mbrojtjeje vaksinore në kohë dhe të lartë në shërbim të qytetarëve.
- Monitoruar reaksionet dhe ndodhitë pas vaksinimit (efekteve anësore të padëshirueshme të vaksinës/vaksinimit) në bashkëpunim me sektorë të tjerë të Njesisë bazë (Departamentit) edhe sektorin e Farmakovigjilencës pranë Agjencisë së Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
- Përgatitur raportet ndërkombëtare në lidhje me vaksinimin si p.sh.: raportimin vjetor të raportit të përbashkët OBSH&UNICEF në lidhje me vaksinimin, apo raportimet vjetore në lidhje me poliomielin, fruthin dhe rubeolën për OBSH-në, në bashkëpunim me sektorë të tjerë të Njesisë bazë (Departamentit)

- Kryer rolin e sekretariatit për koordinimin e Komitetit Këshillimor Kombëtar Teknik të Imunizimit.
- Kryer koordinimin e Komitetit të Gripit në bashkëpunim me sektorë të tjerë të Njesisë bazë (Departamentit)
- Monitoron cilësinë e punës në lidhje me vaksinimin në operatorin qendror dhe lokal të shërbimit shëndetësor dhe me tej në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor (NJVKSH), apo në sektorë të tjerë publik dhe privat që lidhen me vaksinimin.
- Kryen koordinimin, trajnimin e vazhdueshëm të personelit si p.sh.: atij epidemiolog dhe kryevaksinators të NJVKSH-ve për programin e vaksinimit, futjen e vaksinave të reja, fushatat, monitorimet, sistemet e raportimit dhe monitoruar këtë program trajnimi në nivel kombëtar.
- Kryen trajnimin e çdo personeli të ri që ka lidhje me vaksinimin pranë operatorit kombëtar të shërbimit shëndetësor dhe në NJVKSH.
- Përgatit ndërhyrje që përmirësojnë programin e vaksinimit dhe efektivitetin e tij në çdo nivel.
- Bashkëpunon me sektorë të tjerë brenda Njesisë bazë (Departamentit) dhe jashtë tij në lidhje me survejancën dhe kontrollin e sëmundjeve të parandalueshme me anë të vaksinimit.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Supervizim për menaxhimin e programit të vaksinimit në të gjithë vendin dhe konsulencë në lidhje me menaxhimin e tij. Ofrim i shërbimit të vaksinimit dhe efekteve të tyre, si dhe ofrim i vlerësimit të vaksinimit në rast shpërthimesh epidemike. Kryerja e parashikimit të sasive të vaksinave, shiringave dhe materialeve të tjera të Programit Kombëtar të Vaksinimit. Kryerja e vlerësimit të kostos për programin për UNICEF dhe ISHP. Vlerësimi i mbulesës vaksinale për të gjithë vendin dhe zona të veçanta të tij. Ndjekje e procesit të ardhjes së vaksinave nga burimi i tyre deri në depon qendrore të ISHP-së dhe më pas shpërndarjes pranë depove përkatëse të rretheve. Supervizim i menaxhimit të kushteve të ruajtjes dhe aplikimit të vaksinave, si zinxhirit ftohës dhe sigurisë së injeksioneve. Kërkim shkencor në lidhje me cilësinë e vaksinave, efekteve të tyre dhe vlerësimin e impaktit të programit të vaksinimit. Kërkim dhe studime në lidhje me vlerësimin e mbulesës vaksinale dhe imunitetit të popullatës. Përfaqësim në komitete, grupe pune, konferenca, takime kombëtare apo ndërkombëtare. Përgatit raportet kombëtare dhe raportimet ndërkombëtare si JRF për OBSH, UNICEF etj.

Përshkrimi i punës: Specialist/ Me Titull / Gradë

Ofrim i shërbimit të vaksinimit dhe vlerësimit të vaksinimit në rast shpërthimesh epidemike. Ndhmon në kryerjen e parashikimit të sasive të vaksinave, shiringave dhe materialeve të tjera të programit kombëtar të vaksinimit, vlerësimit të mbulesës vaksinale. Koordinon dhe ndjek procesin e ardhjes së vaksinave nga burimi i tyre deri në depon qendrore të ISHP-së dhe më pas shpërndarjes pranë depove përkatëse të rretheve. Ndhmon në supervizimin e menaxhimit të kushteve të ruajtjes dhe aplikimit të vaksinave. Kërkim shkencor në lidhje me cilësinë e vaksinave, kosto-efektivitetin, futjen e vaksinave të reja, vendimmarrjen, efekteve të tyre dhe vlerësimin e impaktit të programit të vaksinimit. Raportim për mbulesën vaksinale. Përfaqësim në komitete, grupe pune, konferenca, takime kombëtare apo ndërkombëtare.

Përshkrimi i punës: Specialist

Koordinon menaxhimin e depos qendrore të vaksinave, cilësinë tyre në depo, kontrollon cilësitë e depove të vaksinave në rrethe, përgatit raporte mbi gjendjen në depon e vaksinave dhe njih sistemet e informacionit të vaksinimit. Koordinon shërbimin e zinxhirit të ftohtë të depos qendrore të vaksinave. Kryen kërkime shkencore operationale në drejtim të menaxhimit të vaksinave.

Koordinon sigurinë e zinxhirit të ftohtë që nga mbërritja në aeroport deri në depon qendrore të vaksinave dhe më pas në rrethe. Siguron cilësinë e transportit të sigurt të vaksinave deri në depot e rretheve. Vlerëson sigurinë e zinxhirit të ftohtë të vaksinave në të gjithë vendin. Njih dhe vlerëson pajisjet e zinxhirit të ftohtë. Kryen kërkime shkencore në drejtim të zinxhirit të ftohtë dhe mënyrave të reja të ruajtjes së vaksinave.

Koordinon shpërndarjen e vaksinave, procesin mbërritjes së vaksinave në vend nga aeroporti në depon qendrore dhe më pas në rrethe në depot përkatëse të vaksinave. Siguron cilësinë e transportit të sigurt të vaksinave deri në depot e rretheve. Vlerëson transportin e vaksinave brenda rrethit. Kryen kërkime shkencore operationale në drejtim të mënyrave të shpërndarjes së vaksinave dhe cilësisë së tyre. Monitoron menaxhimin e vaksinave dhe administrimin e tyre dhe evidenton problemet përkatëse, si dhe ofron zgjidhjet në nivel kombëtar dhe lokal.

Kryen vlerësim të cilësisë së vaksinave në ardhje dhe shpërndarje, plotëson dokumentacionin përkatës, kontrollon vazhdimisht cilësinë e vaksinave sipas udhëzimeve përkatëse në depon qendrore dhe ofron ekspertizën në të gjithë vendin. Njih dhe aplikon vaksinimin e sigurt. Vlerëson vaksinimin e sigurt në vend.

21.3.Sektori i Programit Kombëtar të Kontrollit të HIV/AIDS/SST

Misioni

Përmirësimi i shëndetit të popullatës nëpërmjet parandalimit të infeksioneve të reja HIV, ofrimit të mbështetjes, kujdesit dhe trajtimit mjekësor cilësor për të gjithë personat e infektuar me HIV dhe sigurimit të një mjedisi mbështetës për reduktim të stigmës, diskriminimit dhe mbështetjes sociale.

Vizioni

Fuqizimi dhe përmirësimi i menaxhimit të Programit Kombëtar HIV/AIDS në parandalimin e përhapjes së infeksionit HIV duke përdorur qasje dhe ndërhyrje të kombinuara përfshirë programet e informimit dhe ndërgjegjësimit, zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve të këshillimit dhe testimit vullnetar (KTV), parandalimin e transmetimit nga nëna te fëmija (PMTCT), ndryshimin e sjelljes dhe të praktikave seksuale, përmirësime të kuadrit ligjor.

Baza ligjore:

- Ligji nr.9952, datë 14.7.2008 “Për Parandalimin dhe Kontrollin e HIV/AIDS”;
- Ligji nr. 15/2016 datë 10.3.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”;
- Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”.

Sektori menaxhon programin kombëtar të HIV/AIDS duke:

- Koordinuar përgjigjen kombëtare ndaj HIV/AIDS dhe bashkërenduar punën e institucioneve shtetërore, OJF-ve dhe organizatave ndërkombëtare për arritjen e objektivave të programit dhe për të siguruar ndjekjen e politikave kombëtare.
- Monitoruar zbatimin e ligjshmërisë dhe koordinuar përgatitjet e të gjithave dokumenteve ligjore dhe teknike për HIV/AIDS.
- Rishikuar strategjitë dhe politikat ndërhyrëse në bazë të ndryshimit të situatës epidemiologjike, si dhe të përvojave ndërkombëtare.
- Rishikuar dhe përditësuar udhëzues dhe standardet kombëtare të parandalimit dhe testimit për HIV.
- Monitoruar dhe vlerësuar ndërhyrjet në shkallë kombëtare të aktivitetëve në fushën e parandalimit të HIV/AIDS.
- Koordinuar survejancën e integruar të HIV/AIDS.
- Kryer hetime epidemiologjike të rasteve dhe situatave specifike.
- Koordinuar, monitoruar dhe zbatuar aktivitetet e parandalimit të transmetimit të infeksionit HIV (PMTCT) në bashkëpunim me operatorin dhe njësitë vendore të kujdesit shëndetësor (NJVKSH).
- Përgatitur raporte ndërkombëtare në kuadër të GARP, Progres Raportit mbi Përgjigjen Globale ndaj AIDS (Global AIDS Response Progress Reporting), dhe ECDC.
- Advokuar për mbrojtjen e të drejtave të personave që jetojnë me HIV/AIDS.
- Nxitur përdorimin e teknologjisë së informacionit apo mënyra të tjera për të siguruar dhënien e informacionit në mënyrë të saktë dhe të shpejtë.
- Kontrolluar, vlerësuar cilësinë e të dhënave dhe burimet e tyre.
- Siguruar kushtet për të mundësuar shkëmbimin e informacionit mes Programit Kombëtar HIV/AIDS dhe programeve të ngjashme.
- Bashkëpunuar me faktorin ndërkombëtar për të siguruar mbështetje teknike dhe financiare për të parandaluar përhapjen e HIV/AIDS.
- Kryer kërkime shkencore në fushën e HIV/AIDS.
- Kryer monitorimin e medias për HIV/AIDS dhe përgatitur raporte vjetore.
- Përgatitur standardet e edukimit për HIV/AIDS sipas grup-moshave dhe grupeve të ndryshme shoqërore apo profesioneve.
- Koordinuar fushatat e ndërgjegjësimit dhe promovimit duke përfshirë ditën ndërkombëtare të HIV/AIDS.
- Ofruar shërbim psiko-social për qendrën kombëtare të testimit vullnetar.
- Koordinuar dhe monitoruar veprimtarinë e shërbimeve të testimit vullnetar në shkallë kombëtare.
- Kryer vlerësimin social të impaktit të HIV/AIDS, vlerësimin e shërbimeve sociale të HIV/AIDS dhe cilësisë së tyre për të gjithë grupet e popullatave.
- Raporton pranë ECDC në kuadër të integritetit evropian, UNAIDS dhe OBSH sipas çështjeve të përcaktuara.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Koordinon programin kombëtar të HIV/AIDS në të gjithë vendin me të gjithë aktorët brenda ISHP-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale strukturave të saj dhe jashtë saj, brenda strukturave qeveritare, ose me shoqërinë civile. Prodhon raportin kombëtar të HIV/AIDS dhe koordinon përgatitjen e të gjitha dokumenteve ligjore dhe teknike që lidhen me HIV/AIDS. Koordinon survejancën e integruar të HIV/AIDS dhe të gjitha iniciativat e parandalimit të HIV/AIDS në vend. Vlerëson zbatimin e ligjshmërisë dhe ofron shërbime në fushën e kontrollit të HIV/AIDS. Kryen kërkime shkencore në fushën e parandalimit të HIV/AIDS.

Përshkrimi i punës: Specialist/ Me Titull /Gradë

Koordinon survejancën epidemiologjike të HIV/AIDS dhe hedh të dhënat në lidhje me të. Kontrollon cilësinë e të dhënave dhe i vlerëson ato dhe burimet e tyre. Kryen hetime epidemiologjike në lidhje me HIV/AIDS. Ofron shërbime të këshillimit në fushën e zbatimit të programeve të parandalimit të HIV/AIDS për të gjitha grupet. Përgatit raportin epidemiologjik kombëtar të HIV/AIDS. Vlerëson zbatimin e ligjshmërisë dhe shërbimeve në fushën e kontrollit dhe kujdesit të HIV/AIDS. Raporton pranë ECDC/ËHO për HIV/AIDS. Kryen kërkime shkencore në fushën e HIV/AIDS dhe përhapjes së tij.

Kryejnë vlerësimin social të impaktit të HIV/AIDS, vlerësimin e shërbimeve sociale të HIV/AIDS dhe cilësisë së tyre për të gjithë grupet e popullatave. Marrin pjesë në kryerjen e survejancës së sjelljeve dhe i monitorojnë ato në grupe të ndryshme të popullatës. Kryejnë kërkime shkencore në fushën e shkencave sociale dhe HIV/AIDS.

Kryen monitorimin e materialeve të edukimit për HIV/AIDS dhe zbatimin e tyre. Ofron ekspertizë në fushën e edukimit shëndetësor dhe HIV/AIDS. Kryen monitorimin e medias për HIV/AIDS dhe prodhon raporte vjetore për këtë problem. Përgatit standardet e edukimit për HIV/AIDS sipas grup-moshave dhe grupeve të ndryshme shoqërore apo profesioneve. Kryen kërkime në fushën e HIV/AIDS dhe edukimit apo medias. Koordinon kalendarin e veprimeve të ditës ndërkombëtare të HIV/AIDS.

Ofron shërbim psiko-social për qendrën kombëtare të testimit vullnetar. Koordinon veprimtarinë e qendrave të testimit vullnetar në të gjithë vendin dhe përcakton standardet e këtyre qendrave, si dhe i monitoron ato. Ofron konsulencë kombëtare në çështjet e këshillimit para dhe pas testimit dhe standardet e tyre. Kryen zbatimin e ligjshmërisë në fushën e HIV/AIDS. Kryen kërkime në lidhje me HIV/AIDS dhe këshillimin dhe testimin vullnetar.

21.4.Sektori i Programit Kombëtar të Kontrollit të Turbekulozit

Misioni

Përmirësimi i shëndetit të popullatës nëpërmjet parandalimit të infeksioneve të reja të Tuberkulozit, ofrimit të mbështetjes, kujdesit dhe trajtimit mjekësor cilësor për të gjithë personat e infektuar dhe sigurimit të një mjedisi me mbështetje sociale, që lehtëson terapinë direkte observuese duke reduktuar stigmën dhe diskriminimin.

Vizioni

Fuqizimi dhe përmirësimi i menaxhimit të Programit Kombëtar të Tuberkulozit për të parandaluar përhapjen e tuberkulozit në vend duke përdorur qasje dhe ndërhyrje të kombinuara.

Baza ligjore:

- Ligji nr. 15/2016 datë 10.3.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”;
- Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”.

Sektori menaxhon Programin Kombëtar të Tuberkulozit duke:

- Koordinuar përgjigjen kombëtare ndaj tuberkulozit dhe bashkërenduar punën e institucioneve shtetërore, OJF-ve dhe organizatave ndërkombëtare për arritjen e objektivave të programit dhe për të siguruar ndjekjen e strategjive, politikave dhe udhëzuesve kombëtare.
- Monitoruar zbatimin e ligjshmërisë dhe koordinuar përgatitjet e të gjithave dokumenteve ligjore dhe teknike për tuberkulozin në vend.
- Rishikuar strategjitë dhe politikat ndërhyrëse në bazë të ndryshimit të situatës epidemiologjike, si dhe të përvojave ndërkombëtare.
- Rishikuar dhe përditësuar udhëzues dhe standardet kombëtare të parandalimit, kontrollit dhe menaxhimit të rastit për tuberkulozin.
- Monitoruar dhe vlerësuar ndërhyrjet në shkallë kombëtare apo lokale të ndërhyrjeve dhe aktiviteteve në fushën e parandalimit dhe menaxhimit të tuberkulozit.
- Koordinuar survejancën e integruar të tuberkulozit.
- Kryer hetime epidemiologjike të rasteve, shpërthimeve epidemike dhe situatave specifike.
- Koordinuar, monitoruar dhe zbatuar aktivitetet e parandalimit të transmetimit të tuberkulozit në bashkëpunim me operatorin dhe njësitë vendore të kujdesit shëndetësor (NJVKSH).
- Përgatitur raporte kombëtare vjetore dhe ndërkombëtare, si dhe duke marrë pjesë në aktivitete dhe përgatitur informacione të lidhura me inteligjencën epidemike periodike për tuberkulozin.
- Advokuar për mbrojtjen e të drejtave të personave të infektuar nga tuberkulozi.
- Nxitur përdorimin e teknologjisë së informacionit apo mënyra të tjera për të siguruar dhënien e informacionit në mënyrë të saktë dhe të shpejtë.
- Kontrolluar, vlerësuar cilësinë e të dhënave dhe burimet e tyre.
- Siguruar kushtet për të mundësuar shkëmbimin e informacionit mes Programit Kombëtar të Tuberkulozit dhe programeve të ngjashme apo të tjera brenda dhe jashtë Njësisë bazë (Njësisë bazë (Departamentit))
- Bashkëpunuar me faktorin ndërkombëtar për të siguruar mbështetje teknike dhe financiare për të parandaluar përhapjen e tuberkulozit.
- Kryer kërkime shkencore në fushën e tuberkulozit, përhapjes dhe prandalimit dhe kontrollit të tij.
- Përgatitur standardet e funksionimit të parandalimit dhe kontrollit të tuberkulozit pranë operatorit të kujdesit shëndetësor dhe në veçanti NJVSKH.
- Përgatitur standardet e edukimit në vazhdim për kontrollin e tuberkulozit sipas profesioneve.

- Koordinuar fushatat e ndërgjegjësimit dhe promovimit duke përfshirë ditën ndërkombëtare të tuberkulozit.
- Koordinuar dhe monitoruar veprimtarinë e shërbimeve kujdesit shëndetësor, diagnozës, trajtimit dhe parandalimit të infeksionit spitalor për tuberkulozin me spitale, dispanseritë përkatëse, mjekun e familjes dhe shërbimet e epidemiologjisë pranë NJVKSH-së.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Koordinon programin kombëtar të Tuberkulozit (TB) në të gjithë vendin me të gjithë aktorët brenda ISHP-së, MSHMS dhe strukturave të saj dhe jashtë saj, brenda strukturave qeveritare ose me shoqërinë civile.

Prodhon raportin kombëtar të TB.

Koordinon përgatitjen e të gjitha dokumenteve ligjore dhe teknike që lidhen me TB.

Koordinon survejancën epidemiologjike të integruar të TB dhe përmirëson vazhdimisht elemente të saj.

Kontrollon cilësinë e të dhënave dhe i vlerëson ato dhe burimet e tyre për TB.

Kryen hetime epidemiologjike në lidhje me TB.

Koordinon të gjitha iniciativat e parandalimit të TB në vend dhe siguron ndërlidhjen e programit të TB me atë HIV/AIDS.

Vlerëson zbatimin e ligjshmërisë në fushën e TB, kontrollit dhe survejancës dhe trajtimit.

Ndjek reformën dhe ndryshimet në programin e TB në vend dhe koordinon punën me laboratorët diagnostikë të TB duke prodhuar raporte kombëtare vjetore për këtë.

Prodhon buletinet tremujore të survejancës së TB.

Kryen kërkime shkencore në fushën e parandalimit dhe survejancës së TB.

Ndjek dhe monitoron zbatimin e projekteve të Fondit Global ndaj TB dhe të donatorëve të tjerë.

Ofron shërbime të këshillimit në fushën e zbatimit të programeve të parandalimit të TB për të gjitha grupet.

Raporton pranë ECDC/ËHO për TB.

Përshkrimi i punës: Specialist/ Me Titull /Gradë

Ndihmon në survejancën dhe siguron cilësinë e të dhënave për Tuberkulozin (TB).

Kryen kontrollin e cilësisë së të dhënave të TB në sistemin SISI.

Kryen vlerësimin social të impaktit të TB.

Kryen vlerësimin e shërbimeve sociale për TB dhe cilësisë së tyre për të gjithë grupet e popullatave.

Merr pjesë në kryerjen e survejancës së sjelljeve dhe i monitorojnë ato në grupe të ndryshme të popullatës për TB në bashkëpunim me HIV/AIDS.

Kryejnë kërkime shkencore në fushën e shkencave sociale për TB dhe HIV/AIDS.

Kryen monitorimin e materialeve të edukimit për TB, dhe zbatimin e tyre.

Ndihmon në fushën e edukimit shëndetësor për TB.

Kryen monitorimin e medias për TB dhe prodhon raporte periodike për këtë problem.

Ndihmon dhe koordinon në përgatitjen e standardeve dhe kurrikulave të edukimit të vazhduar për TB, si dhe edukimit në shkolla dhe komunitete.

Kryen kërkime në fushën parandalimit dhe kujdesit social për TB.
Koordinon kalendarin e veprimeve të ditës ndërkombëtare të TB.

Përshkrimi i punës: Specialist

Kontrollon dhe vlerëson të dhënat për çdo pacient me tuberkuloz (TB). Kontrollon dhe hedh në databazën e rasteve me TB të dhënat apo i plotëson ato për të gjitha NJVKSH-të, gjatë gjithë vitit. Përgatit raporte periodike për TB, në bazë të databazës së rasteve sipas formatit të përcaktuar dhe bën gati këto të dhëna për shpërndarje të mëtejshme, nëse duhet.

Monitoron cilësinë e punës të stafit përgjegjës për mbajtjen e regjistrave të TB të dispanserive dhe SUSM, si dhe për çdo NJVKSH, siguron raportimin e tyre pranë ISHP-së çdo tre muaj.

Trajnon dhe siguron hedhjen e të dhënave në sistemin SISI për TB nga çdo NJKVSH, apo ofrues i kujdesit shëndetësor që raporton raste me TB, kontrollon edhe ndërlidhjen me laboratorin apo testimet.

Lehtëson takimet me pacientë dhe familjarë të tyre për njohjen sa më mirë të TB.

Ndjek dhe siguron databazën e materialeve sensibilizuese për popullatën e përgjithshme dhe grupeve vulnerabël (romët, të burgosur), si dhe të studimeve kombëtare në fushën e TB.

Vlerëson koordinimin e punës në çdo NJVKSH midis aktorëve kryesore, në zbatim të programit të miratuar të monitorimit.

Ndihmon në përgatitjen e raportit kombëtar vjetor të TB, si dhe raporteve të tjera.

Përgatit raport/artikuj për publikim në buletin e ISHP-së në bashkëpunim me punonjësit e tjerë të sektorit.

Lehtëson dhe organizon takimet midis aktorëve kryesore të parandalimit, kontrollit dhe trajtimit të Tuberkulozit në vend dhe përgatit raportet përkatëse të tyre.

Siguron të dhënat nga TB i kafshëve duke bashkëpunuar me sektorin e intelgjencës epidemike ISUV dhe njësinë e epidemiologjisë pranë Ministrisë së Bujqësisë.

Koordinon kalendarin e veprimeve të ditës ndërkombëtare të TB.

21.5.Sektori Programit të Kontrollit të Infeksioneve spitalore

Misioni

Përmirësimi i shëndetit të popullatës përmes kontrollit të infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor për të rritur sigurinë e pacientit dhe zvogëluar sëmundshmërinë. gjymtimin dhe vdekjen nga këto infeksione apo sëmundje të cilat mund të parandalohen përmes praktikave të ndryshme të mira dhe të sigurta të kujdesit shëndetësor, duke ofruar një program kombëtar koordinues cilësor të kontrollit të infeksioneve, i cili përmirëson vazhdimisht gamën e shërbimeve të tij dhe përmirëson mirëqenien e sigurinë në institucionet e kujdesit shëndetësor.

Vizioni

Përmirësim i menaxhimit të programit të kontrollit të infeksioneve spitalore për të arritur një standard të ri të cilësisë në të gjithë vendin në lidhje me kontrollin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe

sigurinë e pacientit duke përfshirë të gjitha elementet përbërës të këtij programi, si: koordinimin e monitorimit mjedisor, infeksioneve dhe rezistencës antimikrobike, koordinimin dhe zbatimin e elementëve të tjerë të kontrollit - dezinfektimin, menaxhimin e mbetjeve spitalore etj., organizimin në institucionet e kujdesit shëndetësor, edukimin në vazhdim dhe elemente të tjerë.

Baza ligjore:

-Ligji nr. 15/2016 datë 10.3.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”,

-Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”.

Detyrat e këtij sektori janë:

- Monitorimi dhe vlerësimi i infeksioneve spitalore në lidhje me kujdesin shëndetësor në të gjithë vendin.
- Monitorimi, vlerësimi dhe kontrolli i pranisë së prezencës së mikroorganizmave patogene në mjediset e lidhur me kujdesin shëndetësor në të gjithë vendin duke përfshirë institucionet publike dhe private.
- Monitorimi dhe vlerësimi i rezistencës antimikrobike në institucionet e kujdesit shëndetësor në bashkërendim dhe bashkëpunim me sektorë të tjerë të Njesisë bazë (Departamentit) dhe ISHP-së.
- Nxitja dhe mbështetja e vendosjes së njësive të kontrollit të infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor në të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor në të gjithë vendin.
- Monitorimi i aktivitetit dhe raportimit të njësive vendore të kujdesit shëndetësor në lidhje me kontrollin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor.
- Zhvillimi dhe përditësimi i standardeve për kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor në të gjithë vendin.
- Kryerja e ekspertizës, vlerësimi, monitorimi dhe hetimi i infeksioneve spitalore në lidhje me kujdesin shëndetësor në të gjithë vendin në bashkëpunim me sektorin e epidemiologjisë, si dhe sektorë të tjerë të Njesisë bazë (Departamentit) dhe ISHP-së.
- Përgatitja, planifikimi dhe zbatimi i studimeve për përcaktimin e prevalencës dhe faktorëve shkaktarë të infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor në spitale në bashkëpunim me sektorë të tjerë të Njesisë bazë (Departamentit) dhe ISHP-së.
- Monitorimi i vazhdueshëm i protokollit të larjes së duarve dhe pastërtisë së tyre në spitale, dhe institucione të kujdesit shëndetësor.
- Monitorimi i vazhdueshëm dhe survejanca laboratorike e infeksioneve të plagëve operatore në të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor në vend.
- Vlerësimi dhe monitorimi i efikasitetit të solucioneve dezinfektues dhe sterilizues, dhe i programeve të dezinfektimit dhe sterilizimit në të gjithë vendin.
- Përgatitja e rekomandimeve përkatëse për parandalimin e infeksioneve spitalore dhe pezullimin e përkohshëm të aktivitetit mjekësor në sallat operatore, në pavione, në sallat e lindjes dhe ato të aborteve, të spitaleve publike ose private, kur ngarkesa dhe ndotja mikrobike e tyre tejkalon kufijtë e lejuar, deri në normalizimin e situatës nga sterilizimi dhe dezinfektimi efektiv në bashkëpunim me inspektoratin shëndetësor shtetëror.

- Përgatitja e udhëzuesve dhe procedurave standarde për të gjithë elementët e lidhur me kontrollin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor.
- Koordinimi dhe organizimi i programeve të edukimit në vazhdim për infeksionet e lidhura me kujdesin shëndetësor.
- Përgatitja e ndërhyrjeve që përmirësojnë programin e kontrollit të infeksioneve në institucionet e kujdesit shëndetësor.
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve me sektorë të tjerë brenda departmentit dhe jashtë tij në lidhje me kontrollin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor, survejancën e tyre dhe survejancën e rezistencës antimikrobike apo elementë dhe ndërhyrje të tjera.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Koordinon survejancën e infeksioneve spitalore dhe kontrollin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor në vend dhe hetimin e këtyre infeksioneve apo problemeve të lidhura me gjendjen në spitale në lidhje me higjienën, dezinfektimin dhe ruajtjen e kushteve përkatëse të kontrollit, si dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme në kuadër të ligjeve në fuqi dhe rregullores ndërkombëtare të shëndetit apo organizmave të tjerë ndërkombëtare e të tjerë sipas detyrimit të vendit. Kryen kërkime shkencore në këto fusha dhe merr pjesë në edukimin e vazhduar në fushën përkatëse. Kryen konsulencën kombëtare për kontrollin e infeksioneve spitalore në vend, si dhe ndërkombëtare kur i kërkohet, sipas detyrimeve që ka vendi. Përgatit raporte për kontrollin e infeksioneve spitalore të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe masat që duhet të merren apo ato që janë marrë. Raporton pranë shefit të Njesisë bazë (Njesisë bazë (Departamentit))

Përshkrimi i punës: Specialist/ Me Titull /Gradë

Koordinon survejancën e infeksioneve spitalore dhe kontrollin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor në vend dhe hetimin e këtyre infeksioneve apo problemeve të lidhura me gjendjen në spitale në lidhje me higjienën, dezinfektimin dhe ruajtjen e kushteve përkatëse të kontrollit, si dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme në kuadër të ligjeve në fuqi dhe rregullores ndërkombëtare të shëndetit apo organizmave të tjerë ndërkombëtare e të tjerë sipas detyrimit të vendit. Kryen kërkime shkencore në këto fusha dhe merr pjesë në edukimin e vazhduar në fushën përkatëse. Kryen konsulencën kombëtare për kontrollin e infeksioneve spitalore në vend, si dhe ndërkombëtare kur i kërkohet sipas detyrimeve që ka vendi. Përgatit raporte për kontrollin e infeksioneve spitalore të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe masat që duhet të merren apo ato që janë marrë. Raporton pranë shefit të Njesisë bazë (Njesisë bazë (Departamentit))

Merr pjesë në survejancën dhe identifikimin e agjentëve mikrobike në mjediset ku ofrohet kujdesi shëndetësor në vend dhe merr pjesë me hetimin e këtyre infeksioneve apo problemeve të lidhura me gjendjen në spitale, si: me higjienën, dezinfektimin dhe ruajtjen e kushteve përkatëse të mjedisit spitalor. Kryen kërkime shkencore në këto fusha dhe merr pjesë në edukimin e vazhduar në fushën përkatëse. Kryen konsulencën kombëtare për kontrollin e infeksioneve spitalore në vend, si dhe ndërkombëtare kur i kërkohet sipas detyrimeve që ka vendi. Kryen izolimet mikrobiologjike dhe identifikon agjentët përkatës, si dhe kryen

studime për rezistencën ndaj antibiotikëve. Përgatit raporte për agjentët bakterialë të izoluar në mjediset e lidhura me kujdesin shëndetësor dhe masat që duhet të merren apo ato që janë marrë. Raporton pranë shefit të Njesisë bazë (Njesisë bazë (Departamentit))

Përshkrimi i punës: Laborant

Zbatojnë me përpikmëri protokollet e identifikimit të agjentëve të ndryshëm bakterialë në mjediset spitalore apo të lidhura me kujdesin shëndetësor, plagët e ndryshme etj. Ruajnë mjedisin dhe biosigurinë në laborator. Zbatojnë teknikat e reja të përgatitura dhe procedurat standarde të veprimit për laboratorin. Marrin pjesë në procesin e ardhjes, procedimit të mostrës dhe më pas identifikimit apo ruajtjes së saj, apo ruajtjes së shtameve në kushtet e duhura sipas protokolleve standarde. Plotësojnë dokumentacionin përkatës të laboratorit sipas procedurave standarde. Njoftojnë për çdo aksident në laborator personelin e lartë, shefin e laboratorit, shefin e Njesisë bazë (Departamentit) dhe titullarin e ISHP-së. Kryejnë flebotomi dhe marrin pjesë në hetime epidemilogjike. Njohin me saktësi teknikat bakteriologjike.

21.6.Sektori i Programit Kombëtar të Kontrollit të Vektorëve

Misioni

Përmirësimi i shëndetit të popullatës përmes kontrollit të vektorëve dhe identifikimit të disa agjentëve patogenë që transmetohen përmes tyre për të zvogëluar sëmundshmërinë, gjymtimin dhe vdekjen nga infeksione apo sëmundje që transmetohen më anë të vektorëve, duke ofruar një program kombëtar koordinues cilësor të kontrollit të vektorëve.

Vizioni

Përmirësim i menaxhimit të programit kombëtar të kontrollit duke rekomanduar dhe ofruar atë në çdo nivel (kombëtar, bashki, komuna, qendra shëndetësore) përmes teknikave dhe metodologjive më të mira bashkëkohore të sigurta nëpërmjet shërbimeve të ndryshme.

Baza ligjore:

- Ligji nr. 15/2016, “Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive”.
- Ligji nr.10 138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”.
- Ligji nr.7761, datë, 19.10.1993 “Për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.
- Ligji nr. 95/2015 “Për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik”.

Sektori menaxhon programin kombëtar të kontrollit të vektorëve duke:

- Përgatitur listën e vektorëve prioritar të vendit dhe metodat për kontrollin e tyre.
- Përgatitur programin e survejancës entomologjike sipas vektorëve prioritarë dhe monitoruar zbatimin e saj.

- Përgatitur programin e monitorimit entomologjik përpara dhe pas kontrollit të vektorëve dhe monitorimin e zbatimit të tij.
- Vlerësimin e faktorëve të riskut.
- Përgatitur dhe propozuar strategjitë dhe programet e integruara të kontrollit të vektorëve.
- Përgatitur përgjigjen ndaj shpërthimeve epidemike për sëmundjet që transmetohen nga vektorët në lidhje me kontrollin e vektorëve të caktuar duke bashkëpunuar me sektorë të tjerë brenda Njesisë bazë (Departamentit) ose jashtë tij, si me pushtetin lokal apo sektorë në ministri të tjera.
- Përgatitur udhëzuesit dhe procedurat standarde të kontrollit të vektorëve.
- Zbatuar në mënyrë specifike ligjshmërinë si më poshtë:
 - Në zbatim të *Ligjit nr. 95/2015, neni 15 pika 1, shkronja "a"*:
 - a) monitorim i dëmtuesve të shëndetit publik, përcaktim i statusit të tyre, i metodave të kontrollit dhe informim i ministrit përgjegjës për shëndetësinë;
 - Në zbatim të *Ligjit nr. 95/2015, neni 15 pika 1 pika b*:
 - b) survejancë / monitorim entomologjik i vektorëve dhe rodentologjik i gjitarëve të vegjël (brejtës dhe insektivorë) në të gjithë territorin e vendit për identifikimin e dëmtuesve të shëndetit publik duke përcaktuar dhe masat e kontrollit;
 - c) krijon dhe përditëson bazën e të dhënave lidhur me përhapjen gjeografike dhe sezonale të vektorëve dhe gjitarëve të vegjël;
 - d) përditëson hartëzimin e përhapjes së vektorëve dhe gjitarëve të vegjël në Shqipëri;
 - e) përgatit udhëzues mbi survejancën dhe kontrollin e integruar të vektorëve dhe gjitarëve të vegjël;
 - Në zbatim të *Ligjit nr. 95/2015, neni 15 pika 1, shkronja "ç"*:
 - f) përgatit kurrikula dhe kryen trajnimin e përdoruesve profesionistë të shërbimit të produkteve biocide në shëndetin publik;
 - Në zbatim të *Ligjit nr. 95/2015, neni 15 pika 1, shkronja "d"*:
 - g) përgatit kurrikula dhe trajnon personelin në institucionet e varësisë, përgjegjës për monitorimin e shërbimit të produkteve biocide në shëndetin publik;
 - Në zbatim të *Ligjit nr. 95/2015, neni 15 pika 1, shkronja "dh"*:
 - h) kryen vlerësimin e produkteve biocide gjatë dhe pas procedurës së autorizimit;
 - Në zbatim të *Ligjit nr. 95/2015, neni 15 pika 1, shkronja "e"*:
 - k) kryen hulumtime me eksperimente, ekzaminime të lëndëve, ndikimeve dhe efekteve, në kushtet e monitorimit entomologjik, në mënyrë që hulumtimet shkencore të jenë të ndërlidhura me zhvillimin e produkteve biocide të reja dhe teknikave inovative të kontrollit të vektorëve.
 - Në zbatim të *Urdhrit i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 202, Prot. 3808, datë 23.05.2014*:
 - a) ofron asistencë teknike Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi procesin e autorizimit të importit të produkteve biocide (insekticide dhe rodenticide).
 - b) konsulencë teknike për hartimin e strategjive dhe programeve të integruara të kontrollit të vektorëve dhe gjitarëve të vegjël;
 - c) të vlerësojë efikasitetin e masave të kontrollit të zbatuara në vend për vektorët dhe brejtësit e vegjël nëpërmjet monitorimit entomologjik dhe rodentologjik;

- d) të vlerësojë shkallën e sensitivitetit të vektorëve ndaj biocideve (insekticido-rezistenca) dhe brejtësve-rezervuarë ndaj raticideve (raticido-rezistenca);
- e) studime kërkimore shkencore mbi fenotipin, gjenotipin, bioekologjinë dhe kapacitetin vektorial të vektorëve;
- f) studime kërkimore mbi taksonominë e mamalëve të vegjël (Mammalia: Rodentia dhe Insektivora), kapacitetin rezervuar dhe rolin e tyre në përhapjen e sëmundjeve infektive si Leptospirozë (bakteri spiroket leptospira spp.) dhe viruseve Hantaan (Dobrava, Seoul, Puumala, Tula);
- g) studime mbi bioekologjinë dhe dinamikën e brejtësve komensalë (minjtë e zonave të banuara) në zonat urbane dhe rurale.

Në zbatim të Ligjit nr. 15/2016 për "Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive":

- a) përcakton, konfirmon, monitoron, përgjigjen ndaj shpërthimeve dhe sigurimin e evidencës shkencore për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve zoonotike dhe të transmetuara nga vektorët.
- b) siguron për laboratorët e tjerë materiale referente laboratorike dhe protokolle diagnostike sipas standardeve ndërkombëtare.
- c) siguron ekspertizën dhe këshillimin shkencor për laboratorët e tjerë në këtë fushë dhe jo vetëm, me anë të mbështetjes shkencore, informacioneve, rekomandimeve, trajnimeve.
- d) vendos kontakte, bashkëpunon dhe bëhet pjesë e rrjeteve laboratorike kombëtare, rajonale, ndërkombëtare për sëmundje të caktuara dhe shkaktarë të caktuar sipas fushës që mbulon, si dhe merr pjesë në rrjete dhe projekte për kërkim dhe zhvillim të cilat kontribuojnë në survejancën ndërkombëtare.
- e) siguron mbështetje dhe këshillime teknike në raste të shpërthimeve epidemiologjike dhe dukurive të pazakonta.
- f) përditëson metodat diagnostike për konfirmimin e shkaktarit etiologjik/ duke përdorur ato të rekomanduara nga OBSH-ja dhe institucionet ndërkombëtare të referencës në këtë fushë.
- g) zotëron pajisjet dhe bazën materiale të duhur për kryerjen e diagnozës konfirmuese.
- h) kryen trajnime për rritjen e aftësive profesionale bashkëkohore.

Në zbatim të Ligjit nr. 95/2015, neni 15 pika 1, shkronja "c":

- a) të përgatisë vlerësimin dhe kushtet që duhen për të kryer provat biologjike të efektivitetit dhe analizat fiziko-kimike të produkteve biocide, për monitorimin e tyre;
- Përgatit udhëzimet në lidhje me identifikimin agjentëve patogene tek vektorët apo njeriu, si dhe qenie të tjera duke bashkëpunuar me sektorë të tjerë në kuadrin e përjasjes në shëndet.
- Të ofrojë shërbime diagnostike dhe identifikuese apo të seroprevalencës në lidhje me disa agjentë infektivë që transmetojnë vektorët, si dhe për vektorët duke bashkëpunuar brenda dhe jashtë Njesisë bazë (Njesisë bazë (Departamentit))
- Monitoruar cilësinë e punës në lidhje me kontrollin e vektorëve në operatorin qendror dhe lokal të shërbimit shëndetësor, dhe më tej, në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor (NJVKSH), pushtetin lokal apo në sektorë të tjerë publik dhe privat.
- Kryen koordinimin trajnimit e vazhdueshëm në fushën e entomologjisë mjekësore.

- Përgatiten ndërhyrje që përmirësojnë kontrollin e vektorëve dhe efektivitetin e tij në çdo nivel.
- Përgatiten raporte kombëtare vjetore apo sipas problematikës, si dhe ndërkombëtare në lidhje me vektorët, survejancën dhe kontrollin e tyre.
- Bashkëpunon me sektorë të tjerë brenda departmentit dhe jashtë tij me sektorë të tjerë si dhe rrjete kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadrin e përqasjes një shëndet.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Koordinon të gjithë procesin e monitorimit entomologjik në vend, hartëzimin dhe identifikimin e vektorëve. Kryen kërkime shkencore në lidhje me vektorët, rezistencën e tyre, identifikimin dhe llojet e reja apo adaptimin e tyre në lartësi, mjedise apo kushte klimatike të ndryshme. Konsulton në lidhje me programet e kontrollit të vektorëve dhe koordinon veprimet kombëtare të kontrollit dhe luftës ndaj vektorëve.

Përshkrimi i punës: Specialist/ Me Titull /Gradë

Harton dhe kryen monitorimin entomologjik në vend, hartëzimin dhe identifikimin e vektorëve. Kryen kërkime shkencore në lidhje me vektorët, rezistencën e tyre, identifikimin dhe llojet e reja apo adaptimin e tyre në lartësi, mjedise apo kushte klimatike të ndryshme. Konsulton në lidhje me programet e kontrollit të vektorëve dhe merr pjesë në veprimet kombëtare të kontrollit dhe luftës ndaj vektorëve.

Kryen identifikimin dhe konfirmin parazitëve të ndryshëm duke përdorur metodat e kapjes direkte, kulturave, serologjisë dhe teknikave të tjera. Përgatit standardet dhe procedurat e punës për këta shkaktarë dhe konfirmimin e tyre. Kryen koordinimin e studimeve të lidhura me parazitozat në Shqipëri. Vlerësojnë praktikën më të mira laboratorike. Përgatit dhe zbaton protokollet e reja laboratorike. Merr pjesë në hetimet epidemiologjike. Kryen kërkim shkencor në fushën e parazitologjisë dhe sëmundjeve prioritare si: Leishmanioza, Toksoplazmoza, Leptospiroza, Ekinokoza, dhe merr pjesë në proceset e edukimit të vazhduar. Dokumenton me përpikmëri çdo veprim dhe testim të kryer në laborator sipas metodikës përkatëse. Njofton për çdo aksident në laborator personelin e lartë, shefin e laboratorit, shefin e Njesisë bazë (Departamentit) dhe titullarin e ISHP-së.

Përshkrimi i punës: Laborant

Ndihmon në monitorimin entomologjik në vend, hartëzimin dhe identifikimin e vektorëve. Kryen përgatitjen për teknikat që përdoren në terren për identifikimin e vektorëve. Kryen aplikimin e metodave të monitorimit entomologjik dhe vlerëson aplikimin e kontrollit të vektorëve në terren. Mirëmban laboratorin e entomologjisë mjekësore.

21.7.Sektori i Survejancës Laboratorike të Sëmundjeve Emergjente Virale

Misioni

Përmirësimi i shëndetit të popullatës përmes survejancës laboratorike dhe diagnozës së sëmundjeve virale e në veçanti, ato emergjente për të zvogëluar sëmundshmërinë, gjymtimin dhe vdekjen prej tyre.

Vizioni

Përmirësim i identifikimit të agjentëve mikrobikë viral, sidomos atyre emergjente dhe përhapjes së tyre, duke përmirësuar metodat e identifikimit dhe futur teknologjitë e reja si struktura e vetme e referencës dhe ekspertizës në diagnostikën e Sëmundjeve Emergjente Virale në fushën e shëndetit publik në Shqipëri.

Ky sektor përbëhet nga një sërë laboratorësh të njohura zyrtarisht dhe akredituara si pjesë e Programeve Globale të survejancave laboratorike të monitoruara nga OBSH-ja, apo organizma të tjerë ndërkombëtare që janë:

- Laboratori i PoliomiELIT, Totaviruseve dhe Enteroviruseve të tjera
- Laboratori i Fruth-Rubeolës dhe ekzantemave të tjera virale
- Laboratori i Gripit dhe viruseve të tjera respiratore
- Laboratori i Arboviruseve

Baza ligjore:

- Ligji nr. 15/2016 datë 10.3.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”,
- Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”

Detyrat kryesore të këtij sektori konsistojnë në:

- Koordinimin e survejancës laboratorike për survejancën laboratorike për të gjitha sëmundjet emergjente virale.
- Zhvillimin, përmirësimin dhe zbatimin e survejancës laboratorike për të gjitha sëmundjet emergjente virale.
- Përgatitjen e metodologjive të reja në zhvillimin dhe zbatimin e survejancës laboratorike për të gjitha sëmundjet emergjente virale.
- Zhvillimin, përmirësimin dhe përditësimin në sasi dhe cilësi të diagnostikës laboratorike dhe realizimin e objektivave përkatës të bashkëpunimit me OBSH-(Rajoni Europian), CDC (Qendra e Kontrollit të Sëmundjeve, USA), ECDC, ENIVD etj., lidhur me certifikimin periodik të tyre prej këtyre agjencive, apo organizmave të tjera ndërkombëtare.
- Kryerjen e diagnostikës laboratorike dhe dhënien e ekspertizës teknike në shkallë vendi të sëmundjeve infektive virale emergjente nëpërmjet përdorimit të metodave bashkëkohore.
- Kryerjen e ekspertizës diagnostike në shkallë vendi duke përfshirë këtu edhe trajnimin periodik të personelit teknik në lidhje me survejancën laboratorike për të gjitha sëmundjet emergjente virale.
- Përgatitjen dhe kryerjen e studimeve epidemiologjike/sero-epidemiologjike në bashkëpunim të ngushtë me sektorët e tjerë përbërës të këtij departamenti dhe me departamentet e tjera të ISHP-së.

- Raportimin në kohë reale të rezultateve të interpretuara tëurvejancave laboratorike përkatëse si brenda Njesisë bazë (Departamentit), ashtu edhe jashtë tij në strukturat/agjencitë përkatëse.
- Mirëmbajtjen e databazës së të dhënave laboratorike dhe kryerjen e analizave të rezultateve dhe shkëmbimin e informacionit me sektorin e epidemiologjisë dhe të tjerë brenda Njesisë bazë (Njesisë bazë (Departamentit))
- Sigurimin e biosigurisë dhe biosigurimit të laboratorit duke zbatuar udhëzuesit përkatës dhe patur përherë e zbatuar strategjinë përkatëse të laboratorit.
- Sigurimin dhe monitorimin e kontrollit të cilësisë duke u mbështetur në udhëzuesin dhe planin përkatës të laboratorit.
- Sigurimin e transportit të mostrave dhe dërgesave të materialeve infektive brenda e jashtë vendit, në mënyrë korrekte e sipas rregulloreve standarde ndërkombëtare.
- Vlerësimin e riskut gjatë manipulimit në laborator me agjentët që paraqesin rrezikshmëri (Gr 2,3,4) si dhe dokumentimi i tyre.
- Përgatitjen e terreneve dhe mirëmbajtjen e linjave qelizore për nevojat e laboratorit.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Koordinon të gjithë punën që kryhet në laboratorët kombëtarë të referencës pranë ISHP-së, cilësinë e saj dhe zbatimin e detyrave të çdo laboratorit. Planifikon dhe përgatit nevojat dhe listat për përmbushjen e këtyre nevojave për të siguruar shërbim cilësor laboratorik. Koordinon me shefin e Njesisë bazë (Departamentit) dhe epidemiologët për vlerësimin e nevojave dhe prioriteteve. Përcakton standardet kombëtare të laboratorëve të shëndetit publik dhe diagnozës mikrobiologjike në vend. Kryen kontrollin e këtyre standardeve dhe përmbushjen e kushteve të biosigurisë dhe kontrollit të cilësisë. Përgatit raportin kombëtar të aktivitetit të laboratorëve të shëndetit publik. Koordinon vlerësimin e zbatimit të protokolleve dhe ligjshmërisë në të gjitha laboratorët e vendit.

Përshkrimi i punës: Specialist/ Me Titull /Gradë

Kryen identifikimin e agjentëve viral të sëmundjeve të ndryshme dhe gjatë hetimeve apo shpërthimeve epidemike. Përgatit standardet dhe procedurat e punës për identifikimin e agjentëve viral. Kryen koordinimin e mirëmbajtjes dhe pasazhimit të linjave qelizore dhe proceset që kryhen ndaj vezëve të embrionuara. Vlerësojnë praktikën më të mira laboratorike. Përgatisin dhe zbatojnë protokollin e reja laboratorike. Marrin pjesë në hetimet epidemiologjike. Kryejnë kërkim shkencor në fushën e virologjisë dhe marrin pjesë në proceset e edukimit të vazhduar. Dokumentojnë me përpikëri çdo veprim dhe testim të kryer në laborator sipas metodikës përkatëse. Njoftojnë për çdo aksident në laborator personelin e lartë, shefin e laboratorit, shefin e Njesisë bazë (Departamentit) dhe titullarin e ISHP-së.

Përshkrimi i punës: Specialist (menaxher laborator) me Titull/Gradë

Asiston shefin e Njesisë bazë (Departamentit) dhe shefin e sektorit për të evidentuar problemet dhe përgjigjet për gjendjen e kiteve, reagenteve dhe mirëfunksionimin e laboratorit. Koordinon punën e laborantëve dhe

ndërlidhjen me persona të tjerë, si dhe përgatit planet e burimeve njerëzore me shtesat e tyre në rast ngjarjesh të jashtëzakonshme apo sipas rastit, identifikon në kohë nevojat e laboratorit dhe koordinon me magazinën përkatëse. Përditëson gjendjen e kiteve dhe reagenteve në laborator dhe vlerëson kërkesën dhe ofrimin e shërbimit, nevojat përkatëse me gjendjen në çdo kohë. Përgatit raporte vjetore të përdorimit të kiteve dhe reagenteve dhe problemeve të hasura duke propozuar zgjidhjet përkatëse. Raporton pranë shefit të laboratorëve, shefit të Njesisë bazë (Departamentit) dhe titullarit të institucionit në çdo kohë.

Përshkrimi i punës: Laborant

Zbatojnë me përpikëri protokollet e identifikimit të agjentëve viral. Ruajnë mjedisin dhe biosigurinë në laborator. Zbatojnë teknikat e reja të përgatitura dhe procedurat standarde të veprimit për laboratorin e virologjisë. Marrin pjesë në procesin e ardhjes, procedimit të mostrës dhe më pas identifikimit apo ruajtjes së saj apo shtameve përkatëse, dhe mbajnë përgjegjësi për ruajtjen e tyre në kushtet e duhura sipas protokolleve standarde. Plotësojnë dokumentacionin përkatës të laboratorit sipas procedurave standarde. Kryejnë flebomi dhe marrin pjesë në hetimin epidemiologjik. Njoftojnë për çdo aksident në laborator personelin e lartë, shefin e laboratorit, shefin e Njesisë bazë (Departamentit) dhe titullarin e ISHP-së.

Neni 22

NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I LABORATORËVE TË REFERENCËS KOMBËTARE

Departamenti është i organizuar në tre sektorë:

22.1. Sektori i Laboratorëve të Referencës Kombëtare për Kontrollin e Sëmundjeve Infektive

Ka në përbërje këta laboratorë:

- 1- Laboratori i Imunologjisë (HIV/AIDS dhe Hepatitet Virale)
- 2- Laboratori i Bakteriologjisë dhe Mykologjisë
- 3- Laboratori Biologjisë Molekulare
- 4- Laboratori i Parazitologjisë
- 5- Laboratori i Preparatorisë, Prodhimit të Antigeneve dhe Serumeve Diagnostike

Laboratorët e Institutit të Shëndetit Publik janë Laboratorë Reference (Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për Shëndetin Publik".

Referencë për diagnozën

- Staf i Laboratorëve të Referencës përbëhet nga mjekë mikrobiologë, biologë si dhe nga teknikët e laboratorit në përputhje me strukturat e ISHP-së.
Stafi specializohet, merr pjesë në trajnime e takime ndërkombëtare e kombëtare për rritje të aftësisë profesionale.

- Laboratorët e Referencës kryejnë konfirmimin e shkaktarit etiologjik dhe janë referencë diagnoze për të gjithë laboratorët e shëndetit publik dhe laboratorët e sektorit privat për shkaktarë të caktuar.
- Laboratorët e Referencës monitorojnë dhe bashkëpunojnë për cilësinë e diagnozës laboratorike me laboratorët mikrobiologjikë të shëndetit publik të vendit.
- Kryejnë me cilësi diagnozën laboratorike përmes përditësimit të herëpashershëm të protokolleve të diagnozës.
- Forcimin i kapaciteteve diagnostike përmes futjes së procedurave teknikave e materialeve diagnostikuese bashkëkohore.
- Janë përgjegjës për biosigurinë në ISHP dhe bashkëpunojnë dhe me laboratorët e aktorë të tjerë për rritjen e biosigurisë.

Referencë për materiale burimore

- Sigurojnë për laboratorët e tjerë materiale referuese (shtame laboratorike, izolime klinike, serume, etj.), si dhe protokolle të diagnozës të përgatitura e të miratuara këto në përputhje me standardet ndërkombëtare për standardizimin e metodave dhe rritjen e cilësisë së diagnozës laboratorike.
- Mbledhin të dhënat nga laboratorët e Shëndetit Publik për veprimtarinë dhe diagnozën e shkaktarëve mikrobiologjikë.

Këshillues shkencor

Laboratorët e Referencës janë koordininues për ekspertizë në fushën përkatëse për laboratorët e Shëndetit Publik. Japin informacion, këshilla, rekomandime dhe mbështetje shkencore për laboratorët dhe autoritetet e shëndetit publik dhe politikbërësit.

Ofrojnë kualifikim e trajnim për punonjësit e laboratorëve të shëndetit publik për marrjen, transportin e mostrave, trajtimin e mbetjeve, si dhe metodat e procedurat në fushën e diagnozës etj.

Sigurojnë kontrollin e cilësisë së jashtme për laboratorët e Shëndetit Publik.

Bashkëpunim

Vendos kontaktet me rrjetet laboratorike kombëtare, rajonale e ndërkombëtare për shkaktarët/sëmundjet të caktuara, si dhe përfshirja në netëorket e Bashkimit Europian (ECDC) apo nismave globale CDC, OBSH.

Monitorimi, gatishmëria dhe reagimi

Laboratorët e Referencës marrin pjesë në studime epidemiologjike dhe sero-epidemiologjike në bashkëpunim me sektorët dhe departamentet e tjera të ISHP-së.

Ndihmojnë Laboratorët e Shëndetit Publik dhe kontribuojnë në rastet e shpërthimeve epidemike me këshilla dhe mbështetje teknike për diagnozën etiologjike të këtyre ngjarjeve.

Laboratorët e Referencës sigurojnë dhe monitorojnë sigurimin e cilësisë së diagnozës mikrobiologjike në të gjithë laboratorët, përmes vlerësimit të cilësisë së produkteve dhe protokolleve të diagnozës.

Komunikon e vendos lidhje me departamentet e tjera në ISHP duke raportuar rregullisht për çdo dukuri të pazakontë të lidhur me diagnozën mikrobiologjike.

- Komunikimi e bashkëpunimi me aktorë të tjerë jashtë ISHP-së për zbulimin dhe përgjigjen e shpejtë ndaj ngjarjeve shëndetësore.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e Sektorit në bashkëpunim me Përgjegjës të Njësive Bazë dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore në ISHP.

Koordinon zbatimin e planit të punës kërkimore të laboratorëve në bashkëpunim me Përgjegjës të Njësive Bazë.

Zbaton planet e punës kërkimore-shkencore të sektorit në përputhje me vizionin/misionin dhe strategjinë/objektivat e Njësive Bazë, në bashkërendim dhe bashkëpunim me Përgjegjës të Njësive Bazë. Zbaton në kohë dhe me cilësi planet e punës në sektor, duke siguruar kushtet objektive për realizimin e tyre.

Mbikëqyr në çdo kohë zbatimin nga ana e personelit në laboratorët e sektorit, të rregullave të sigurimit teknik dhe higjienës.

Koordinon dhe mbikëqyr menaxhimin e mostrave që hyjnë në laborator.

Orienton dhe mbikëqyr aktivitetet lidhur me sigurinë dhe kontrollin e cilësisë së rezultateve të analizave.

Harton në bashkëpunim me specialistët përgjegjës, një Program për Kontrollin dhe Sigurinë e Cilësisë sipas standardeve të përcaktuara.

Harton në bashkëpunim me specialistët përgjegjës, një Program për Biosigurinë në Laboratorët e Sektorit sipas standardeve të përcaktuara.

Kujdeset për hartimin dhe zbatimin e programeve afatgjatë ose afatshkurtër dhe kërkesave për trajnim dhe rifreskim të njohurive për personelin e sektorit, si dhe për atë të laboratorëve të specialitetit në DSHP-të në rrethet.

Përgatit planet e punës dhe realizimet periodike sipas objektivave të Njësive Bazë dhe koordinimit me përgjegjës të Njësive Bazë, si dhe një plan vjetor për sektorin duke u mbështetur në planet individuale të laboratorëve, si edhe të stafit të specialistëve.

Harton kërkesat vjetore për mjete konsumi, materiale ndihmëse, reagente, qelqurina, standarde, pjesë këmbimi për aparaturat dhe literaturë, në bashkëpunim me stafin e specialistëve dhe të teknikëve të laboratorit, si dhe kujdeset për dorëzimin në kohë të tyre në Njësine Bazë.

Kujdeset për furnizim të rregullt periodik të laboratorëve që ka në përgjegjësi.

Plotëson çdo fundmuaj kohëshënuesin.

Propozon, kur është e nevojshme, për masa disiplinore në zbatim të rregullores së ISHP-së dhe Kodit të Punës.

Cakton një person përgjegjës në çdo laborator për komunikim me të.

I raporton në mënyrë periodike për aktivitetin e sektorit. Përgjegjësit të Njesisë Bazë, Titullarit, MSHMS-së. Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

1.1 Laboratori i Imunologjisë (HIV/AIDS dhe Hepatitet Virale)

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit. Harton dhe merr pjesë në tema studimore të laboratorit; merr pjesë në projekte kërkimore të institutit ose në bashkëpunim me institutet homologe apo institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Kryen ekzaminime laboratorike serologjike, konfirmon raste për diagnozë si laborator reference.

Merr pjesë në ndihmë të hetimeve epidemiologjike.

Ofron ekspertizë/konsulencë për çështje të diagnozës dhe kiteve diagnostikuese në rang vendi.

Harton Procedurat Standarde të Operimit (SOP) për analizat që mbulon në lidhje me diagnozën dhe konfirmimin laboratorik dhe kujdeset për zbatimin e tyre në nivel kombëtar.

Është përgjegjës për menaxhimin e teknikave laboratorike me të cilat punon, për mirëmbajtjen e pjesshme, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi.

Lajmëron përgjegjësin e laboratorëve dhe administratën e ISHP-së për defektet dhe nevojat për mirëmbajtje për teknikat laboratorike.

Harton dokumentacionin e kontrollit të cilësisë, merr pjesë në prova të zotësisë. Është përgjegjës për cilësinë e rezultateve të analizave të prodhuara në laborator dhe firmos raport-analizën.

Mban dokumentacion të rregullt për teknikat dhe për rezultatet e analizave të kryera sipas standardit përkatës. Zbaton Programin për Kontrollin dhe Sigurinë e Cilësisë dhe atë për Biosigurinë në Laborator sipas standardeve të përcaktuara.

Harton kërkesat periodike për kite dhe reagente diagnostik, mjete ndihmëse, pjesë këmbimi, materiale konsumi etj., për laboratorin dhe ia paraqet shefit të sektorit të laboratorëve.

Mbikëqyr sterilizimin, largimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rregulloreve përkatëse të biosigurisë.

Përgatit program trajnimi në specialitetin të cilit i përket dhe realizon trajnimet përkatëse për stafin e laboratorët mikrobiologjike të DRSHP-ve.

Merr pjesë në komisione e grupe pune për mbarëvajtjen e laboratorëve dhe ISHP. Përgatit program trajnimi për stafin e laboratorit në shkallë kombëtare dhe realizon trajnimet përkatëse.

Merr pjesë në komisione e grupe pune për mbarëvajtjen e laboratorëve dhe ISHP.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

Përgatit raporte periodike për Njësinë Bazë, Drejtorinë dhe institucionet e tjera.

Përshkrimi i punës: Laborant

Asiston specialistin mikrobiolog në punën analitike, duke marrë pjesë aktive në analizat laboratorike në zbatim të protokolleve të identifikimit të agjentëve të ndryshëm bakterial për të cilët përgjigjet. Kryen analiza mikrobiologjike për të cilat është trajnuar nga stafi përgjegjës i laboratorit, Përgatit materialet e nevojshme për kryerjen e analizave mikrobiologjike. Përgatit terrere, kryen sterilizime, mban regjistrin e mostrave dhe rezultatet e analizave rutinore dhe studimore, merr pjesë në furnizimin e vazhdueshëm të laboratorit me materialet ndihmëse e të konsumit. Mirëmban materialet biologjike siç janë shtamet dhe kulturat mikrobike të ruajtura, dhe etiketon çdo gjë sipas të dhënave të tyre. Zhdëmton materialet infekte sipas rregullave të asepsisë dhe sterilizimit. Mban në gjendje gatishmërie të gjitha aparaturat e laboratorit dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tyre. Është përgjegjës për larjen dhe trajtimin e qelqurinave sipas metodikave analitike. Mban pastër vendin e punës, bën pastrimin periodik të laboratorit dhe përgjigjet për pastërtinë dhe mbajtjen e rregullit në përgjithësi. Kujdeset për sterilizimin, largimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rregulloreve përkatëse të biosigurisë. Kryen furnizimin periodik të laboratorëve me materiale ndihmëse dhe konsumi dhe mban dokumentacion të rregullt për këtë. Menaxhon reagentet dhe qelqurinat në laborator duke mbajtur dokumentacion të rregullt për vendndodhjen, për harxhimin dhe vë në dijeni kimistët për nevojat për furnizim. Mban dokumentacion të rregullt (procesverbale) për nxjerrjen jashtë përdorimit të qelqurinave apo mjeteve të tjera ndihmëse. Merr pjesë aktive në inventarizimet vjetore të laboratorit në bashkëpunim me administratorin e Njësisë bazë (Departamentit) dhe komisionin përgjegjës për inventarin. Merr pjesë në trajnime periodike për metodika të reja pune dhe rifreskim dijesh. Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

1.2 Laboratori i Bakteriologjisë dhe Mykologjisë

***(Entrobakteret)**

Përshkrimi i punës: Specialist Me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit. Monitoron survejancën laboratorike në mbështetje të survejancës epidemiologjike kombëtare dhe në lidhje me sëmundjet/infeksionet diarreike dhe rezistencës bakteriale. Siguron ekspertizë laboratorike të specializuar në shpërthimet epidemike për izolimin dhe evidentimin në kohë të shkaktarit për të mundur marrjen e masave antiepidemike efektive në kohën e duhur.

Harton dhe vë në zbatim metodologjitë bashkëkohore diagnostikuese.

Ofron ekspertizë/konsulencë për ekzaminimet mikrobiologjike (bakteriologjike dhe serologjike) të rasteve (mostra dhe shtame) të dërguara nga NJVKSH-të.

Kontrollon cilësinë dhe biosigurinë në laborator.

Përfshirje në kërkim shkencor mbi enteropatogjenët potencialë dhe rezistencën bakteriale.

Diagnostikon dhe ndjek survejancën laboratorike mbi brucelozën në vend si laborator reference kombëtar, si dhe infeksionet/sëmundjet që paraqesin sindromin febril Tifo Abdominale dhe Tifo Rikéciozë.

Siguron ekzaminimin laboratorik të infeksioneve/sëmundjeve të rrezikshme si Anthrax, Pestis, Tularemi.

Trajnon stafin e laboratorëve të NJVKSH-ve mbi metodat laboratorike bashkëkohore në diagnozën mikrobiologjike.

Merr pjesë në konferenca, botime shkencore në revista, në median e shkruar, elektronike.

Përgatit raporte periodike për Njësinë Bazë, Drejtorinë dhe institucionet e tjera.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

***(Aerogenet)**

Përshkrimi i punës: Specialist Me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit. Kryen konsulencën kombëtare për problemet lidhur me identifikimin e shkaktarëve të sëmundjeve bakteriale infektive të fushave që mbulon.

Monitoron survejancën laboratorike në mbështetje të survejancës epidemiologjike kombëtare dhe në lidhje me shkaktarët bakterial të traktit respirator, urinar, gjenital, infeksionet e lëkurës dhe indeve të buta, ekzaminimin e likuorit truro-shpinor.

Siguron ekspertizë laboratorike të specializuar në shpërthimet epidemike për izolimin dhe evidentimin në kohë të shkaktarit për të mundësuar marrjen e masave antiepidemike efektive në kohën e duhur.

Kryen identifikimin e rezistencës ndaj antibiotikëve për shkaktarët bakterialë të identifikuar.

Harton dhe vë në zbatim metodologjitë bashkëkohore diagnostikuese.

Ofron ekspertizë/konsulencë për ekzaminimet mikrobiologjike (bakteriologjike dhe serologjike) të rasteve (mostra dhe shtame) të dërguara nga NJVKSH-të.

Kontrollon cilësinë dhe biosigurinë në laborator.

Kryen kërkime shkencore në këto fusha dhe merr pjesë në edukimin e vazhduar në fushën përkatëse.

Merr pjesë në përgatitjen e standardeve lidhur me identifikimin e shkaktarëve bakterialë të sëmundjeve infektive të fushës që mbulon.

Jep ndihmesë në kualifikimin e mjekëve të rretheve dhe përgatitjen e teknikëve të laboratorit në fushën e identifikimit të shkaktarëve bakterialë të sëmundjeve infektive.

Merr pjesë në konferenca, botime shkencore në revista, në median e shkruar, elektronike. Përgatit raporte periodike për Njësinë Bazë, Drejtorinë dhe institucionet e tjera.

Kryen testime të vazhdueshme të laborantëve në fushën e zbatimit të teknikave të mira laboratorike, si dhe njohjes dhe zbatimit të kërkesave lidhur me biosigurinë në laborator.

Kryen në mënyrë periodike pasazhimin e shtameve të izoluara për qëllime studimore.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

***(Mykologjia)**

Përshkrimi i punës: Specialist Me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit. Kryen konsulencën kombëtare për problemet lidhur me identifikimin e shkaktarëve të Infeksioneve Seksualisht të transmetueshme (IST) si *Gardnerella vaginalis*, *Trichomonas vaginalis* dhe të Mykozave vaginale.

Laborator reference për diagnozën dhe konfirmimin e rasteve të dyshuara për Sifiliz në rang vendi.

Siguron ekspertizë laboratorike të specializuar në shpërthimet epidemike për izolimin dhe evidentimin në kohë të shkaktarit për të mundësuar marrjen e masave antiepidemike efektive në kohën e duhur.

Harton dhe vë në zbatim metodologjitë bashkëkohore diagnostikuese.

Kontrollon cilësinë dhe biosigurinë në laborator.

Kryen kërkime shkencore në këto fusha dhe merr pjesë në edukimin e vazhduar në fushën përkatëse.

Merr pjesë në konferenca, botime shkencore në revista, në median e shkruar, elektronike.

Përgatit raporte periodike për Njësinë Bazë, Drejtorinë dhe institucionet e tjera.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

Përshkrimi i punës: Specialist

Kryen analiza për raste të emergjencave.

Harton Procedurat Standarde të Operimit (SOP).

Është përgjegjës për mirëmbajtjen e pjesshme, kalibrimin, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi.

Lajmëron përgjegjësin e laboratorëve dhe administratën e ISHP-së për defektet dhe nevojat për mirëmbajtje për teknikat laboratorike.

Mban dokumentacion të rregullt për laboratorin.

Harton kërkesat periodike për mjete ndihmëse, reagente, qelqurina, pjesë këmbimi, materiale konsumi etj., për laboratorin dhe ia paraqet shefit të sektorit të laboratorëve.

Kujdeset për largimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rregulloreve përkatëse.

Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete dhe trajnime që lidhen me punën në laborator dhe shëndetin e mjedisin.

Merr pjesë në komisione e grupe pune për mbarëvajtjen e laboratorëve të ISHP-së.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

1.3 Laboratori Biologjisë Molekulare

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Njesisë Bazë dhe Përgjegjësin e Sektorit.

Zhvillon aktivitete kërkimore diagnostike në lidhje me agjentët infektivë sipas prioriteteve të shëndetit publik në Shqipëri duke u fokusuar tek viruset dhe bakteret.

Zhvillon dhe përditëson në sasi dhe cilësi diagnozën laboratorike me metoda molekulare për agjentët viralë. Në kuadër të Programit Kombëtar të Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës, me VKM nr. 47, datë 30.1.2019, kryen detyrën e Laboratorit Qendror për depistimin me metoda molekulare të infeksionit me HPV. Hartimi i protokolleve të punës, si dhe hartimi i Procedurave të Standardeve të Punës (SOP) për mostrat që pranohen, përpunohen dhe analizohen në Laboratorin e Biologjisë Molekulare.

Dokumentimi me përpikëri i çdo veprimi dhe testimi të kryer në laborator sipas metodikës përkatëse. Njofton dhe komunikon për çdo problem apo aksident në laborator shefin e laboratorit, shefin e Njesisë bazë (Departamentit) dhe titullarin e ISHP-së.

Vlerëson praktikat më të mira laboratorike.

Identifikon metodat dhe teknikat më efikase të analizës për diagnostikimin, kontrollin dhe monitorimin e patogjeneve të rinj infektivë që paraqesin rrezikshmëri të lartë në shëndetin publik.

Kryerja e veprimtarive të tjera në zbatim të urdhrave të titullarit të institucionit dhe përgjegjësit të Njesisë Bazë, në lidhje me përpilimin e specifikimeve teknike, me përcaktimin e fondit limit dhe vlerësimin e ofertave për procedurat e tenderimit.

Pjesëmarrja në hetimet epidemiologjike. Përgatitja e raporteve për survejancën epidemiologjike të sëmundjeve infektive. Sigurimi i të dhënave të nevojshme për identifikimin e shtameve të reja infektive.

Përpunimi i rekomandimeve metodike për monitorimin (survejimin) epidemiologjik të shëndetit të popullatës.

1.4 Laboratori i Parazitologjisë

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Njesisë Bazë dhe Përgjegjësin e Sektorit.

Kryen konsulencë kombëtare për problemet lidhur me identifikimin e parazitëve të ndryshëm (përfshirë edhe ata zoonotikë), shkaktarëve të sëmundjeve parazitare infektive.

Monitoron survejancën laboratorike në mbështetje të survejancës epidemiologjike kombëtare dhe në lidhje me shkaktarët parazitare.

Siguron ekspertizë laboratorike të specializuar në shpërthimet epidemike për izolimin dhe evidentimin në kohë të shkaktarit për të mundësuar marrjen e masave antiepidemike efektive në kohën e duhur.

Harton dhe vë në zbatim metodologjitë bashkëkohore diagnostikuese.

Ofron ekspertizë/konsulencë për ekzaminimet mikrobiologjike (bakteriologjike dhe serologjike) të rasteve (mostra dhe shtame) të dërguara nga NJVKSH-të.

Kontrollon cilësinë dhe biosigurinë në laborator.

Kryen kërkime shkencore në këto fusha dhe merr pjesë në edukimin e vazhduar në fushën përkatëse.

Merr pjesë në përgatitjen e standardeve lidhur me identifikimin e shkaktarëve bakterialë të sëmundjeve infektive të fushës që mbulon.

Jep ndihmesë në kualifikimin e mjekëve të rretheve dhe përgatitjen e teknikëve të laboratorit në fushën e identifikimit të shkaktarëve bakterialë të sëmundjeve infektive

Merr pjesë në konferenca, botime shkencore në revista, në median e shkruar, elektronike.

Përgatit raporte periodike për Njësinë Bazë, Drejtorinë dhe institucionet e tjera.

Analizon, argumenton e dokumenton me përpikëri çdo veprim dhe testim të kryer në laborator dhe jashtë tij, sipas protokolleve përkatës.

Njofton eprorët për çdo problematikë të identifikuar apo aksident të mundshëm në punë.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

1.5 Laboratori i Preparatorisë, Prodhimit të Antigeneve dhe Serumeve Diagnostike

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin prodhues të laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit.

Ekzekuton kërkesat për terrene të laboratorëve brenda NJBLRK-së si dhe kërkesat e Njërive të tjera brenda institucionit bazuar në një planifikim praparak mujor dhe vjetor.

Koordinon punën për prodhimin e serumeve dhe antigeneve diagnostike për laboratorët mikrobiologjike të DRSH-ve.

Koordinon punën me Sektorin e Vivariumit.

Siguron cilësinë e terreneve dhe të serumeve e antigeneve diagnostike bazuar në protokollet standarde të prodhimit, si dhe furnizimin e laboratorëve me sasinë, cilësinë dhe në kohën e duhur.

Ruan dhe konservon shtamet sipas protokolleve të përcaktuar dhe rregullave të biosigurisë në laborator.

Harton Procedurat Standarde të Operimit (SOP) për prodhimin e terreneve dhe serumeve e antigeneve diagnostike.

Është përgjegjës për menaxhimin e teknikave laboratorike me të cilat punon, për mirëmbajtjen e pjesshme, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi.

Lajmëron përgjegjësin e laboratorëve dhe administratën e ISHP-së për defektet dhe nevojat për mirëmbajtje për teknikat laboratorike.

Harton dokumentacionin e kontrollit të cilësisë, merr pjesë në prova të zotësisë. Është përgjegjës për cilësinë e terreneve të prodhuara në laborator.

Mban dokumentacion të rregullt për teknikat dhe prodhimin e terreneve të prodhuara sipas standardeve përkatës.

Harton kërkesat periodike për mjete ndihmëse, reagente, qelqurina, pjesë këmbimi, materiale konsumi etj., për laboratorin dhe ia paraqet shefit të sektorit përkatës.

Kujdeset për sterilizimin, largimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rregulloreve përkatëse të biosigurisë. Përgatit program trajnimi në specialitetin të cilit i përket dhe realizon trajnimet përkatëse për stafin e laboratorët mikrobiologjike të DRSH-ve.

Merr pjesë në komisione e grupe pune për mbarëvajtjen e laboratorëve të ISHP-së. Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

22.2. Sektori i Laboratorëve të Referencës Kombëtare të Shëndetit dhe Mjedisit

Sektori i Laboratorëve të Referencës Kombëtare të Shëndetit e Mjedisit është pjesë e Njesisë bazë (Departamentit) të Laboratorëve të Referencës Kombëtare të ISHP-së.

Ka në përbërje këta laboratorë:

- 1- Laboratori i Kimisë së Ujit dhe Sanitetit
- 2- Laboratori i Mikrobiologjisë së Ujit
- 3- Laboratori i Kimisë Analitike Instrumentale
- 4- Laboratori i Mikrobiologjisë Ushqimore
- 5- Laboratori i Kimisë Ushqimore dhe Jodurisë.

Misioni

Sektori i Laboratorëve të Referencës Kombëtare të Shëndetit e Mjedisit (SLRKSHM) mbështet Departamentin e Shëndetit dhe Mjedisit, si dhe departamentet e tjerë të ISHP-së me analiza fiziko-kimike, kimike e bakteriologjike të mostrave mjedisore, kryesisht të ujërave dhe ushqimeve.

Sektori është pjesë integrale e punës kërkimore të ISHP-së, si dhe angazhohet në projekte e bashkëpunime mbi shëndetin dhe mjedisin.

Sektori ndihmon institucionet e shëndetit publik në gjithë vendin përmes trajnimeve dhe përmes analizave të avancuara.

Vizioni

Vizioni i SLRKSHM është ruajtja dhe rritja e kapacitetit analitik të laboratorëve, duke vendosur e përmirësuar sistemin e cilësisë dhe duke demonstruar cilësinë e rezultateve analitike përmes parametrave të performancës. Objektiv afatmesëm i Sektorit është akreditimi i laboratorëve sipas standardit ISO 17025.

SLRKSHM bashkëpunon ngushtësisht edhe me partnerë të tjerë, si organizatat ndërkombëtare, universitetet, institucione shtetërore, mediat, shoqërinë civile etj., sipas parimeve të transparencës dhe ndihmës reciproke, duke respektuar hierarkinë institucionale, në shërbim të shëndetit publik dhe mjedisit.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e sektorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Njesisë Bazë dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore në ISHP.

Koordinon zbatimin e planit të punës kërkimore të laboratorëve në bashkëpunim me Përgjegjësin e Njesisë Bazë.

Koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e Sektorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Njesisë Bazë.

Zbaton planet e punës kërkimore-shkencore të sektorit në përputhje me vizionin/misionin dhe strategjinë/objektivat e Njesisë Bazë, në bashkërendim dhe bashkëpunim me Përgjegjësin e Njesisë Bazë.

Zbaton në kohë dhe me cilësi planet e punës së sektorit duke siguruar kushtet objektive për realizimin e tyre. Mbikëqyr në çdo kohë zbatimin nga ana e personelit në laboratorët e sektorit, të rregullave të sigurimit teknik dhe higjienës.

Koordinon dhe mbikëqyr menaxhimin e mostrave që hyjnë në laborator.

Orienton dhe mbikëqyr aktivitetet lidhur me sigurinë dhe kontrollin e cilësisë së rezultateve të analizave.

Harton në bashkëpunim me specialistët përgjegjës, një Program për Kontrollin dhe Sigurinë e Cilësisë sipas standardeve të përcaktuara.

Harton në bashkëpunim me specialistët përgjegjës një Program për Biosigurinë në Laboratorët e Sektorit sipas standardeve të përcaktuara.

Ndihmon në zgjidhjen e problemeve analitike nga analistët.

Kujdeset për hartimin dhe zbatimin e programeve afatgjatë ose afatshkurtër dhe kërkesave për trajnim dhe rifreskim të njohurive për personelin e sektorit, si dhe për atë të laboratorëve të specialitetit në NJVKSH-të në rrethe.

Përgatit planet e punës dhe realizimet periodike sipas objektivave të njesisë bazë dhe koordinimit me përgjegjësin e Njesisë Bazë, si dhe një plan vjetor për sektorin duke u mbështetur në planet individuale të laboratorëve, si edhe të stafit të specialistëve në bashkërendim me kërkesat për analiza të sektorëve të Njesisë Bazë (Departamentit), kërkesat nga të tretët dhe punën kërkimore të vetë sektorit.

Harton kërkesat vjetore për mjete konsumi, materiale ndihmëse, reagente, qelqurina, standarde, pjesë këmbimi për aparaturat dhe literaturë në bashkëpunim me stafin e specialistëve dhe të teknikëve të laboratorit, si dhe kujdeset për dorëzimin në kohë të tyre në Njesisë Bazë.

Kujdeset për furnizim të rregullt periodik të laboratorëve që ka në përgjegjësi.

Plotëson çdo fundmuaj kohëshënuesin.

Propozon, kur është e nevojshme, për masa disiplinore në zbatim të rregullores së ISHP-së dhe Kodit të Punës.

Cakton një person përgjegjës në çdo laborator për komunikim me të. Raporton në mënyrë periodike për aktivitetin e sektorit tek Përgjegjësi i Njesisë Bazë, Titullari, MSHMS.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

2.1 Laboratori i Mikrobiologjisë së Ushqimeve dhe Mykologjisë

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit. Harton dhe merr pjesë në tema studimore të laboratorit; merr pjesë në projekte kërkimore të institutit ose në bashkëpunim me institutet homologe, apo institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Kryen analiza mikrobiologjike të mostrave ushqimore konform standardeve përkatëse. Kryen analiza të antibiotiko-rezistencës dhe analiza për raste të emergjencave.

Harton Procedurat Standarde të Operimit (SOP) për analizat që mbulon.

Është përgjegjës për menaxhimin e teknikave laboratorike me të cilat punon, për mirëmbajtjen e pjesshme, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi.

Lajmëron përgjegjësin e laboratorëve dhe administratën e ISHP-së për defektet dhe nevojat për mirëmbajtje për teknikat laboratorike.

Harton dokumentacionin e kontrollit të cilësisë, merr pjesë në prova të zotësisë. Është përgjegjës për cilësinë e rezultateve të analizave të prodhuara në laborator dhe firmos raport-analizën.

Mban dokumentacion të rregullt për teknikat dhe për rezultatet e analizave të kryera sipas standardit përkatës. Kryen punë kërkimore për shtrimin dhe futjen e metodave të reja në laboratorin e Mikrobiologjisë Ushqimore dhe Antibiotiko-Rezistencës.

Harton kërkesat periodike për mjete ndihmëse, reagente, qelqurina, pjesë këmbimi, materiale konsumi etj., për laboratorin dhe ia paraqet shefit të sektorit të laboratorëve.

Kujdeset për sterilizimin, largimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rregulloreve përkatëse të biosigurisë. Përgatit program trajnimi për stafin mikrobiolog të shëndetit publik në rrethe dhe realizon trajnimet përkatëse.

Merr pjesë në trajnime dhe aktivite që lidhen me punën në laborator dhe shëndetin e mjedisin.

Merr pjesë në komisione e grupe pune për mbarëvajtjen e laboratorëve të ISHP-së.

Komunikon me përgjegjësin e Sektorit të Laboratorëve lidhur me problematikën e laboratorit në rolin e personit përgjegjës për laboratorin.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

2.2 Laboratori i Mikrobiologjisë së Ujit, Ajrit, Tokës

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit. Harton dhe merr pjesë në tema studimore të laboratorit. Merr pjesë në projekte kërkimore të institutit ose në bashkëpunim me institutet homologe apo institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Kryen analiza mikrobiologjike të mostrave të ujit dhe mostrave të tjera mjedisore konform standardeve përkatëse. Kryen analiza për raste të emergjencave.

Harton Procedurat Standarde të Operimit (SOP) për analizat që mbulon.

Është përgjegjës për menaxhimin e teknikave laboratorike me të cilat punon, për mirëmbajtjen e pjesshme, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi.

Lajmëron përgjegjësin e laboratorëve dhe administratën e ISHP-së për defektet dhe nevojat për mirëmbajtje për teknikat laboratorike.

Harton dokumentacionin e kontrollit të cilësisë, merr pjesë në prova të zotësisë. Është përgjegjës për cilësinë e rezultateve të analizave të prodhuara në laborator dhe firmos raport-analizën.

Mban dokumentacion të rregullt për teknikat dhe për rezultatet e analizave të kryera sipas standardit përkatës. Kryen punë kërkimore për shtrimin dhe futjen e metodave të reja në laboratorin e Mikrobiologjisë së Ujërave. Harton kërkesat periodike për mjete ndihmëse, reagente, qelqurina, pjesë këmbimi, materiale konsumi etj., për laboratorin dhe ia paraqet shefit të sektorit të laboratorëve.

Kujdeset për sterilizimin, largimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rregulloreve përkatëse të biosigurisë. Kryen konsulencë kombëtare në fushën e ujit dhe sanitetit, kur kërkohet, sipas detyrimeve që ka vendi.

Përgatit program trajnimi për stafin mikrobiolog të shëndetit publik në rrethe dhe realizon trajnimet përkatëse.

Merr pjesë në trajnime dhe aktivite që lidhen me punën në laborator dhe shëndetin e mjedisin.

Merr pjesë në komisione e grupe pune për mbarrëvajtjen e laboratorëve të ISHP-së.

Komunikon me përgjegjësin e Sektorit të Laboratorëve lidhur me problematikën e laboratorit në rolin e personit përgjegjës për laboratorin.

Mban dokumentacion të rregullt për teknikat dhe për rezultatet e analizave të kryera sipas standardit përkatës.

Kryen punë kërkimore për shtrimin dhe futjen e metodave të reja në laboratorin e Mikrobiologjisë së Ujërave.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

2.3 Laboratori i Kimisë Së Ujit Dhe Sanitetit

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin Sektorit. Harton dhe merr pjesë në tema studimore të laboratorit; merr pjesë në projekte kërkimore të institutit ose në bashkëpunim me institutet homologe apo institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Kryen analiza fiziko-kimike të mostrave të ujit dhe mostrave të tjera mjedisore konform standardeve përkatëse. Kryen analiza për raste të emergjencave.

Harton Procedurat Standarde të Operimit (SOP) për analizat që mbulon.

Është përgjegjës për menaxhimin e teknikave laboratorike me të cilat punon, për mirëmbajtjen e pjesshme, kalibrimin, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi.

Lajmëron përgjegjësin e laboratorëve dhe administratën e ISHP-së për defektet dhe nevojat për mirëmbajtje për teknikat laboratorike.

Harton dokumentacionin e kontrollit të cilësisë, validon metodat analitike, vlerëson karakteristikat e performancës së metodave të përdorura në laborator përfshirë pasigurinë e rezultateve, merr pjesë në prova të zotësisë.

Është përgjegjës për cilësinë e rezultateve të analizave të prodhuara në laborator dhe firmos raport-analizën.

Mban dokumentacion të rregullt për teknikat dhe për rezultatet e analizave të kryera sipas standardit ISO 17025.

Punon për vendosjen e metodikave të reja të analizave të ujërave.

Harton kërkesat periodike për mjete ndihmëse, reagentë, qelqurina, pjesë këmbimi, materiale konsumi etj., për laboratorin dhe ia paraqet shefit të sektorit të laboratorëve.

Kujdeset për largimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rregulloreve përkatëse.

Përgatit program trajnimi për stafin analitik të shëndetit publik në rrethe dhe realizon trajnimet përkatëse.

Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete që lidhen me punën në laborator dhe shëndetin e mjedisin.

Merr pjesë në komisione e grupe pune për mbarëvajtjen e laboratorëve të ISHP-së.

Raporton tek Përgjegjësi i Sektorit lidhur me problematikat e laboratorit.

Është përgjegjës për përdorimin, mirëmbajtjen dhe rigjenerimin e sistemit të prodhimit të ujit të dejonizuar dhe ultrapur.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

2.4 Laboratori i Kimisë Ushqimore dhe Jodurisë

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin Sektorit. Harton dhe merr pjesë në tema studimore të laboratorit; merr pjesë në projekte kërkimore të institutit ose në bashkëpunim me institutet homologe apo institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Harton Procedurat Standarde të Operimit (SOP) për analizat që mbulon.

Është përgjegjës për menaxhimin e teknikave laboratorike me të cilat punon, për mirëmbajtjen e pjesshme, kalibrimin, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi.

Lajmëron përgjegjësin e laboratorëve dhe administratën e ISHP-së për defektet dhe nevojat për mirëmbajtje për teknikat laboratorike.

Harton dokumentacionin e kontrollit të cilësisë, kryen validimin e metodave analitike, llogaritjen e karakteristikave të performancës së metodave të përdorura në laborator përfshirë pasigurinë e rezultateve, merr pjesë në prova të zotësisë. Është përgjegjës për cilësinë e rezultateve të analizave të prodhuara në laborator dhe firmos raport-analizën.

Mban dokumentacion të rregullt për teknikat dhe për rezultatet e analizave të kryera sipas standardit ISO 17025.

Punon për vendosjen e metodikave të reja të analizave të ujërave.

Harton kërkesat periodike për mjete ndihmëse, reagentë, qelqurina, pjesë këmbimi, materiale konsumi etj., për laboratorin dhe ia paraqet shefit të sektorit të laboratorëve.

Kujdeset për largimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rregulloreve përkatëse.

Përgatit program trajnimi për stafin analitik të shëndetit publik në rrethe dhe realizon trajnimet përkatëse.

Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete që lidhen me punën në laborator dhe shëndetin e mjedisin.

Merr pjesë në komisione e grupe pune për mbarëvajtjen e laboratorëve të ISHP-së.

Raporton tek Përgjegjësi i Sektorit lidhur me problematikat e laboratorit.

Komunikon me përgjegjësin e Sektorit të Laboratorëve lidhur me problematikën e laboratorit në rolin e personit përgjegjës për laboratorin.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

2.5 Laboratori i Kimisë Analitike, Instrumentale dhe Sigurisë, Kontrollit të Cilësisë

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Drejton, koordinon, kontrollon dhe ndjek aktivitetin e laboratorit në bashkëpunim me Përgjegjësin e Njësisë Bazë dhe përgjegjësin e Sektorit.

Harton dhe merr pjesë në tema studimore të laboratorit; merr pjesë në projekte kërkimore të institutit ose në bashkëpunim me institutet homologe apo institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Kryen analizat e metaleve të rënda me teknikën AAS, konform standardeve përkatëse.

Kryen analizat e ndotësve organik me teknikën HPLC, konform standardeve përkatëse.

Kryen analizat e ndotësve organik me teknikën GC, konform standardeve përkatëse.

Kryen analiza për raste të emergjencave.

Kryen aktivitet analitik për matjen e ndotësve organik me teknikën e GCMS në kuadër të temave studimore dhe analizave për të tretë, përgatitje e mostrave, përgatitje e standardeve të punës.

Harton Procedurat Standarde të Operimit (SOP) për analizat që mbulon.

Është përgjegjës për menaxhimin e teknikave laboratorike me të cilat punon, për mirëmbajtjen e pjesshme, kalibrimin, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi. Lajmëron përgjegjësin e laboratorëve dhe administratën e ISHP-së për defektet dhe nevojat për mirëmbajtje për teknikat laboratorike.

Harton dokumentacionin e kontrollit të cilësisë, kryen validimin e metodave analitike, llogaritjen e karakteristikave të performancës së metodave të përdorura në laborator përfshirë pasigurinë e rezultateve, merr pjesë në prova të zotësisë. Është përgjegjës për cilësinë e rezultateve të analizave të prodhuara në laborator dhe firmos raport-analizën.

Mban dokumentacion të rregullt për teknikat dhe për rezultatet e analizave të kryera sipas standardit ISO 7025.

Punon për vendosjen e metodikave të reja të analizave në fushën përkatëse.

Harton kërkesat periodike për mjete ndihmëse, reagente, qelqurina, pjesë këmbimi, materiale konsumi etj., për laboratorin dhe ia paraqet shefit të sektorit të laboratorëve.

Kujdeset për largimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rregulloreve përkatëse.

Përgatit program trajnimi për stafin analitik të shëndetit publik në rrethe dhe realizon trajnimet përkatëse.

Merr pjesë në trajnime dhe aktivite që lidhen me punën në laborator, shëndetin e mjedisin.

Merr pjesë në komisione e grupe pune për mbarëvajtjen e laboratorëve të ISHP-së.

Komunikon me përgjegjësin e sektorit të Laboratorëve lidhur me problematikën e laboratorit në rolin e personit përgjegjës për laboratorin.

Është përgjegjës për përdorimin, mirëmbajtjen dhe rigjenerimin e sistemit të prodhimit të ujit të dejonizuar dhe suprapur.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

Përshkrimi i punës: Specialist

Kryen analiza për raste të emergjencave.

Kryen aktivitet analitik për matjen e ndotësve organik me teknikën e GCMS në kuadër të temave studimore dhe analizave për të tretë, përgatitje e mostrave, përgatitje e standardeve të punës.

Harton Procedurat Standarde të Operimit (SOP) për analizat që mbulon.

Është përgjegjës për menaxhimin e teknikave laboratorike me të cilat punon, për mirëmbajtjen e pjesshme, kalibrimin, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi. Lajmëron përgjegjësin e laboratorëve dhe administratën e ISHP-së për defektet dhe nevojat për mirëmbajtje për teknikat laboratorike.

Mban dokumentacion të rregullt për teknikat dhe për rezultatet e analizave të kryera sipas standardit ISO 17025.

Harton kërkesat periodike për mjete ndihmëse, reagente, qelqurina, pjesë këmbimi, materiale konsumi etj.. për laboratorin dhe ia paraqet shefit të sektorit të laboratorëve.

Kujdeset për largimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mbeturinave të dëmshme të analizave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe rregulloreve përkatëse.

Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete që lidhen me punën në laborator, shëndetin e mjedisin.

Merr pjesë në komisione e grupe pune për mbarëvajtjen e laboratorëve të ISHP-së.

Është përgjegjës për përdorimin, mirëmbajtjen dhe rigjenerimin e sistemit të prodhimit të ujit të dejonizuar dhe suprapur.

Të ketë gjithmonë në vëmendje, ruajtjen e etikës profesionale, të shprehur nëpërmjet komunikimit, sjelljes dhe veshjes.

22.3. Sektori i Vivarium

Objektivat e Sektorit të Vivariumit

1. Mbajtje nën kontroll të racave të pastra sterile (lepuj, kavje, minj), duke bërë kryqëzime të kontrolluara dhe futjen në racionin ushqimor të Pelets si i vetmi ushqim për të prodhuar kafshë laboratorike sterile.
2. Rikonstruksion i ambienteve të rritjes (lepuj, kavje, minj).
3. Rishikim i buxhetit për Sektorin e Vivariumit.

Veprimtaria:

Kontroll i përditshëm i gjendjes shëndetësore të kafshëve të Vivariumit, mbajtja në kontroll të kushteve higjieno-sanitare, përgatitja e racioneve ushqimore, vaksinimit, profilaksisë për enterotoksemin, koksidiozën, marrje gjaku në dëshë, lepuj, kavje dhe gjela.

Mbajtja në kushte optimale të temperaturës dhe lagështirës për mbarështimin e kafshëve të laboratorit.

Sektori i përgjigjet nevojave të laboratorëve të ISHP-së me kafshë eksperimenti për punën rutinë dhe shkencore.

Bashkëpunim me laboratorin e Virologjisë, Preparatorisë dhe Përgatitjes së Antigjeneve Diagnostikë për sigurimin e gjakut në gjela, kavje, deshë dhe lepuj.

Sipas kërkesave siguron gjak dashi për NJVKSH Tiranë dhe Klinikën Ortodokse.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Të organizoj kontrollin e përditshëm rutinë bashkë me veterinerin dhe punonjësit e sektorit për të siguruar shëndet të plotë për kafshët, *çdo ditë në mënyrë periodike* janar-dhjetor.

Të merret me sigurimin e njësive ushqimore të freskëta dhe ushqim të koncentruar, për të garantuar kafshë të shëndetshme dhe me cilësi.

Të merret me sigurimin e bazës ushqimore, të freskët dhe të koncentruar, janar-dhjetor.

Të organizoj sektorin për sigurimin e gjakut dhe kafshët e laboratorit sterile, bashkë me veterinerin dhe punonjësit e sektorit, *çdo ditë në mënyrë periodike*, janar-dhjetor.

Të drejtojë punën shkresore të sektorit me zyrën e financës për të garantuar mirëfunksionimin e sektorit, *çdo ditë në mënyrë periodike*, janar-dhjetor.

Neni 23

NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I VLERËSIMIT DHE TRAJTIMIT TË RISQEVË TË SHËNDETIT PUBLIK

Departamenti është i organizuar në pesë sektorë:

23.1.Sektori i Ujit dhe Sanitetit

Është Qendra Kombëtare e mbledhjes, përpunimit, analizës dhe vlerësimit të riskut referuar të dhënave të ardhura nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor në rrethe; harton raportin vjetor mbi cilësinë e ujit të pijshëm në të gjithë Shqipërinë, me qëllimin final: Uljen e sëmundshmërisë dhe parandalimin e shpërthimeve epidemike me origjinë hidrike në vend.

Seksioni i Ujit dhe Sanitetit, si qendër reference shkencore e kërkimeve, ka për detyrë:

Të bëjë studime dhe hulumtime në lidhje me vlerësimin e rreziqeve mjedisore të dëmshme që lidhen me ujin, sanitetin dhe ndikimin në shëndet.

Propozon dhe punon në vazhdimësi në lidhje me përmirësimin e legjislacionit, standardeve dhe normave brekë natyrisht parasysh përafrimin e tij me legjislacionin e BE-së.

Miron ndihmë tekniko-profesionale për specialistët e shëndetit publik, shërbimit të higjienës dhe Inspektoratit Sanitar Shtetëror në rrethe, ofron trajnimin dhe kualifikimin e specialistëve të shërbimit të higjienës dhe ISSH-ve në rrethe me anë të seminareve dhe pranë seksionit në fushën e ujit dhe sanitetit, - merr pjesë në to. Ndjek rregullisht dhe mban nën kontroll të vazhdueshëm situatën higjieno-sanitare të ujit të pijshëm në vend nëpërmjet analizës së të dhënave që vijnë nga rrethet. bën vlerësimin e faktorëve të rrezikut në lidhje me monitorimin e ujit të pijshëm.

Përgatit në vazhdimësi informacione shkencore në fushën e ujit dhe sanitetit për dikastere të ndryshme shtetërore qendrore dhe lokale me qëllim informimi, sensibilizimi dhe vëmendjeje më të madhe ndaj problemeve nga ana e tyre, për reduktimin e ekspozimit të popullatës ndaj faktorëve të dëmshëm që lidhen me ujin e pijshëm.

Organizon, studion dhe merr masa për zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, mbi monitorimin e ujit të pijshëm, ujërave sipërfaqësore, ujërave bregdetare të larjes, në bashkëpunim dhe të ofruar nga donatorë të huaj, vendas, sipas Vendimit nr. 103, datë 31.03.2002.

Organizon dhe kontrollon punën për marrjen e masave të nevojshme për seksionin, me qëllim funksionimin në mënyrë të rregullt e të shpejtë të të gjitha kërkesave emergjente që paraqiten në lidhje me ujin e pijshëm. Organizon punën për shpërndarjen e mostrave të ujërave në të gjithë laboratorët e Njesisë bazë (Njesisë bazë (Departamentit)) Harton treguesit analitik për secilin laborator, për probleme të ndryshme në lidhje me rezultatet - bashkëpunon dhe konsultohet me specialistë të ndryshëm, mikrobiologë dhe kimistë.

Përgjigjet në kohë për të gjitha kërkesat e bëra nga subjekte shtetërore dhe private për ekzaminime laboratorike dhe vlerësime analitike të ujërave. (Përgatitja e raport-analizave të ndryshme në lidhje me këtë problem dhe futja e të ardhurave dytësore nga të tretët).

Mbledh të dhënat analitike nga të gjithë laboratorët, përgatit dokumentacionin për hartimin e raport-analizave dhe informacioneve të tjera.

Organizon, drejton dhe kontrollon të gjitha detyrat në fushën e Ujit dhe Sanitetit, sipas problematikës Miraton planet e punës së specialistëve dhe bën analiza të punës periodike të tyre.

Harton planin e punës së Sektorit dhe i miraton ato tek shefi i Njesisë bazë (Departamenti))

Bën shpërndarjen e detyrave ditore, javore e mujore në përputhje me planet e miratuara të gjithë punonjësve të Sektorit.

Harton informacione për realizimin e detyrave të planifikuara të Sektorit.

Përgatit informacione për aktivitetet e ushtruara nga Sektori (të planifikuara, rutinë apo të paplanifikuara).

Sipas kërkesave të ndryshme merr pjesë në ekspertiza higjieno-sanitare.

Kontrollon zbatueshmërinë e rekomandimeve të ndryshme të lëna për zbatim nga ekspertizat higjieno-sanitare të kryera.

Kontrollon disiplinën në punë të sektorit dhe raporton për mungesat në punë.

Raporton aktivitetin mujor, aktivitetin 6-mujor dhe aktivitetin vjetor.

Raporton për punën tekniko-profesionale brenda sektorit dhe propozon tematikë për vitin në vijim, duke planëzuar mbështetjen nga Shefi i Njesisë bazë (Departamentit) dhe Drejtori.

Harton, merr pjesë dhe përgatit raporte, konkluzione dhe rekomandime të studimeve.

Përgatit materiale dhe organizon takime/trajnime me specialistët e Shëndetit Publik në Qarqet e vendit me tematika mbi Ujin dhe Sanitetin.

Përgatit materiale për raportimin në kohë reale nga Njësitë Vendore të Shëndetit Publik në rast të konstatimit të problematikave lidhur me furnizimin me ujë të popullatës dhe shpërthimeve hidrike, duke përmirësuar sistemin e raportimit.

Përgatitja për botim e abstrakteve dhe të artikujve shkencorë (autorë/bashkautorë).

Merr pjesë në konferenca e seminare me tematika të ndryshme që lidhen me Shëndetin e Mjedisin dhe impaktin në shëndet të problematikave mjedisore

Merr pjesë në takime në grupe ndër-institucionale si përfaqësuese e ISHP-së.

Përgatit sugjerime dhe komente për drafte, strategji apo dokumenta të tjerë.

Ndjek kërkesat e ardhura në Sektor, kthen përgjigje sipas rasteve, përgatit rekomandimet përkatëse.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori me Titull/Gradë

Survejanca epidemiologjike dhe diagnoza laboratorike e sëmundjeve të shkaktuara nga uji, me qëllimin reduktimin e sëmundshmërisë dhe parandalimin e shpërthimeve epidemike (me origjinë nga uji).

Kryen studime dhe hulumtime në lidhje me vlerësimin e risqeve mjedisore që lidhen me ujin dhe sanitetin, si dhe impaktin në shëndet.

Sektori, në kuadër të kërkimit shkencor, harton dhe merr pjesë në projekte në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Harton raportin vjetor kombëtar mbi cilësinë e ujit të pijshëm, Raporti përgatitet bazuar në analizat bakteriologjike dhe fiziko-kimike sipas pikave të monitorimit të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, në zbatim të Aktmarrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor të rretheve dhe Ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizimeve.

Organizon dhe kontrollon punën për marrjen e masave të nevojshme, me qëllim funksionimin në mënyrë të rregullt e të shpejtë për zgjidhjen e të gjitha kërkesave emergjente që paraqiten në lidhje me ujin e pijshëm. Propozon dhe punon mbi përmirësimin e legjislacionit, standardeve, normave dhe hartimin e rregulloreve që lidhen me ujin e pijshëm dhe me ujërat larës.

Ofron ndihmë tekniko-profesionale për specialistët e shëndetit publik. Trajnime dhe kualifikim të specialistëve të shëndetit të Strukturave Rajonale Shëndetësore në rrethe.

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Specialisti merr detyra, porosi, urdhra prej përgjegjësit të sektorit dhe raporton realizimin e detyrave në mënyrë periodike.

Harton planet e punës dhe raporton te përgjegjësi i sektorit, realizimin e tyre.

Kryen mbledhjen, përpunimin e të dhënave të monitorimit të raportuara nga NJVKSH-të dhe përgatit raportin vjetor kombëtar të cilësisë së ujit të pijshëm.

Pritjen, regjistrimin /kodimin, shpërndarjen me fletën shoqëruese përkatëse, të mostrave në të gjithë laboratorët.

Kryen mbledhjen e të dhënave analitike nga të gjithë laboratorët, përgatit dokumentacionin dhe harton raport-analizat.

Përfshihet në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit të ardhur sipas zonave në situata emergjente.

Përfshihet në krijimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet përgatitjes së materialeve trajnuese të specialistëve të NJVKSH-ve të rretheve dhe studentëve që vijnë për praktikë në ISHP.

Përgatit të dhënat e aktivitetit periodike , mujor, 6-mujor, vjetor dhe raporton në kohë tek përgjegjësi i sektorit.

Përfshihet në ekspertiza higjieno-sanitare dhe përgatit raportet përkatëse.

Përfshihet në survejancën e sëmundjeve me origjinë nga uji.

Përfshihet në kërkime dhe programe ndërhyrjesh të shëndetit publik në fushën e ujit dhe sanitetit.

Përfshihet – jep mendim për çdo material të ardhur në sektor nga institucionet kompetente dhe kthim përgjigjeje.

Përshkrimi i punës: Laborant

Laboranti merr detyra, porosi, urdhra prej përgjegjësit të sektorit dhe raporton realizimin e detyrave në mënyrë periodike.

Raporton te përgjegjësi i sektorit, realizimin e tyre. Pritjen, regjistrimin /kodimin, shpërndarjen me fletën shoqëruese përkatëse, të mostrave në të gjithë laboratorët.

Mbledhjen e të dhënave analitike nga të gjithë laboratorët, dhe dorëzimin e tyre pranë specialistëve të sektorit. Përfshirjen në grupet e punës në situata të krijuara. Përgatitjen e të dhënave të aktivitetit laboratorik, dhe raportimin në kohë tek përgjegjësi i sektorit. Përfshirjen në ekspertiza higjieno - sanitare.

Përfshirjen në grupet e punës për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit të ardhur sipas zonave në situata emergjente.

23.2.Sektori i Epidemiologjisë Ambientale dhe Kontrollit të Cilësisë së Ajrit

Ka për qëllim :

Të përmirësojë njohuritë mbi rolin e ekspozimeve mjedisore dhe përcaktuesve socio-ekonomikë në shkaktimin e shfaqjes së sëmundjeve dhe traumave përmes studimeve epidemiologjike të përshtatshme për përcaktimin e ndërhyrjeve parandaluese.

Të kryejë hulumtime që synojnë vlerësimin e lidhjes midis ekspozimeve të caktuara mjedisore dhe patologjive specifike për të kontribuar në zhvillimin e masave parandaluese.

Të realizojë vlerësimin e impaktit që ka ndotja e cilësisë së ajrit në shëndetin e popullatës.

Të marrë pjesë në ekspertiza mjedisore që lidhen me ndotjen urbane të shkaktuara nga një sërë burimesh ndotëse (ndotje akustike) pranë qendrave të banimit.

Të hartojë dhe të realizojë tema studimore lidhur me problemet shëndetësore që lidhen me ndotjen (cilësia e ajrit të brendshëm dhe të jashtëm) nëpërmjet bashkëpunimit edhe me laboratorët e tjerë.

Të realizojë tema seminaresh me specialistë të fushës në lidhje me implementimin e indikatorëve të mjedisit dhe shëndetit (kryesisht cilësia e ajrit) për të dalë më mirë në pah lidhja shkak-pasojë.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori me Titull/Gradë

Identifikimin e strategjive në lidhje me parandalimin parësor për të shmangur dhe reduktuar rrezikun e sëmundjeve të ndikuar nga faktorë mjedisorë, si dhe transferimin e provave shkencore në programet dhe politikat e shëndetit publik.

Realizimin e ekspertizave mjedisore me fokus multidisiplinar, që kanë të bëjnë me identifikimin dhe karakterizimin e faktorëve të rrezikut mjedisor dhe impaktin në efekte shëndetësore.

Ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe bashkëpunime bilaterale nëpërmjet projekteve të mbështetura nga institucione ndërkombëtare.

Të hartojë dhe realizojë studime mbi vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe impaktit në shëndet.

Të marrë pjesë në ekspertiza sanitare që lidhen me ndotjen urbane të shkaktuara nga një sërë burimesh të tilla (ndotje industriale) pranë qendrave të banimit.

Të realizojë kurrikula me specialistë të fushës të cilët lidhen me implementimin e vlerësimit të indikatorëve mjedisorë/shëndetësorë (indikatorët e cilësisë së ajrit).

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Të realizojnë procesin e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe vlerësimin e ndotjes në zonat që monitorohen.

Të përcaktojnë zonat hot-spot sipas specifikave të ndotjes dhe metodologjitë e realizimit të procesit të monitorimit.

Të realizojnë vlerësime në mjediset ku drejtohet ankesa nga të tretët.

Të hartojnë dhe përfshihen në projektstudime që lidhen me vlerësimin e ndotjes së ajrit dhe ndikimin në mjedis.

Të jenë pjesë aktive e grupeve për diskutime mbi ligjshmërinë.

Përfshirjen në grupe pune në funksionimin ndërinstitucional të punës për Integrimin Europian.

Përfshirje në përpilimin e kurrikulave për trajnime të specialistëve në nivel vendi për të siguruar ngritjen profesionale të stafit, të cilët janë pjesë në sektorët e epidemiologjisë mjedisore dhe kontrollit të cilësisë së ajrit.

Përfshirje në hartimin e materialeve informuese dhe edukuese, me qëllim sensibilizimin e popullatës sipas grup-moshave, mbi ndotësit e cilësisë së ajrit.

Ngritjen e informacionit (grumbullim të dhënash), analizimin statistikor të tyre dhe vlerësimin e faktorëve shkaktësor me ndikim në zhvillimin e problematikave shëndetësore.

Përshkrimi i punës: Laborant

Identifikimin e strategjive në lidhje me parandalimin parësor për të shmangur dhe reduktuar rrezikun e sëmundjeve të ndikuar nga faktorë mjedisorë, si dhe transferimin e provave shkencore në programet dhe politikat e Shëndetit Publik. Realizimin e ekspertizave mjedisore me fokus multidisiplinar, që kanë të bëjnë me identifikimin dhe karakterizimin e faktorëve të rrezikut mjedisor dhe impaktin në efekte shëndetësore.

Ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe bashkëpunime bilaterale nëpërmjet projekteve të mbështetura nga institucione ndërkombëtare.

Të hartojë dhe të realizojë studime mbi vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe impaktit në shëndet. Të marrë pjesë në ekspertiza sanitare që lidhen me ndotjen urbane të shkaktuara nga një sërë burimesh ndotëse (ndotje industriale) pranë qendrave të banimit.

Të realizojë kurrikula me specialistë të fushës të cilët lidhen me implementimin e vlerësimit të indikatorëve mjedisorë/shëndetësorë (indikatorët e cilësisë së ajrit). Të ketë njohuri mbi standardet që lidhen me treguesit e ndotësve të cilësisë së ajrit. Të ketë njohuri mbi ligjshmërinë e fushës ku operon. Të zgjerojë gamën e larmishme të treguesve analitik në kuadër të Cilësisë së Ajrit. Stafi i mesëm njih dhe zbaton rregulloren e brendshme të laboratorit (sigurimin teknik, metodat e punës etj.), dhe përgjigjet për punën e kryer në laborator. Merret me mbarëvajtjen e punës së laboratorit (përgatitje të mostrave për monitorim dhe për analizim). Përgjigjet në kohë dhe me korrektësi për analizat e miratuara. Siguron cilësi maksimale në analizat laboratorike, të kryera sipas standardeve të vendosura. Merr pjesë në furnizimin e vazhdueshëm të laboratorit me materiale ndihmëse e të konsumit. Mban në gjendje gatishmërie të gjitha aparaturat e laboratorit. Angazhohet për realizimin e temave studimore të laboratorit në kryerjen e analizave të ndryshme të ndotësve të Cilësisë së Ajrit, për të realizuar me përpikëri qëllimet e institucionit.

23.3.Sektori i Fizikës Sanitare

Misioni i Sektorit të Fizikës Sanitare është zbatimi i ligjshmërisë së shëndetit publik në fushën e fizikës sanitare (ndotja akustike, vibracionet, elektromagnetizmi, ndriçimi etj.), për vlerësimin e ekspozimit dhe ndikimit në shëndetin e popullatës dhe punëmarrësve, nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe ekspertizës analitiko-shkencore; përgatitja e akteve ligjore e nënligjore në fushën e fizikës sanitare; trajnimi i specialistëve të shëndetit publik për ekspertizën, monitorimin dhe vlerësimin praktik-shkencor; si edhe vlerësimi i riskut në shëndet publik nga ndotësit mjedisor fizik (indoor,outdoor).

Detyrat kryesore të Sektorit të Fizikës Sanitare janë:

Njohja e situatës së ndotjes nga faktorët fizik në mjediset e hapura dhe të mbyllura nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe ekspertizës sanitare.

Vlerësimi i riskut në shëndetin e popullatës dhe punëmarrësve nga faktorë të ndryshëm fizik.

Kryerja e ekspertizave sanitare për vlerësimin e ndotjes akustike (indoor dhe outdoor).

Përgatitja e materialeve koherente dhe trajnimi periodik i specialistëve të shëndetit publik në fushën e fizikës sanitare.

Hartimi i materialeve shkencore përmbledhëse në fushën e ekspozimit ndaj faktorëve fizikë në popullatë dhe ndikimit në shëndet.

Bashkëpunimi me strukturat qendrore, vendore dhe institucione/organizma të tjera në fushën e fizikës sanitare.

Bashkërendimi i veprimtarisë me institucionet e shëndetit publik për monitorimin, vlerësimin e riskut dhe ekspertizën në fushën e fizikës sanitare, si qendër reference në nivel kombëtar.

Mbështet veprimtarinë e saj në legjislacionin në fuqi, direktivat, rregulloret dhe standardet e OBSH-së dhe BE-së.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori me Titull/Gradë

Sektori i Fizikës Sanitare, si njësi reference, kryen monitorimin dhe vlerësimin e ndotësve fizikë, si: zhurma, vibracioni, ndriçimi natyral/artificial, rrezatimi jojonizues dhe ndikimin e tyre në shëndet, me qëllim sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe të sigurt për popullatën.

Pjesëmarrje në partneritet që informojnë popullatën, profesionistët e shëndetit publik, dhe të tjerët në sektorin publik/privat rreth parandalimit dhe menaxhimit të sëmundjeve nga ndotësit fizikë, si: zhurma, vibracioni, ndriçimi natyral/artificial dhe rrezatimi jojonizues.

Në bashkëpunim me Ministrinë e linjës, përfshihet në procese politikash të fushës së fizikës sanitare (zhurma, vibracioni, ndriçimi natyral/artificial dhe rrezatimi jojonizues) dhe shëndetit publik, si: hartime projektligjesh të rinj, përditësime të ligjeve ekzistuese, VKM, udhëzues, standarde dhe materiale për të promovuar një shoqëri të shëndetshme.

Sektori, në kuadër të kërkimit shkencor, harton dhe merr pjesë në projekte në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Harton dhe merr pjesë në studimet e kërkimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të impaktit në shëndetin e popullatës/punëmarrëve, ndaj ndotësve fizikë, si: zhurma, vibracioni, ndriçimi natyral/artificial dhe rrezatimi jojonizues; vlerësimit të dëgjimit, në grup-mosha vulnerabël (moshat shkollore dhe profesionistë); vlerësimit të fushës pamore në grup-mosha më vulnerable dhe institucione të ndryshme.

Merr pjesë në temat studimore të sektorëve të tjerë të Njësisë bazë (Departamentit), të institucionit apo institucioneve të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Është përgjegjës për menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore në lidhje me temat studimore që ndërmerr sektori.

Përfshihet në krijimin e kapaciteteve profesionale në fushën e fizikës sanitare nëpërmjet planëzimit-organizimit-drejtimit teknik të seminareve, ëorkshop-eve, mbledhjeve dhe mbështetjes teknike të specialistëve në strukturat rajonale të shëndetit publik, si Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor.

Përfshihet në aktivitete që sigurojnë ngritjen profesionale të stafit dhe përditësimin e njohurive dhe përsosjen e kompetencave për ndotësit fizikë në fushën e shëndetit publik.

Përfshihet në dhënie përgjigje/zgjidhjeje kërkesave drejtuar Sektorit të Fizikës Sanitare dhe mban dokumentacion të rregullt për to.

Në bashkëpunim me përgjegjësin e sektorit, përfshihet në procese politikash të fushës së fizikës sanitare (zhurma, vibracioni, ndriçimi natyral/artificial dhe rrezatimi jojonizues) dhe shëndetit publik, si: hartime projektligjesh të rinj, përditësime të ligjeve ekzistuese, VKM, udhëzues, standarde dhe materiale për të promovuar një shoqëri të shëndetshme.

Përfshihet në hartimin e paketave informuese dhe edukuese, me qëllim sensibilizimin e popullatës sipas grup-moshave, mbi ndotësat fizikë (zhurma, vibracioni, ndriçimi natyral/artificial dhe rrezatimi jojonizues), efektet e dëmshme në shëndet, si dhe masat për parandalimin e tyre.

Përgatit, boton dhe paraqitet në aktivitete shkencore në fushën e fizikës sanitare dhe të shëndetit publik.

Harton dhe merr pjesë në studimet e kërkimit, monitorimit dhe vlerësimit të situatës së ndotjes (ndaj ndotësve fizikë si zhurma, vibracioni, ndriçimi natyral/artificial, rrezatimi jojonizues) nëpërmjet ekspertizave sanitare.

Përcakton, mbikëqyr dhe hartëzon zonat urbane me risk më të lartë, nëpërmjet monitorimit të ndotjes akustike, në nivel kombëtar.

Merr pjesë në temat studimore të sektorëve të tjerë të Njesisë bazë (Departamentit), të institucioneve të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Përgatit procesin e punës për kryerjen e matjeve dhe monitorimit të ndotësve fizikë, si: zhurma, vibracioni, ndriçimi natyral/artificial, rrezatimi jojonizues, konform standardeve (ISO) përkatëse. Është përgjegjës për cilësinë e rezultateve të matjeve të kryera dhe firmos raportin e këtyre ekspertizave. Mban dokumentacionin të rregullt, për teknikat dhe rezultatet e matjeve të kryera sipas standardit (ISO 17025).

Është përgjegjës për menaxhimin e teknikave të pajisjeve me të cilat punon, për mirëmbajtjen e pjesshme, kalibrimin, furnizimin me pjesë ndërrimi e materiale konsumi. Lajmëron përgjegjësin e sektorit dhe administratën e ISHP-së për defektet dhe nevojat për mirëmbajtjen teknike të pajisjeve me të cilat punon.

Përfshihet në krijimin e kapaciteteve profesionale në fushën e fizikës sanitare nëpërmjet planëzimit-organizimit-drejtimit teknik të seminareve, ëorkshop-eve, mbledhjeve dhe mbështetjes teknike të specialistëve në strukturat rajonale të shëndetit publik, si Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor.

Përfshihet në aktivitete që sigurojnë ngritjen profesionale të stafit dhe përditësimin e njohurive dhe përsosjen e kompetencave për ndotësit fizikë në fushën e shëndetit publik.

Përfshihet në dhënie përgjigje/zgjidhjeje kërkesave drejtuar Sektorit të Fizikës Sanitare dhe mban dokumentacion të rregullt për to.

Në bashkëpunim me përgjegjësin e sektorit, përfshihet në procese politikash të fushës së fizikës sanitare (zhurma, vibracioni, ndriçimi natyral/artificial dhe rrezatimi jojonizues) dhe shëndetit publik, si: hartime projektligjesh të rinj, përditësime të ligjeve ekzistuese, VKM, udhëzues, standarde dhe materiale për të promovuar një shoqëri të shëndetshme

Përgatit, boton dhe paraqitet në aktivitete shkencore në fushën e fizikës sanitare dhe të shëndetit publik.

23.4.Sektori i Shëndetit në Punë dhe Toksikologjisë

Sektori i Shëndetit në Punë dhe Toksikologjisë si qendër reference shkencore e kërkimeve në fushën e Shëndetit në punë, ka për detyrë të bëjë studime dhe hulumtime në lidhje me vlerësimin e rreziqeve në shëndetin e punës

Propozon dhe punon në vazhdimësi në lidhje me përmirësimin e legjislacionit, standardeve dhe normave duke patur parasysh përafrimin e tij me legjislacionin e BE-së.

Ofron ndihmë tekniko-profesionale për specialistët e shëndetit, ofron trajnimin dhe kualifikimin e specialistëve të shëndetit të Strukturave Rajonale Shëndetësore në rrethe me anë të seminareve dhe specializimeve të tyre.

Ndjek rregullisht dhe mban nën kontroll të vazhdueshëm situatën në shëndetin në punë, si aksidentetet në punë dhe sëmundjet profesionale.

Është Qendra Kombëtare e mbledhjes, përpunimit, analizës dhe vlerësimit të riskut referuar të dhënave të ardhura nga Strukturat Rajonale të Shëndetit Publik në rrethe.

Përgatit në vazhdimësi informacione shkencore në fushën e shëndetit në punë për dikastere të ndryshme

shtetërore qendrore dhe lokale me qëllim informimi, sensibilizimi dhe vëmendjeje më të madhe ndaj problemeve të shëndetit në punë.

Organizon dhe kontrollon punën për marrjen e masave të nevojshme të sektorit, me qëllim funksionimin në mënyrë të rregullt e të shpejtë të të gjitha kërkesave emergjente që paraqiten.

Përgjigjet në kohë për të gjitha kërkesat e bëra nga subjekte shtetërore dhe private për vlerësimin e vështirësisë në punë (përgatitja e raport-ekspertizave të ndryshme në lidhje me këtë problem dhe kostifikimin e ekspertizave).

Organizon, drejton dhe kontrollon të gjitha detyrat në fushën e Shëndetit në punë.

Miraton planet e punës së specialistëve dhe bën analiza të punës periodike të tyre.

Harton planin e punës së sektorit dhe i miraton ato tek shefi i Njesisë bazë (Departamentit)

Bën shpërndarjen e detyrave ditore, javore e mujore në përputhje me planet e miratuara gjithë punonjësve të sektorit.

Harton Informacione për realizimin e detyrave të planifikuara të sektorit.

Informon Shefin e Njesisë bazë (Departamentit) dhe Drejtorin për të gjitha detyrat e ndjekura, punët e kryera nga sektori dhe propozon masat që duhen marrë për probleme që kapërcejnë kompetencat e tij

Përgatit informacione për aktivitetet e ushtruara nga sektori (të planifikuara, rutinë apo të paplanifikuara).

Sipas kërkesave të ndryshme merr pjesë në ekspertiza të semundjeve profesionale, aksidenteve në punë dhe përcaktimin e vështirësive në punë.

Kontrollon zbatueshmërinë e rekomandimeve të ndryshme të lëna për zbatim nga ekspertizat.

Harton planin e lejes së punonjësve të sektorit dhe ia dërgon për miratim Shefit të Njesisë bazë (Departamentit) dhe në Administratë.

Bën koordinimin e veprimtarisë së sektorit të shëndetit në punë dhe toksikologjisë dhe e koordinon me sektorë të tjerë të Njesisë bazë (Njesisë bazë (Departamentit))

Merr korrespondencën nga administrata dhe e shpërndan sipas përkatësisë Specialistëve, duke kërkuar zbatimin në afat të tyre.

Raporton aktivitetin mujor, 6-mujor dhe aktivitetin vjetor.

Raporton për punën tekniko-profesionale brenda sektorit dhe propozon tematikë për vitin në vijim, duke planëzuar mbështetjen nga Shefi i Njesisë bazë (Departamentit) dhe Drejtori.

Për probleme që tejkalojnë mundësitë e tij i propozon shefit të Njesisë bazë (Departamentit) organizimin e konsultave ndërsektoriale

Harton, merr pjesë dhe përgatit: Raporte, Konkluzione dhe Rekomandime të studimeve.

Përgatit materiale dhe organizon takime/trajnime të specialistëve dhe mjekëve të punës. Përgatit materiale për raportimin në kohë reale nga Njësiti Vendore të Shëndetit Publik në rast të konstatimit të problematikave lidhur me aksidentet në punë.

Përgatitja për botim e artikujve (autorë e bashkautorë) dhe abstrakteve.

Merr pjesë në konferenca e seminare me tematika të ndryshme që lidhen me Shëndetin e Mjedisin dhe impaktin në shëndet të problematikave mjedisore.

Merr pjesë në takime në grupe ndërinstitutionale si përfaqësuese e ISHP-së.

Përgatit rekomandimet për Raportin Vjetor Kombëtar, shëndetin në punë.

Përgatit Planin e Kontrollit dhe ekspertizave dhe përcakton grupin e punës

Përgatit Sugjerime dhe komente për drafte, strategji apo dokumenta të tjera.

Ndjek kërkesat e ardhura në Sektor, kthen përgjigje sipas rasteve përgatit rekomandimet përkatëse.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori me Titull/Gradë

Ky sektor e shtrin ekspertizën e tij në dy fusha: **Sigurinë dhe Shëndetin në punë**

Është përgjegjës për mirëfunksionimin e punëve në sektor duke kryer ndarjen e detyrave të çdo specialisti sipas temave përkatëse.

Përgjigjet para drejtuesit të Njesisë bazë (Departamentit) për çdo problem apo aktivitet në lidhje me sektorin e tij. Merr pjesë në aktivitete të hartimit të rregulloreve, materialeve për promovimin e parandalimit të aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe toksikologjisë.

Mbledh dhe përpunon informacionin për të përcaktuar shkaqet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Përgatit ose kontrollon dhe monitoron raportet për çdo aksident në punë të deklaruar, sipas formës standarde të raportimit.

Përgatit ose kontrollon dhe monitoron raportet për çdo sëmundje profesionale të deklaruar, sipas formës standarde të raportimit.

Merr pjesë në kërkime dhe programe ndërhyrjesh të shëndetit publik në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Vlerëson çdo material të ardhur në sektor nga institucionet kompetente.

Organizon aktivitete trajnuese të edukimit në vazhdim, që sigurojnë përditësimin e njohurive për sigurinë dhe aksidenteve në punë në shëndet publik.

Përfshirje në krijimin dhe organizimin e programeve trajnuese në fushën e sigurisë dhe aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe toksikologjisë për çdo person që kryen kursin e trajnimit pranë ISHP-së.

Përshkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë

Merr pjesë në aktivitete të hartimit të rregulloreve, materialeve për promovimin e parandalimit të aksidenteve në punë.

Mbledh dhe përpunon informacionin për të përcaktuar shkaqet e aksidenteve në punë.

Është personi i kontaktit për raportimin e aksidenteve në punë nga specialistët e çdo NJKVSH-je.

Përgatit raportin e hollësishëm për çdo aksident në punë të deklaruar, sipas formës standarde të raportimit.

Merr pjesë në kërkime dhe programe ndërhyrjesh të shëndetit publik në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Vlerëson çdo material të ardhur në sektor nga institucionet kompetente.

Përfshirje në aktivitete trajnuese të edukimit në vazhdim që sigurojnë përditësimin e njohurive për sigurinë dhe aksidenteve në punë në shëndet publik.

Përfshirje në krijimin dhe organizimin e programeve trajnuese në fushën e sigurisë dhe aksidenteve në punë për çdo person që kryen kursin e trajnimit pranë ISHP-së.

Merr pjesë në aktivitete të hartimit të rregulloreve dhe materialeve për promovimin e parandalimit të sëmundjeve profesionale.

Mbledh informacion dhe përpunon të dhënat për sëmundjet profesionale.

Është personi i kontaktit për raportimin e sëmundjeve profesionale nga specialistët e çdo NJKVSH-je.

Përgatit raportin e hollësishëm për çdo sëmundje profesionale të deklaruar.

Merr pjesë në kërkime dhe programe ndërhyrjesh të shëndetit publik në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Vlerëson çdo material të ardhur në sektor nga institucionet kompetente.

Përfshirje në aktivitetet trajnuese të edukimit në vazhdim që sigurojnë përditësimin e njohurive për sigurinë në punë dhe sëmundjet profesionale në shëndet publik.

Përfshirje në krijimin dhe organizimin e programeve trajnuese në fushën e sigurisë në punë dhe sëmundjeve profesionale për çdo person që kryen kursin e trajnimit pranë ISHP-së.

Merr pjesë në aktivitete të hartimit të rregulloreve dhe materialeve për promovimin e parandalimit të helmimeve aksidentale dhe të përhershme.

Mbledh informacion dhe përpunon të dhënat për substancat toksike me risk në vendin e punës. Është personi i kontaktit për raportimin e aksidenteve në punë nga specialistët e çdo NJKVSH-je. Përgatit raportin e hollësishëm për çdo situatë të helmimit nga lëndë toksike në vendin e punës. Merr pjesë në kërkime dhe programe ndërhyrjesh të shëndetit publik në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Vlerëson çdo material të ardhur në sektor nga institucionet kompetente.

Përfshirje në aktivitete trajnuese të edukimit në vazhdim që sigurojnë përditësimin e njohurive për sigurinë dhe shëndetin në punë, për toksikologjinë në ambientet e punës. Përfshirje në krijimin dhe organizimin e programeve trajnuese në fushën e sigurisë në punë dhe sëmundjeve profesionale për çdo person që kryen kursin e trajnimit pranë ISHP-së.

Përshkrimi i punës: Laborant

Varet nga shefi i Sektorit, merr detyra, porosi dhe urdhra prej tij dhe raporton për zbatimin e tyre. Harton planin e punës dhe i miraton ato tek shefi i Sektorit.

Përgatit dhe raporton te shefi i Sektorit, realizimin e detyrave të planifikuara të Toksikologut;

Përgatit raporte në lidhje me aktiviteti periodik të laboratorit dhe i dërgon në kohë ato tek shefi i Sektorit.

Informon shefin e Sektorit për probleme të ndryshme të veprimtarisë si toksikolog duke kërkuar sipas rastit edhe mbështetjen e tij.

Bën vlerësime përmblledhëse të gjendjes për problemet e konstatuara dhe nxjerr propozimet e duhura për përmirësimin e punës.

Raporton për punën tekniko-profesionale të tij dhe propozon temat për vitin në vijim, duke planëzuar mbështetjen nga shefi i Sektorit.

Mban statistika të sakta mbi aktivitetin e punës së tij dhe i raporton në kohë ato. Kjo veprimtari dokumentohet në të gjitha praktikatat e sektorit.

Sipas kërkesave të ndryshme merr pjesë në ekspertiza dhe përgatit raportin përkatës.

merr pjesë në studimet e ndryshme që kryen sektori.

Merr pjesë në grupet e punës për mbledhje dhe përpunim të informacionit të ardhur sipas zonave në situata emergjente.

23.5.Sektori i Sigurisë Ushqimore

Ky sektor e artikulon ekspertizën e tij në dy fusha: **Siguri Ushqimore** dhe **Ushqyerje**.

Në fushën e Sigurisë Ushqimore ky sektor ka si mision të tij parësor mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së popullatës nëpërmjet zhvillimit të njohurive, mjeteve dhe ndërhyrjeve që synojnë parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve me origjinë ushqimore.

Për të arritur këtë mision, ky seksion kryen shumë aktivitete brenda ISHP-së, në të gjithë vendin.

Këto aktivitete përfshijnë:

Projekte mbështetëse që ndërtojnë kapacitete të shëndetit mjedisor, kapacitete epidemiologjike dhe laboratorike, në nivel kombëtar dhe lokal.

Sigurimin e informacionit dhe rekomandimeve, bazuar nëurvejancën dhe epidemiologjinë e shëndetit publik, që kanë implikime për politikat e sigurisë ushqimore.

Pjesëmarrje në partneritet që informojnë konsumatorët, ofruesit e kujdesit shëndetësor, profesionistët e shëndetit publik, dhe të tjerët në sektorin publik dhe privat rreth parandalimit dhe menaxhimit të sëmundjeve me origjinë ushqimore.

Funksionet e Seksionit të Ushqyerjes lidhen me ato aktivitete (procese, praktika, shërbime dhe programe) të cilat ndërmerren me qëllim promovimin e të ushqyerit optimal, shëndetit dhe mirëqenies në popullatë.

Seksioni i Ushqyerjes kryen monitorimin e gjendjes ushqyese të popullatës dhe ndikimin e dietës në shëndet, monitorim për zbulimin në kohë të gjendjeve si pasojë e pamjaftueshmërive nutricionalë me rëndësi në shëndet publik, për të promovuar ushqyerje të shëndetshme dhe përmirësim të të ushqyerit.

Në bashkëpunim me institucionet lokale ky sektor kryen matje antropometrike, ekzaminime klinike, analiza biokimike dhe testime të konsumit të ushqimit, për të vlerësuar statusin e të ushqyerit dhe zakonet dietike të popullatës.

Në bashkëpunim me ministrinë e linjës përfshihet në zhvillimin e politikave kombëtare të ushqimit dhe ushqyerjes, standarde dhe norma të konsumit të grupeve të caktuara të popullatës, si dhe udhëzime dhe materiale për të promovuar ushqim të shëndetshëm.

Seksioni merr pjesë në projekte mjekësore dhe shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës sektori me Titull/Gradë

Sektori i Sigurisë Ushqimore dhe Ushqyerjes është përgjegjës për zhvillimin e veprimtarive të mbikëqyrjes në të ushqyerit; të ofrimit të informacionit të plotë për popullatën; drejtimit dhe zhvillimit të veprimtarive të mbikëqyrjes epidemiologjike dhe të diagnozës laboratorike, të sëmundjeve të shkaktuara nga ushqimi; dhe një nga aktorët e sistemit të shëndetit publik që marrin pjesë në sigurimin e qëndrueshëm dhe të përballueshëm të sasisë e të cilësisë së duhur të ushqimeve të sigurt dhe të shëndetshme për çdo individ.

Ky sektor e artikulon ekspertizën e tij në dy fusha: **Siguri Ushqimore dhe Ushqyerje.**

1. Në fushën e Sigurisë Ushqimore ky sektor ka si mision të tij primar mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së popullatës nëpërmjet zhvillimit të njohurive, mjeteve dhe strategjive që synojnë parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve me origjinë ushqimore.

Seksioni i Sigurisë Ushqimore ndihmon në parandalimin dhe uljen e barrës së sëmundjeve, paafëtisë, dhe vdekjeve nga sëmundjet me origjinë ushqimore të shkaktuara nga ndotës të natyrës bakteriale, fizike dhe kimike.

Për të arritur këtë mision, ky seksion kryen shumë aktivitete brenda ISHP-së, dhe në të gjithë vendin.

Këto aktivitete përfshijnë:

Veprimtari të mbikëqyrjes epidemiologjike dhe të diagnozës laboratorike, të sëmundjeve të shkaktuara nga ushqimi

Hartimin dhe koordinimin e projekteve mbështetëse që ndërtojnë kapacitete në shëndetin mjedisor, kapacitete epidemiologjike dhe laboratorike në nivel kombëtar dhe lokal.

Sigurimin e informacionit dhe rekomandimeve, bazuar nëurvejancën dhe epidemiologjinë e shëndetit publik, që kanë implikime për politikat e sigurisë ushqimore.

Pjesëmarrje në partneritet që informojnë konsumatorët, ofruesit e kujdesit shëndetësor, profesionistët e shëndetit publik, dhe të tjerët në sektorin publik dhe privat rreth parandalimit dhe menaxhimit të sëmundjeve me origjinë ushqimore.

Koordinimin dhe bashkëpunimin me Organizatat Ndërkombëtare (INFOSAN, EHO, AGISAR, FERG, IFSA) për zhvillimin e projekteve në fushën e Sigurisë Ushqimore, bazuar në forcimin e kapaciteteve teknike dhe laboratorike në ISHP, dhe Institucione të tjera të kësaj fushe (ISUV, AKU, UBT).

2. Funksionet e Seksionit të Ushqyerjes lidhen me ato aktivitete (procese, praktika, shërbime dhe programe) të cilat ndërmerren me qëllim promovimin e të ushqyerit optimal, shëndetit dhe mirëqenies në popullatë.

Seksioni i Ushqyerjes kryen vlerësime të gjendjes ushqyese të popullatës dhe ndikimin e dietës në shëndet, sidomos në zbulimin në kohë dhe zgjidhjen e gjendjeve si pasojë e pamjaftueshmërive nutricionalë me rëndësi në shëndet publik, për të promovuar ushqyerje të shëndetshme dhe sa më të përmirësuar.

Në bashkëpunim me institucionet lokale ky sektor kryen matje antropometrike, ekzaminime klinike, analiza biokimike dhe testime të konsumit të ushqimit për të vlerësuar statusin e të ushqyerit dhe zakonet dietike të popullatës.

Në bashkëpunim me ministrinë e linjës zhvillon politika kombëtare të ushqimit dhe ushqyerjes, standarde dhe norma të konsumit të grupeve të caktuara të popullatës, si dhe udhëzime dhe materiale për të promovuar ushqim të shëndetshëm.

Seksioni merr pjesë në projekte mjekësore dhe shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pesëkrimi i punës: Specialist me Titull/Gradë / të sigurisë ushqimore

Përfshirje në aktivitete të parandalimit të sëmundjeve (shkaqeve) me origjinë ushqimore.

Përfshirje në veprimtari të mbikëqyrjes dhe të diagnozës laboratorike, të sëmundjeve të shkaktuara nga ushqimi.

Pjesëmarrje në partneritet që informojnë konsumatorët, ofruesit e kujdesit shëndetësor, profesionistët e shëndetit publik dhe të tjerët në sektorin publik dhe privat rreth parandalimit dhe menaxhimit të sëmundjeve me origjinë ushqimore.

Pjesëmarrje në kërkime dhe programe ndërhyrjesh të shëndetit publik në fushën e sigurisë ushqimore.

Marrje ose pritje e mostrave ushqimore nga subjekte apo individë për kryerjen e analizave në laboratore dhe kthimi i përgjigjeve të çdo shkresë që vjen në sektor.

Dhënie e mendimeve për çdo material të ardhur në sektor nga institucionet kompetente.

Përfshirje në aktivitete që sigurojnë ngritjen profesionale të stafit dhe përditësimin e njohurive dhe përsosjen e kompetencave për sigurinë ushqimore në shëndet publik.

Përfshirje në krijimin e kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë ushqimore, nëpërmjet përgatitjes së materialeve trajnuese, si dhe organizimit të trajnimeve pranë Sektorit të Ushqyerjes të specialistëve të NJVKSHP-ve të rretheve, ashtu edhe studentëve të niveleve të ndryshme (bachelor/master/doktoraturë) që vijnë për praktikë në ISHP.

Specialist me Titull/Gradë /shkenca e të ushqyerit

Përfshirje në studimet e kërkimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të gjendjes ushqyese të popullatës dhe ndikimin e dietës në shëndet, të zbatuara si nga ISHP-ja, edhe në bashkëpunim me institucione apo organizata të shëndetit partnere me të (ËHO/UNICEF/FAO etj). Përfshirja përfshin çdo fazë: hartim, propozim, "field work" apo analizë dhe shkrim raporti të rezultateve.

Përfshirje në përgatitjen e materialeve dhe aktiviteteve të informimit, edukimit apo promovimit mbi ushqyerjen e shëndetshme të popullatës.

Përfshirje në krijimin e kapaciteteve profesionale në fushën e ushqyerjes, nëpërmjet përgatitjes së materialeve trajnuese, si dhe organizimit të trajnimeve pranë Sektorit të Ushqyerjes të specialistëve të NJVKSHP-ve të rretheve, ashtu edhe studentëve të niveleve të ndryshme (bachelor/master/doktoraturë) që vijnë për praktikë në ISHP.

Përfshirje në procese politikash në fushën e ushqyerjes dhe shëndetit publik, si: hartime projektligjesh të rinj apo përditësime të ligjeve ekzistuese, VKM-ve, udhëzuesve për ushqyerje të shëndetshme, vlerësim normash ushqimore për grup-popullata të ndryshme etj.

Prodhim (botime, paraqitje në aktivitete shkencore kombëtare/ndërkombëtare) të materialeve shkencore në fushën e ushqyerjes në shëndet publik.

Përfshirje në aktivitete që sigurojnë ngritjen profesionale të stafit dhe përditësimin e njohurive dhe përsosjen e kompetencave për ushqyerje në shëndet publik.

Përfshirje dhe dhënie përgjigje/zgjidhjeje çdo kërkesë drejtuar Sektorit të Sigurisë Ushqimore nga palë të treta.

Përshkrimi i punës: Laborant

Zbatimi i të gjitha detyrave dhe udhëzimeve që rrjedhin nga Rregullorja e sektorit dhe detyrat e ngarkuara nga kuadri i lartë.

Kujdesi për dokumentacionin e sektorit dhe mirëmbajtja e tij. Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm me bazë materiale ndihmëse për punën në sektor. Marrja pjesë aktive në mbledhjen e informacioneve nga rrethet.

Përgatitja e të dhënave nga fishat e ardhura nga rrethet në bazë të kërkesave të kuadrit të lartë për përgatitje të monitorimit të kripës së jodizuar.

Mbledhja e të dhënave analitike nga laboratorët (ISH/DSHP). Hedhja e të dhënave në kompjuter gati për përpunim.

Vlerësimi i të gjithë informacioneve, analizave të ardhura nga DSHP-të e rretheve dhe Laboratorit Ushqimor/Jodit i ISHP-së.

Marrja pjesë në të gjitha temat studimore dhe programet e hartuara nga kuadri i lartë, si dhe studimet e realizuara në rrethe në përbërje të grupit të punës dhe në programet e ndryshme studimore. Realizimi i marrjes së mostrave (kripë, urinë) dhe matjet antropometrike sipas kërkesave për marrjen e mostrave, studimeve në zbatim.

Hedhja e të dhënave në kompjuter të formularëve dhe fishave të monitorimit të jodit në kripë, të ardhura nga DSHP-të e rretheve dhe Laboratorit Ushqimor të Jodit.

Neni 24

NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I PERFORMANCËS SHËNDETIT PUBLIK DHE SËMUNDJEVE KRONIKE

Departamenti është i organizuar në pesë sektorë:

Departamenti i Performancës së Shëndetit Publik dhe Sëmundjeve Kronike ushtron aktivitetin e vet në bashkëpunim të ngushtë me departamentet e tjera shkencore të ISHP-së, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Spitalet Universitare Obstetrike-Gjinekologjike “Mbretëresha Geraldinë” dhe “Koço Gliozheni”, Spitalin Universitar të Traumës, Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në bazë rajoni dhe Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor në bazë rrethi, Ofruesit jopublikë të Kujdesit Shëndetësor në vendin tonë, si dhe sektorët publikë jashtë sferës së shëndetësisë dhe/ose organizma/organizata të ndryshme jopublike brenda dhe jashtë vendit.

Departamenti e bazon punën e tij në ligjet si ai i Shëndetit Publik nr. 10138, datë. 11.5.2009, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 28.5.2014 “Për përcaktimin e formatit dhe mënyrës së mbledhjes së informacionit shëndetësor”, e shumë ligje të tjera me ndikim në fushën e shëndetit publik.

Gjithashtu, puna bazohet edhe në dokumente të shumtë strategjikë, të tillë si: Strategjia e Shëndetësisë 2021-2030; Plani Kombëtar mbi Kanceret 2022-2030, Plani Kombëtar mbi Sëmundjet Jo të Transmetueshme 2022-2030, Plani i Veprimit të Promocionit Shëndetësor 2022-2030; Plani i Veprimit të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues 2022-2030; Strategjia Kombëtare e Sigurimit të Kontraceptivëve 2022-2026, etj.

Vizioni

Një popullatë e shëndetshme pa sëmundje kronike të parandalueshme.

Misioni

Nxitja e politikave të bazuara në fakte dhe evidencë, si dhe mbështetja e përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të kujdesit shëndetësor në fushën e sëmundjeve jo të transmetueshme duke identifikuar problemet në çështje të tilla si:

- Nevojat për shërbime dhe aksesin në shërbime,
- Ekspozimi ndaj faktorëve të rrezikut dhe sjelljeve të rrezikshme,
- Kapacitetet njerëzore dhe teknologjike,
- Diagnoza e hershme dhe depistimi,
- Monitorimi i performancës dhe cilësisë etj.,

duke ndihmuar në propozimin dhe pilotimin e zgjidhjeve të përshtatshme për vendin tonë dhe duke mbështetur trajnimin e personelit shëndetësor në sistemin e kujdesit parësor dhe atë të shëndetit publik.

Gjithashtu, departamenti ndihmon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rritjen e ndërgjegjësimin të popullatës për çështjet që lidhen me shëndetin dhe faktorët që kontribuojnë në shëndet, duke ofruar informacion dhe duke mbështetur ndryshimin drejt sjelljeve të shëndetshme.

Detyrat

Departamenti kryen detyra menaxhuese, mbikëqyrëse, monitoruese, vlerësuese, analizuese, rekomanduese dhe trajnuese.

- Menaxhim i shërbimeve të lëvizshme të zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit, në koordinim me shërbimet rajonale të shëndetit publik dhe kujdesin shëndetësor parësor.
- Koordinim i programit kombëtar të depistimit mbi kancerin e qafës së mitrës.
- Menaxhim i sistemeve të informacionit lidhur me regjistrat e disa sëmundjeve kronike me rëndësi të veçantë për shëndetin publik.
 - Infarkti i miokardit (IAM)
 - Aksidentet cerebrovaskulare (ACV)
 - Kanceret
 - Diabeti
- Menaxhim i sistemeve kombëtare të survejancave të bazuara në rast, të tilla si:
 - Abortet
 - Defektet e lindura (anomalitë e lindura)
- Monitorim i shërbimeve të planifikimit familjar. Programi LMIS për metodat moderne kontraceptive.
- Monitorim i sistemeve të informacionit kombëtar mbi drogat dhe prodhimi i raporteve periodike.
- Propozon rishikimin e vazhdueshëm të indikatorëve të monitorimit të sëmundjeve jo të transmetueshme.

- Ndërton dhe ofron kurse të akredituara të trajnimit në fusha të ndryshme të shëndetit publik për mjekët e kujdesit parësor, infermierët dhe punonjësit e shëndetit publik.
 - Mbështet programet e arsimit të shëndetit publik në fushën e epidemiologjisë dhe kontrollit të sëmundjeve jo të transmetueshme.
 - Ndërmerr rekomandime mbi politikat shëndetësore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar mbi analizën e eksperiencës ndërkombëtare, dhe eksperiencën nga studimet dhe ndërhyrjet në vendin tonë (ligje, strategji, udhëzues, standarde, praktika, organizim, sisteme, teknologji etj.).
 - Mbështet në vijimësi MSHMS-në në procesin e përgatitjes së strategjive dhe politikave specifike për sëmundjet jo të transmetueshme.
 - Drejton dhe mbikëqyr studime (sasiore dhe cilësore) në popullatë me qëllim vlerësimin e situatave shëndetësore të veçanta mbi sëmundjet jo të transmetueshme, përdorimin e shërbimeve shëndetësore, sjelljeve të rrezikshme dhe faktorëve të rrezikut.
 - Kryen studime dhe analiza në fushën e sistemeve shëndetësore dhe në fushën e politikave shëndetësore, (kërkime në popullatë, në sistemet shëndetësore ose në literaturë). Prodhimi i raporteve përkatëse.
 - Vlerëson ndërhyrjet shëndetësore parandaluese me qëllim verifikimin e kushteve për shtrirjen e tyre në plan të gjerë. Mbështet zbatimin në praktikë të politikave të reja në fushën e kontrollit të sëmundjeve jo të transmetueshme nëpërmjet organizimit të programeve të trajnimit, seminareve, ëorkshopeve, dhe konferencave shkencore.
 - Drejton fushata të edukimit dhe ndërgjegjësimit shëndetësor të grupeve të ndryshme të popullatës, në bashkëpunim me autoritetet shëndetësore rajonale.
 - Përgatit materiale informative për publikun dhe profesionistët e shëndetësisë fletëpalosje, broshura, manualë, udhëzues, protokolle etj.
 - Skicon programe të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe koordinon punën mes partnerëve të mundshëm.
- Përgatit raporte dhe artikuj për periodikët shkencorë dhe operativë në fushën e shëndetësisë.

Departamenti punon për prodhimin dhe/ose monitorimin në vijimësi të një sërë indikatorësh shëndetësorë, të tillë si:

- Vdekshmëria foshnjore, fëmijërore dhe perinatale.
- Prevalenca e aborteve dhe e defekteve të lindura të regjistruara nga shërbimet e obstetri-gjinekologjisë, neonatologjisë dhe pediatriisë.
- Incidenca vjetore e infarktit të miokardit, aksidenteve cerebro-vaskulare, kancereve, diabetit.
- Prevalenca vjetore e sëmundjeve obstruktive kronike të mushkërive dhe aksidenteve të regjistruara nga shërbimet përkatëse.
- Prevalenca e depresionit, tentativës për vetëvrasje, dhimbjes etj., të matura në sisteme shëndetësore dhe në popullatë në grup-mosha të përzgjedhura.
- Shëndeti total i vetëvlerësuar dhe sëmundjet totale të vetëvlerësuara në grup-mosha të përzgjedhura.
- Indikatorë specifikë të programeve të depistimit.

- Indikatorë të përdorimit të shërbimeve shëndetësore.
- Prevalenca e kufizimeve në aktivitetet e përditshme dhe autonomi e matur në grup-mosha të përzgjedhura.
- Prevalenca e disa faktorëve të rrezikut të matur në popullatë në grup-mosha të përzgjedhura:
 - Mbipesha dhe nënpesha
 - Anemia
 - Tensioni i lartë i gjakut
 - Kequshqyerja
 - Aktiviteti fizik
 - Duhanpirja
 - Abuzimi me alkoolin
 - Konsumi i drogave të paligjshme
 - Mbulimi me shërbime të kujdesit shëndetësor parësor
 - Mbulimi me shërbime të depistimit (përfshi check-up, kanceri i gjirit, i cerviksit dhe kolorektal)
 - Mungesa e njohurive bazë lidhur me shëndetin.

24.1.Sektori i sëmundjeve kronike

Misioni

Të sigurojë udhëheqje dhe drejtim në përpjekjet për të kontrolluar dhe parandaluar sëmundjet jo të transmetueshme dhe faktorët e tyre të rrezikut.

- Qasje gjithëpërfshirëse, e integruar dhe hap pas hapi e survejancës, parandalimit dhe menaxhimit; Qasje e bazuar në evidencë (të dhëna), dhe qasje prodrejtësisë; Bashkëveprim multisektorial.

Sektori i Sëmundjeve Kronike është qendra kombëtare në fushën e shëndetit publik për prodhimin e indikatorëve shëndetësorë, kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve kronike jo të transmetueshme, epidemiologjinë e shëndetit riprodhues, studimin/kërkimin mbi epidemiologjinë e sëmundjeve jo të transmetueshme dhe faktorët e rrezikut të lidhura me këto sëmundje, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e regjistrave të sëmundjeve jo të transmetueshme në Shqipëri. Ai ka për funksion të kryejë kërkime kualitative dhe kuantitative në ndihmë të politikave dhe strategjive të shëndetit, të monitorojë dhe vlerësojë ndikimin e ndërhyrjeve në fushën e shëndetit publik, të nxisë/mbështesë koordinimin ndërinstitutional, dhe të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve në fushat e menaxhimit, planifikimit dhe ekonomisë shëndetësore, me synim mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve në shëndetësi.

Objektivat

- a. Menaxhimi, funksionimi dhe mbikëqyrja e Regjistrave Kombëtarë të Sëmundjeve Jo të Transmetueshme (mbledhja, ruajtja, analizimi dhe interpretimi i të dhënave të grumbulluara nga regjistrat e sëmundjeve jo të transmetueshme).
- b. Prodhimi periodik i indikatorëve të ndryshëm shëndetësorë dhe veçanërisht të indikatorëve të sëmundjeve jo të transmetueshme, dhe i indikatorëve rreth faktorëve të rrezikut për këto sëmundje.
- c. Rishikimi i vazhdueshëm i indikatorëve të monitorimit të sëmundjeve jo të transmetueshme.
- d. Studime mbi Epidemiologjinë dhe Kontrollin e Sëmundjeve jo të Transmetueshme dhe mbi Politikën Shëndetësore.
- e. Studime mbi faktorët e rrezikut dhe sjelljet me rrezik për sëmundjet jo të transmetueshme.
- f. Studime në fushën e Epidemiologjisë së Shëndetit Riprodhues.
- g. Bashkëpunimi i ngushtë ndërsektorial dhe ndërinstitutional (sektorë dhe departamente të tjerë të Institutit të Shëndetit Publik, me institucione dhe organizata të tjera publike dhe jopublike në vend, dhe median e folur dhe të shkruar).
- h. Hartimi dhe prodhimi i raporteve, rekomandimeve dhe mbështetje në vijimësi e MSHMS-së në procesin e përgatitjes së strategjive e politikave shëndetësore në vendin tonë, në fushën e sëmundjeve jo të transmetueshme (përfshirë sëmundjet kardio-cerebro-vaskulare, kancerin, diabetin, sëmundjet pulmonare kronike, sëmundjet e shëndetit mendor etj).
- i. Ngritjen e kapaciteteve (nivelit teoriko-shkencor dhe metodik) të punonjësve të vet nëpërmjet trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, si dhe nëpërmjet studimit të udhëzimeve, protokolleve dhe literaturës bashkëkohore.
- j. Mbështetje me trajnime të stafit shëndetësor dhe stafit të shëndetit publik në mbarë vendin.
- k. Mbështetje e programeve të arsimimit të shëndetit publik në fushën e epidemiologjisë dhe kontrollit të sëmundjeve jo të transmetueshme.

Përshkrimi i punës: Përgjegjësi i Sektorit të Sëmundjeve Kronike

Duhet të organizojë, të drejtojë dhe të analizojë veprimtarinë e sektorit të sëmundjeve kronike, regjistrave kombëtarë të sëmundjeve jo të transmetueshme, dhe të shërbimeve përkatëse në nivel sektori, dhe pranë shërbimeve vendore të kujdesit shëndetësor në rrethe.

Duhet një raport mbi pasqyrimin e trendit të sëmundjeve jo të transmetueshme përfshirë dhe shëndetin seksual dhe riprodhues në vend dhe të raportohen indikatorët kryesorë në MSHMS-ë, si dhe të bëhet lidhja e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë mes ISHP-së, FSDKSH-së dhe INSTAT.

Të punohet për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe hartimin e raporteve bazuar në indikatorët shëndetësorë të sëmundjeve jo të transmetueshme.

Të ofrojë mbështetje për strategjinë kombëtare të sëmundjeve kronike, sëmundjeve kardiovaskulare, të kancerit, diabetit, të shëndetit riprodhues dhe planifikimit familjar.

Të marrë pjesë në trajnime e konferenca, brenda e jashtë vendit, si dhe botime në buletin/revista shkencore në kuadër të punës kërkimore.

Të ofrojë trajnime të vazhdueshme për personat përgjegjës të regjistrave të sëmundjeve jo të transmetueshme përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues në rrethe (deri në nivel NJVKSH-je) lidhur me mirëfunksionimin e tyre.

Përshkrimi i punës: Specialist/me titull/gradë

Specialist për shëndetin riprodhues dhe të fëmijëve

Të ndiqet ecuria e Sistemit të Survejancës së Abortit, mbledhja dhe raportimi periodik i informacionit mbi abortet në të gjithë vendin (sektori publik dhe privat), si dhe të monitorohen qendrat e raportimit.

Të prodhohet një raport vjetor mbi pasqyrimin e trendit të aborteve në vend dhe të raportohen indikatorët kryesorë në MSHMS dhe INSTAT.

Të monitorohen prirjet e vdekshmërisë foshnjore, fëmijërore, neonatale dhe perinatale, si dhe të studiohen faktorët e mundshëm të rrezikut dhe shkaqet e lidhura me to.

Të studiojë dhe identifikojë problemet e mangesitë në programet për kujdesin ndaj fëmijëve dhe të rinjve.

Të punohet për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe hartimin e raporteve bazuar në indikatorët shëndetësorë të sëmundjeve joinfektive.

Pjesëmarrje në trajnime e konferenca online, si dhe botime në buletin/revista shkencore në kuadër të punës kërkimore.

Specialist për programin e planifikimit familjar

Të ndjekë ecurinë e Sistemit të Shpërndarjes së Kontraceptivëve (LMIS).

Të grumbullojë të dhënat periodike tremujore nga raportimi i rretheve.

Të analizojë të dhënat dhe të planifikojë shpërndarjen e nevojave për kontraceptivë për çdo rreth.

Të ndihmojë për hartimin e politikave në këtë fushë, përfshi Dokumentin e Plan-Veprimit të Sigurimit të Kontraceptivëve 2022-2026.

Specialist për regjistrin e kancerit

Të ndiqet ecuria e regjistrit të kancerit, mbledhja dhe raportimi vjetor i informacionit mbi rastet me kancer në të gjithë vendin (sektori publik dhe privat), si dhe të monitorohet cilësia e raportimit.

Të prodhohet një raport vjetor mbi pasqyrimin e trendit të rasteve me kancer në vend, dhe të raportohen indikatorët kryesorë në MSHMS-së, si dhe të bëhet lidhja e sëmundshmërisë me vdekshmërinë nga INSTAT.

Të punohet për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe hartimin e raporteve bazuar në indikatorët shëndetësorë të sëmundjeve joinfektive.

Pjesëmarrje në trajnime e konferenca, brenda e jashtë vendit, si dhe botime në buletin/revista shkencore në kuadër të punës kërkimore.

Specialist për programet e depistimit të kancerit (kanceri i qafës së mitrës, kanceri i gjirit, kanceri kolorektal)

Të ndiqet ecuria e Programit të Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës në të gjitha qendrat e kujdesit shëndetësor parësor dhe njësitë vendore të kujdesit shëndetësor.

Logjistika e shpërndarjes, mbledhjes së kитеve të HPV-së, dhe dhënia e rezultateve grave të depistuar.

Monitorimi i ecurisë së programit për verifikimin e kujdesit për gratë që kanë rezultuar pozitive në depistimin primar.

Zhvillimi i ëorkshopeve rajonale për cilësinë e të dhënave dhe ngritja e regjistrave të depistimit dhe të diagnozës pranë kabineteve të kolposkopisë atje ku funksionojnë, dhe raportimi vjetor i informacionit mbi rastet e kapura me leziona preneoplazike dhe me kancer të qafës së mitrës.

Koordinimi me spitalet universitare dhe ato rajonale lidhur me aktivitetin e kolposkopisë.

Menaxhimi i databazës kombëtare të programit të depistimit.

Pjesëmarrje në trajnime e konferenca online, si dhe botime në buletin/revista shkencore në kuadër të punës kërkimore.

Specialist për shëndetin e syrit dhe probleme të tjera të sëmundjeve jo të transmetueshme

Të monitorojë programin kombëtar të depistimit të shikimit të fëmijët e shkollave (përfshi menaxhimin e databazës kombëtare të këtij programi) dhe të sigurojë bashkëpunimin me nivelet e ndryshme të kujdesit shëndetësor.

Të prodhojë raporte të ndryshme me të dhëna dhe analizë të detajuar të informacionit, duke filluar nga hedhja e të dhënave, analizimi tyre dhe hartimi i rekomandimeve në përputhje me politikat shëndetësore.

Të bëhet menaxhimi dhe analizimi i databazave të raportuara për sëmundjet kronike. Përgatitja e kornizës së indikatorëve që duhen raportuar lidhur me sëmundjet jo të transmetueshme.

Të bëhet kryerja e monitorimeve të vazhdueshme lidhur me cilësinë dhe sasinë e raportimit të të dhënave në sektorin publik e privat në Tiranë dhe rrethet e tjera të vendit, në kuadër të ndjekjes së ecurisë së treguesve lidhur me sëmundjet kronike.

Të bëhen botime në revista shkencore, buletine vjetore dhe referime në seminare, në kuadër të punës kërkimore, si dhe pjesëmarrja në trajnime, takime dhe konferenca të ndryshme të zhvilluara në kuadër të dinamikës së sëmundjeve jo të transmetueshme.

Specialist i shëndetit oral dhe probleme të tjera të sëmundjeve jo të transmetueshme

Të monitorojë programin kombëtar të shëndetit oral të fëmijët e shkollave (përfshi menaxhimin e databazës kombëtare të këtij programi) dhe të sigurojë bashkëpunimin me nivelet e ndryshme të kujdesit shëndetësor.

Të menaxhohet dhe të bëhet analizimi i databazave të raportuara për sëmundjet kronike, si dhe prodhimi i raporteve të ndryshme me të dhëna dhe analizë të detajuar, në përputhje me përgatitjen e kornizës së indikatorëve që duhen raportuar çdo vit lidhur me sëmundjet kronike.

Monitorime të vazhdueshme lidhur me cilësinë dhe sasinë e raportimit të të dhënave në sektorin publik e privat në Tiranë, në kuadër të dinamikës së sëmundjeve kronike.

Të bëhen botime në revista shkencore/buletine vjetore dhe referime në seminare, trajnime e konferenca kombëtare e ndërkombëtare, në kuadër të punës kërkimore.

Të angazhohet dhe të marrë pjesë në trajnime, në rrethe lidhur me mirëfunksionimin e sistemit të monitorimit dhe survejancës të sëmundjeve jo të transmetueshme, si dhe pjesëmarrje në studime dhe projekte të kryera në ISHP, apo nisma të ndërmarra nga departamenti në fushën e sëmundjeve kronike.

24.2.Sektori i Sistemeve Shëndetësore

Misioni

Të vlerësojë kapacitet e sistemeve shëndetësore (të shërbimeve shëndetësore, infrastrukturës dhe burimeve njerëzore) duke u fokusuar tek aksesit, barazia, efikasiteti, cilësia dhe qëndrueshmëria, me qëllim përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe shëndetin e popullatës.

Objektivat

- a. Përgatitja e një plani të detajuar dhe të përditësuar të vlerësimit të kapaciteteve të sistemeve shëndetësore {kujdesi shëndetësor parësor, kujdesi shëndetësor spitalor (të gjitha nivelet), shëndeti publik}.
- b. Hartimi i rekomandimeve të duhura, bazuar në vlerësimin e kapaciteteve të sistemeve shëndetësore, me qëllim që cilësia e shërbimeve shëndetësore të jetë e shpërndarë sipas nevojave të popullatës dhe të gjithë të kenë akses në shërbime cilësore kur ata kanë nevojë.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës sektori

Të mbledhë të dhënat për funksionimin e sistemeve shëndetësore në Shqipëri.

Të krijojë rrjet komunikimi me të gjithë aktorët e sistemeve shëndetësore.

Të studiojë performancën dhe aksesin në shërbime në të gjitha nivelet, dhe të punojë për propozimet konkrete në lidhje me sistemet shëndetësore.

Përshkrimi i punës: Specialist/me titull/gradë

Përgatitja një plani të detajuar dhe të përditësuar të vlerësimit të kapaciteteve të sistemeve shëndetësore në Shqipëri.

Grumbullimi i informacionit në mënyrë sistematike, propozim i rekomandimeve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Grumbullimi i informacionit në mënyrë sistematike, propozim i rekomandimeve bazuar në vlerësimin e kapaciteteve të sistemeve shëndetësore, me qëllim që të gjithë të kenë akses në shërbime cilësore, kur ata kanë nevojë.

Koordinimin e punës brenda redaksisë së Buletinit të Institutit të Shëndetit Publik në përcaktimin e artikujve që do të publikohen në Buletin, punë kjo në bashkëpunim me drejtuesit e departamenteve të ISHP-së dhe me shefat e sektorëve përkatës.

Pjesëmarrje në trajnime e konferenca, brenda e jashtë vendit, si dhe botime në Buletin/Revista Shkencore në kuadër të punës kërkimore.

Përgatitja e një plani të detajuar dhe të përditësuar të vlerësimit e pabarazive në aksesin në shërbimet shëndetësore në Shqipëri.

Grumbullimi i informacionit në mënyrë sistematike dhe propozim i rekomandimeve, me qëllim që aksesin në shërbimet shëndetësore të jetë i shpërndarë sipas nevojave të popullatës.

Mbledhje, përpunim dhe analizë e indikatorëve të sistemeve shëndetësore.

Ofron mbështetje për sektorin e sëmundjeve jo të transmetueshme lidhur me menaxhimin e databazës së regjistrave (sëmundjet kardiovaskulare).

Pjesëmarrje në trajnime e konferenca online, si dhe botime në Buletin/Revista Shkencore në kuadër të punës kërkimore.

24.3.Sektori i Monitorimit dhe Vlerësimit të Shëndetit Publik

Misioni

Monitorimi dhe vlerësimi i një shkëmbimi sistematik të informacionit midis programeve, survejancave dhe aktiviteteve të ndërmarra në fushën e shëndetit publik, me qëllim që rezultatet e ndërhyrjeve në shëndetin publik të jenë në përputhje me planet, qëllimet dhe objektivat strategjikë të përcaktuara për vendin tonë.

Objektivat

- a. Mbështetja teknike për përgatitjen e standardeve lidhur me detyrat, përgjegjësitë dhe aftësitë e profesionistëve të shëndetit publik gjatë implementimit të të gjithë aktiviteteve të shëndetit publik në nivel rrethi, rajoni dhe qendror.
- b. Përgatitja e dokumentacionit të performancës teknike të profesionistëve të shëndetit publik, në nivel rrethi, rajoni dhe qendror.
- c. Ofrimi i feedback dhe identifikimi i problemeve rreth ecurisë së aktiviteteve të shëndetit publik në nivel rrethi, rajoni dhe qendror.
- d. Vlerësimi i rezultateve dhe aktiviteteve në fushën e shëndetit publik në bazë të indikatorëve të pritshëm, nëse janë arritur dhe identifikimi i masave përmirësuese.
- e. Planifikimi i trajnimeve të rregullta bazuar në vlerësimin e nevojave të specialistëve të shëndetit publik në nivel rrethi, rajoni dhe qendror.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës sektori me titull/gradë

Të mbështesë në mënyrë sistematike implementimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura me monitorimin e treguesve të shëndetit publik si në nivel rrethi, rajoni dhe qendror.

Të menaxhojë sistemet e informacionit lidhur me treguesit e shëndetësisë në nivel kombëtar dhe në mënyrë më specifike mbi sëmundjet jo të transmetueshme dhe sistemet kombëtare të survejancave nominale.

Studimi dhe korrektimi i problemeve të lidhura me kodifikimin e vdekjeve dhe sëmundjeve duke u bazuar në klasifikimin ndërkombëtar ICD9 dhe ICD10.

Të ndihmojë me trajnime të vazhdueshme lidhur me regjistrimin dhe kodifikimin e sëmundjeve dhe vdekjeve për të gjithë personat përgjegjës në të gjitha nivelet (nga mjeku i familjes, në spital, dhe nga bashkitë në INSTAT).

Përshkrimi i punës: Specialist /me titull/gradë

Specialist i treguesve të shëndetit publik dhe ICD9-10

Ndjek ecurinë e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit periodik shëndetësor në të gjithë vendin (sektori publik dhe privat) dhe verifikon përputhshmërinë me sistemet ndërkombëtare të kodifikimit të sëmundjeve.

Prodhon raporte periodike mbi sëmundshmërinë spitalore dhe vdekshmërinë.

Kryhen monitorime të vazhdueshme në sektorin publik dhe privat lidhur me cilësinë dhe sasinë e raportimit të treguesve.

Ndihmon me trajnime dhe supervizime mbështetëse në kalimin e sistemit kombëtar nga ICD9 në ICD10.

Pjesëmarrje në trajnime e konferenca online, si dhe botime në Buletin/Revista Shkencore në kuadër të punës kërkimore.

Specialist i informacionit shëndetësor dhe i programeve të kujdesit mbi moshimin

Ndjek ecurinë e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit periodik shëndetësor në të gjithë vendin (sektori publik dhe privat). Kryen monitorime të vazhdueshme në sektorin publik dhe privat lidhur me cilësinë dhe sasinë e raportimit të treguesve.

Prodhojnë raporte periodike me indikatorët kryesorë shëndetësorë të shëndetit të të moshuarve, si dhe tregues të kujdesit të integruar për të moshuarit në vend.

Ofron mbështetje për sektorin e sëmundjeve jo të transmetueshme lidhur me menaxhimin e databazave të regjistrave (kanceri).

Pjesëmarrje në trajnime e konferenca online, si dhe botime në Buletin/Revista Shkencore në kuadër të punës kërkimore.

Specialiste e informacionit mbi ekonominë dhe financat në sektorin shëndetësor

Ndjek ecurinë e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit periodik mbi financimin e sektorit shëndetësor në të gjithë vendin (sektori publik dhe privat). Kryen monitorime të vazhdueshme në sektorin publik dhe privat lidhur me cilësinë dhe sasinë e raportimit të treguesve financiarë në shëndetësi.

Prodhojnë raporte periodike me indikatorët kryesorë mbi shpenzimet në shëndetësi. Analizon prirjet dhe faktorët me ndikim.

Ofron mbështetje për sektorin e sëmundjeve jo të transmetueshme kur është e nevojshme.

Pjesëmarrje në trajnime e konferenca online, si dhe botime në Buletin/Revista Shkencore në kuadër të punës kërkimore.

Specialiste e testimit bioklinik në fushën e sëmundjeve jo të transmetueshme

Monitoron dhe studion ekzaminimet klinike me vlerë për shëndetin publik në sistemin shëndetësor shqiptar. Mbështet me ekzaminime dhe ekspertizë programet e studimit të një popullate, të monitorimit të faktorëve të rrezikut, si dhe programet e depistimit në kujdesin shëndetësor parësor.

Mbështet sa herë është e nevojshme departamentin e laboratorëve.

Përfshihet sa herë është e nevojshme për sigurimin e gatishmërisë për (covid-19) pranë Sektorit të Survejancës Laboratorike të Sëmundjeve Emergjente Virale.

Pjesëmarrje në trajnime e konferenca online, si dhe botime në Buletin/Revista Shkencore në kuadër të punës kërkimore.

Specialiste e informacionit shëndetësor

Ndjek ecurinë e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit periodik shëndetësor në të gjithë vendin (sektori publik dhe privat).

Siguron kompjuterizimin e të dhënave e sektorit.

Ofron mbështetje për sektorin e sëmundjeve jo të transmetueshme lidhur me menaxhimin e programeve të depistimit të kancerit (menaxhim informacioni, ndjekje e përgjigjeve për gratë e depistuar etj.).

Pjesëmarrje në trajnime e konferenca online, si dhe botime në Buletin/Revista Shkencore në kuadër të punës kërkimore.

2.4.4.Sektori i Sistemit të Integruar të Informacionit Shëndetësor dhe Funksionalitetit të Sistemit

Misioni

Grumbullimi dhe unifikimi i informacionit shëndetësor, përdorimi dhe diseminimi i strategjive efektive dhe bashkëkohore të komunikimit dhe informimit shëndetësor, me qëllimin final përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor, e reflektuar kjo në rritje dhe përmirësim të qëndrueshëm të rezultateve dhe tregueseve shëndetësor të popullatës së vendit.

Objektivat

- Grumbullimi periodik i informacionit shëndetësor.
- Kontrolli mbi sasinë dhe cilësinë e informacionit të grumbulluar.
- Menaxhimi i shpërndarjes së informacionit në mënyrë sistematike sipas të gjitha strukturave në varësi, në nivel rrethi, rajoni dhe qendror.
- Botimi periodik i Buletinit Shkencor të Institutit të Shëndetit Publik, që përfaqëson kanalin kryesor të komunikimit dhe diseminimit të informacionit shëndetësor të profesionistët e shëndetësisë dhe të gjithë aktorët dhe faktorët e sektorit të shërbimeve shëndetësore në nivel lokal dhe kombëtar, përfshirë edhe

agjencitë, organizmat dhe institucionet ndërkombëtare që asistojnë dhe mbështesin zhvillimin dhe përsosjen e sistemit të shërbimeve shëndetësore në Shqipëri.

- e. Prodhimi periodik i Revistës Mjekësore (në shqip) dhe Albanian Medical Journal (homologu në anglisht) përfaqëson mediumin e shkruar shkencor më të rëndësishëm (krahas njëherësh me Buletin e Shkencave Mjekësore të Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Tiranës) në fushën e shëndetësisë në vendin tonë. Kjo revistë përfaqëson kanalin kryesor të komunikimit të rezultateve të projekteve kërkimore-shkencore në fushën e shëndetësisë, në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.
- f. Mbështetja ndaj Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim (QKEV) lidhur me edukimin në vazhdim në fushën e shëndetit publik.
- g. Mbështetja për drejtorinë e ISHP-së lidhur me përpilimin e dokumentacionit përkatës në projekte studimore të bashkëpunimit dhe partnershipit të ISHP-së me institucione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit në fushën e shëndetit publik.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës sektori/me titull/gradë

Të organizojë, të drejtojë dhe të analizojë veprimtarinë e sektorit të Sistemit të Integruar të Informacionit Shëndetësor dhe Funksionalitetit të Sistemit dhe të shërbimeve përkatëse në nivel sektori, departamenti dhe institucioni.

Të marrë pjesë në trajnime e konferenca, brenda e jashtë vendit, si dhe botime në Buletin/Revista Shkencore në kuadër të punës kërkimore, dhe të ofrojë trajnime të vazhdueshme për personat përgjegjës.

Të grumbullojë në mënyrë periodike informacionin shëndetësor dhe të kontrollojë mbi sasinë dhe cilësinë e informacionit të grumbulluar.

Të prodhojë në mënyrë periodike Buletinin Shkencor të Institutit të Shëndetit Publik.

Të mbështesë drejtorinë e ISHP-së lidhur me përpilimin e dokumentacionit përkatës në projekte studimore të bashkëpunimit dhe partnershipit të ISHP-së me institucione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit në fushën e shëndetit publik.

Të ofrojë trajnime të vazhdueshme për personat përgjegjës deri në nivel NJVKSH-je, lidhur me informacionin shëndetësor mbi sëmundjet jo të transmetueshme.

Përshkrimi i punës: Specialist

Planifikimi dhe dizenjimi i grumbullimit të të dhënave nga burimet e besueshme.

Menaxhimi dhe organizimi i informacionit shëndetësor, duke kategorizuar informacionin për bazat e të dhënave ose regjistrat e sëmundshmërisë.

Prodhimi i indikatorëve shëndetësorë të matshëm, konsistentë, të besueshëm dhe të përdorshëm, raportimi periodik mbi gjendjen e indikatorëve social-ekonomike në popullatë dhe studimi i trendeve të ardhshme.

Pjesëmarrje në aktivitete me karakter shkencor (studime shkencore, publikime shkencore, konferenca shkencore etj.).

24.5.Sektori i Promocionit/Ndërgjegjësimit Shëndetësor

Misioni

Misioni i Sektorit të Promocionit/Ndërgjegjësimit Shëndetësor është të përmirësojë shëndetin e njerëzve nëpërmjet rritjes së kontrollit mbi shëndetin. Nëpërmjet Edukimit Shëndetësor njerëzve u jepet mundësia të mësojnë rreth shëndetit të tyre dhe të ndryshojnë sjelljen e tyre. Për të realizuar misionin e tij, Sektori Promocionit Shëndetësor punon në fushat e mëposhtme:

- Rritja e ndërgjegjësimit të njerëzve për çështjet që lidhen me shëndetin dhe faktorët që kontribuojnë në shëndet.
- Ofrimi i informacionit.
- Motivimi dhe bindja e njerëzve për të ndryshuar stilin e tyre të jetës për të përmirësuar shëndetin e tyre.
- Pajisja e njerëzve me aftësi dhe besim për t'i bërë këto ndryshime.

Objektivat

- a. Sensibilizimi i grup-moshave të ndryshme për mbrojtjen dhe forcimin e shëndetit të tyre nëpërmjet forcimit të veprimtarisë edukativo-shëndetësore (informuese, edukuese, komunikuese).
- b. Edukimi shëndetësor i grupeve të ndryshme target dhe më konkretisht të grave shtatzëna, të nënave të reja, të fëmijëve të moshës shkollore, të moshës së tretë dhe grupeve të marginalizuara etj.
- c. Përgatitja dhe organizimi i aktiviteteve të ndryshme edukativo-shëndetësore.
- d. Ngritja e nivelit teoriko-shkencor dhe metodik të punonjësve të vet, si edhe të specialistëve të Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor në rrethe, nëpërmjet udhëzimeve, protokolleve dhe literaturës bashkëkohore.
- e. Organizimi i fushatave të ndryshme sensibilizuese në kuadër të ditëve të shëndetit, apo edhe për probleme të ndryshme emergjente.
- f. Bashkëpunimi i ngushtë ndërsektorial dhe ndërinstitutional për promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës sektori/me titull/gradë

Organizon, drejton dhe analizon veprimtarinë e SPSH-së në ISHP.

Zhvillon dhe mban marrëdhënie pune bashkëpunuese me agjencitë dhe organizatat që punojnë në fushën e shëndetit publik.

Planifikon aktivitetet që do të realizojë sektori për një afat kohor të caktuar.

Drejton aktivitetet me karakter shkencor (studime shkencore, publikime shkencore, konferenca shkencore etj). Përcakton studimet në fushën e sjelljeve shëndetësore të cilave do t'u jepet prioritet.

Drejton dhe mbikqyr studime (sasiore dhe cilësore) në popullatë me qëllim vlerësimin e sjelljeve të rrezikshme dhe faktorëve të rrezikshëm për shëndetin

Merr pjesë në hartimin e dokumenteve strategjike, në shkrimin e raporteve, në studime kërkimore shkencore, si dhe në shkrimin e artikujve të ndryshëm shkencor

Koordinon punën me të gjithë sektorët e ISHP për çështje të lidhura me komunikimin shëndetësor

Drejton advokacinë në MSHMS dhe në komisionet ndërinstitutionale për çështjet shëndetësore të bazuara në provat më të fundit studimore lidhur me sjelljet shëndetësore.

Drejton aktivitetet që synojnë forcimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e edukimit dhe promocionit shëndetësor.

Organizon dhe drejton fushatat kombëtare dhe lokale për çështje të ndryshme shëndetësore.

Është personi përgjegjës i sektorit për komunikimin me median.

Dizenjon dhe drejton kryerjen e studimeve vlerësuese dhe diagnostikuese për të vlerësuar cilësinë dhe performancën e programeve të edukimit shëndetësor.

Siguron guidë për agjencitë dhe organizatat në vlerësimin e nevojave për edukim shëndetësor, si dhe në zhvillimin dhe shpërndarjen e programeve për edukim shëndetësor.

Përshkrimi i punës: Specialist/me titull/gradë

Specialist për sëmundjet jo të transmetueshme/ushqyerjen e shëndetshme të grup-moshave të ndryshme:

Planifikon aktivitetet që do të realizojë sektori lidhur me sëmundjet jo të transmetueshme për një afat kohor të caktuar. Merr pjesë në aktivitete me karakter shkencor (studime shkencore, publikime shkencore, konferenca shkencore etj.). Organizon dhe lehtëson trajnimet në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit për çështje të lidhura me ushqyerjen e shëndetshme. Organizon fushata kombëtare dhe lokale për çështje të ndryshme të sëmundjeve jo të transmetueshme (ushqyerja e shëndetshme). Shkruan dhe aplikon për miniprojekte në organizatat ndërkombëtare për çështje të lidhura me SJT-të.

Përgatit materiale informative për çështje të lidhura me SJT-të dhe programon shpërndarjen e informacionit në varësi të audiencës target. Zhvillon dhe prezanton programe në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit, të tilla si trajnime, ëorkshop-e, dhe prezantime në mjedise të ndryshme: shkollë, institucione shëndetësore dhe komunitete për çështje të lidhura me SJT-të. Advokon për çështjet shëndetësore të bazuara në gjetjet më të fundit studimore në MSHMS-në dhe në komisionet ndërinstitucionale.

Pjesëmarrje në hartimin e dokumenteve strategjike, në shkrimin e raporteve, në studime kërkimore shkencore, si dhe në shkrimin e artikujve të ndryshëm shkencorë.

Specialist për promovimin e sjelljeve të shëndetshme (aktiviteti fizik) në grup-mosha të ndryshme:

Planifikon aktivitetet që do të realizojë sektori lidhur me promovimin e sjelljeve të shëndetshme (aktivitetin fizik) për një afat kohor të caktuar. Organizon dhe drejton trajnime në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit për çështje të lidhura me aktivitetin fizik. Përgatit materiale informative dhe programon shpërndarjen e informacionit në varësi të audiencës target. Zhvillon dhe prezanton programe në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit, të tilla si trajnime, ëorkshop-e, dhe prezantime në mjedise të ndryshme: shkollë, institucione shëndetësore dhe komunitet. Advokon për çështjet shëndetësore të bazuara në gjetjet më të fundit studimore në MSHMS dhe në komisionet ndërinstitucionale. Pjesëmarrje në hartimin e dokumenteve strategjike, në shkrimin e raporteve, në studime kërkimore shkencore, si dhe në shkrimin e artikujve të ndryshëm shkencorë.

Specialist për promovimin e sjelljeve të shëndetshme (alkool) në grup-mosha të ndryshme:

Planifikon aktivitetet që do të realizojë sektori lidhur me promovimin e sjelljeve të shëndetshme (moskonsumin e alkoolit) për një afat kohor të caktuar. Organizon trajnime në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit me fokus sjelljet e rrezikshme (përdorimi i alkoolit). Përgatit materiale informative (kundër përdorimit të alkoolit) dhe programon shpërndarjen e informacionit në varësi të audiencës target. Lehtëson trajnimet në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit. Zhvillon dhe prezanton programe në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit, të tilla si trajnime, ëorkshop-e, dhe prezantime në mjedise të ndryshme: shkollë, institucione shëndetësore dhe komunitet për çështje të lidhura me sjelljet e rrezikshme.

Harton dhe dizenjon posterat, videot promovuese të shëndetit të cilat hidhen në rrjetet sociale të ISHP-së për çështje të lidhura me sjelljet e rrezikshme. Ndjekjen në dinamikë të të gjitha aktiviteteve që organizon ISHP-ja për t'i pasqyruar në rrjetet sociale.

Advokon për çështjet shëndetësore të bazuara në gjetjet më të fundit studimore në MSHMS dhe në komisionet ndërinstitucionale.

Specialist për promovimin e sjelljeve të shëndetshme (aksidentet rrugore) në grup-mosha të ndryshme:

Planifikon aktivitetet që do të realizojë sektori lidhur me promovimin e sjelljeve të shëndetshme (aksidentet rrugore) për një afat kohor të caktuar.

Organizon trajnime në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit.

Përgatit materiale informative (aksidentet rrugore) dhe programon shpërndarjen e informacionit në varësi të audiencës target. Lehtëson trajnimet në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit. Zhvillon dhe prezanton programe në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit, të tilla si trajnime, ëorkshop-e, dhe prezantime në mjedise të ndryshme: shkollë, institucione shëndetësore dhe komunitet.

Specialist për promovimin e sjelljeve të shëndetshme (parandalimin e dhunës) në grup-mosha të ndryshme:

Planifikon aktivitetet që do të realizojë sektori lidhur me promovimin e sjelljeve të shëndetshme (parandalimin e dhunës) për një afat kohor të caktuar. Organizon trajnime në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit. Përgatit materiale informative (parandalimin e dhunës) dhe programon shpërndarjen e informacionit në varësi të audiencës target.

Lehtëson trajnimet në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit. Zhvillon dhe prezanton programe në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit, të tilla si trajnime, ëorkshop-e, dhe prezantime në mjedise të ndryshme: shkollë, institucione shëndetësore dhe komunitet. Advokon për çështjet shëndetësore të bazuara në gjetjet më të fundit studimore në MSHMS dhe në komisionet ndërinstitucionale. Pjesëmarrje në hartimin e dokumenteve strategjike, në shkrimin e raporteve, në studime kërkimore shkencore, si dhe në shkrimin e artikujve të ndryshëm shkencorë.

Specialist për promovimin e sjelljeve të shëndetshme (shëndetin mendor) në grup-mosha të ndryshme:

Planifikon aktivitetet që do të realizojë sektori lidhur me promovimin e sjelljeve të shëndetshme (shëndeti mendor) për një afat kohor të caktuar.

Organizon trajnime në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit për çështje të shëndetit mendor.

Përgatit materiale informative për shëndetin mendor dhe programon shpërndarjen e informacionit në varësi të audiencës target.

Zhvillon dhe prezanton programe në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit, të tilla si trajnime, ërkshop-e, dhe prezantime në mjedise të ndryshme: shkollë, institucione shëndetësore dhe komunitet.

Advokon për çështjet shëndetësore të bazuara në gjetjet më të fundit studimore në MSHMS dhe në komisionet ndërinstitutionale.

Merr pjesë në hartimin e dokumenteve strategjike, në shkrimin e raporteve, në studime kërkimore shkencore, si dhe në shkrimin e artikujve të ndryshëm shkencorë.

Specialist për promovimin e sjelljeve të shëndetshme (shëndetin riprodhues) në grup-mosha të ndryshme:

Planifikon aktivitetet që do të realizojë sektori lidhur me promovimin e sjelljeve seksuale të shëndetshme për një afat kohor të caktuar. Organizon trajnime në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit për çështje të lidhura me SHSR-në. Përgatit materiale informative (shëndeti riprodhues) dhe programon shpërndarjen e informacionit në varësi të audiencës target. Zhvillon dhe prezanton programe në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit, të tilla si trajnime, ërkshop-e, dhe prezantime në mjedise të ndryshme: shkollë, institucione shëndetësore dhe komunitet.

Specialist për promovimin e sjelljeve të shëndetshme (kundër duhanpirjes) në grup-mosha të ndryshme:

Planifikon aktivitetet që do të realizojë sektori lidhur me promovimin e sjelljeve të shëndetshme (kundër duhanpirjes) për një afat kohor të caktuar.

Organizon trajnime në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit të lidhura me sjelljet e rrezikshme, siç është përdorimi i duhanit. Përgatit materiale informative (duhanpirja) dhe programon shpërndarjen e informacionit në varësi të audiencës target. Lehtëson trajnimet në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit për çështje të lidhura me duhanpirjen. Zhvillon dhe prezanton programe në fushën e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit, të tilla si trajnime, ërkshop-e, dhe prezantime në mjedise të ndryshme: shkollë, institucione shëndetësore dhe komunitet. Koordinatore e të drejtës për informim në Programin e Transparencës. Advokon për çështjet shëndetësore të bazuara në gjetjet më të fundit studimore në MSHMS dhe në komisionet ndërinstitutionale për çështje të lidhura me duhanpirjen.

Pjesëmarrje në hartimin e dokumenteve strategjike, në shkrimin e raporteve, në studime kërkimore shkencore, si dhe në shkrimin e artikujve të ndryshëm shkencorë.

Specialist për promovimin e sjelljeve të shëndetshme në shkolla:

Planifikon aktivitete ndërgjegjësuese në shkolla lidhur me promovimin e sjelljeve të shëndetshme tek fëmijët e moshës shkollore. Është anëtar i rrjetit europian të shkollave që promovojnë shëndet. Është anëtar i ekipit shqiptar, pjesë e rrjetit të HBSC-së (Health Behaviour in School-Aged Children survey). Harton manuale trajnimi dhe zhvillon trajnime për stafin shëndetësor që punon në shkolla. Përgatit materiale informative dhe programon shpërndarjen e informacionit në shkolla. Lehtëson aktivitetet ndërgjegjësuese që kryhen në shkolla për çështje të caktuara shëndetësore.

Përshkrimi i punës: Specialist (Redaktor letrar)

Kryejnë redaktimin letrar dhe korrektojnë të gjitha materialet e prodhuara nga sektori i Promocionit dhe ndërgjegjësimit Shëndetësor dhe gjithë sektorët e tjerë në ISHP.

Përkatësisht: Buletini i Shëndetit Publik (njoftojnë, ndjekin, grumbullojnë të gjithë artikujt për këtë qëllim, në mënyrë periodike çdo 3-muaj); Broshura, Fletëpalosje; Postera; Udhëzues i Promocionit të Shëndetit; Libra nga autorë apo grupe- autorësh për tematika të caktuara të shëndetit (HIV/AIDS etj.); Materiale të KMR-ZMR-së; Raporte të mbledhjeve dhe konkluzioneve vjetore; Rregullore të ndryshme.

Hartimi i planit të punës, i prioritetëve duke pasur në konsideratë kohën dhe rëndësinë e materialeve të paraqitura, dorëzimin e dorëshkrimit brenda afateve.

Përputhja e dorëshkrimit me literaturën, me parimet themelore shkencore për një problem të caktuar, të kuptuarit e kufizimeve dhe dobësisë së hipotezës.

Qenia respektues ndaj autorit, por dhe i palëkundur në kërkimin e shpjegimeve, argumentave dhe qartësisë duke ruajtur vlerën autentike të artikullit për përmirësimin e performancës dhe vlerës shkencore të produktit përfundimtar.

Vlerësimi lidhur me rëndësinë shkencore të artikullit, formës dhe përmbajtjes, duke shmangur maksimalisht përdorimin e pasaktë të fjalëve, frazave, përdorimin e zhargoneve, nëpërkëmbjen e pastërtisë dhe dëlirësisë së gjuhës shqipe.

Kërkimi për një vlerësim të dytë të punës së kryer për të eliminuar çdo gabim të mundshëm.

Shpërndarja e një raporti përfundimtar të redaktimit një për botuesin, një për autorin, megjithë rekomandimet.

Shërbimi i kërkimshëm në lidhje dhe asistencë koherente edhe me shefin e Njesisë bazë (Njesisë bazë (Departamentit))

Ngritje profesionale, përfshirja dhe angazhimi në trajnime në fushën e shëndetit publik për t'u përditësuar me të rejat e fundit në fushën e promocionit shëndetësor në funksion të rritjes së efikasitetit në punën e përditshme, në mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit të popullatës.

Neni 25

DREJTORIA E MBROJTJES NGA RREZATIMET

ZMR-ja kryen funksionin administrativ si drejtori pranë Institutit të Shëndetit Publik. Detyrat dhe të drejtat për Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet janë të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes

nga rrezatimet dhe në rregulloren përkatëse. ISHP-ja mbështet në mënyrë administrative ZMR-në për realizimin e detyrave ligjore të saj.

Misioni i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, si Autoriteti Kompetent Kombëtar në mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese dhe Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet si organ i tij, është:

- Përcaktimi i kushteve të mbrojtjes dhe të sigurisë nga rrezatimet jonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, me qëllim mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, të popullatës dhe mjedisit në tërësi nga rreziqet e mundshme të rrezatimeve, si dhe sigurimin e materialeve radioaktive, duke shfrytëzuar në maksimum të mirat që vijnë nga përdorimi i rrezatimeve jonizuese.
- Përcaktimi i kërkesave për mbikëqyrjen e veprimtarive me rrezatim jojonizues, kontrolli i ekspozimeve të publikut dhe të punonjësve, si dhe monitorimi i rrezatimeve jojonizuese, duke shfrytëzuar të mirat që vijnë nga përdorimi i tyre

Detyrat e Drejtorisë së Mbrojtjes nga Rrezatimet

- Paraqet për miratim në komision aktet rregulluese të veprimtarisë së mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese.
- Kontrollon në praktikë zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese.
- Kryen inspektimin e instalimeve dhe veprimtarive me rrezatim, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
- Mbledh informacion dhe kryen matjet e analizat e nevojshme për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese.
- Përgatit dosjet për dhënien, pezullimin dhe heqjen e licencave, dhe ia paraqet komisionit për miratim.
- Përgatit dosjet për miratimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues dhe ia paraqit komisionit për miratim.
- Përgatit materialet e mbledhjeve të komisionit, si dhe raportet e kërkuara prej tij.
- Mban inventarin kombëtar të burimeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues.
- Angazhon institucionet kërkimore-shkencore në të gjithë vendin për zgjidhjen e problemeve kombëtare, në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese.
- Përgatit lejet e importit, eksportit dhe transportit për burimet e rrezatimit jonizues.
- Zbaton detyrimet që vijnë nga plani i emergjencave radiologjike.
- Plotëson platformat në kuadër të bashkëpunimit me ANEA-n.
- Bashkërendon punën me inspektoratin që mbulon fushën e punës dhe me inspektoratin që mbulon fushën e shëndetit.
- Përafron legjislacionin në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet me atë të BE-së dhe ANEA-s.
- Kërkon nga çdo operator, prodhues, importues ose instalues të pajisjeve që emetojnë rrezatim jojonizues

- të përmbushë respektimin e kufijve bazë dhe të kufijve të ekspozimit nëpërmjet matjeve, deklaratave me shkrim ose certifikatave që lëshohen nga prodhuesit.
- Verifikon procedurat testuese për pajisjet që emetojnë rrezatim jonizues dhe ato elektromjekësore, dhe për kompanitë që do të bëjnë testimin e tyre.

Përshkrimi i punës: Kryetar ZMR-je

Shpërndan detyrat për stafin.

Përfaqëson ZMR-në në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit, si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së ZMR-së.

Kërkon zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, dhe siguron kontrollin e zbatimit të tyre nga strukturat inspektuese në varësi të tij.

Zbaton dhe administron ZMR-në në bashkëpunim me ISHP-në për çështjet administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe propozon në ISHP projektbuxhetin për vitin e ardhshëm. Nxjerr urdhra dhe udhëzime për veprimtarinë e ZMR-së.

Propozon rregulla specifike përkatëse në kuadër të rregullores unike për organizimin dhe funksionimin e ZMR-së.

Miraton listën e subjekteve sipas nivelit të rrezikshmërisë së tyre në sigurinë publike, në bazë të përcaktimeve paraprake.

Përcakton listën emërore të Komisionit të Ankimimit pranë KMR-së, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, si dhe detyrat e përgjegjësitë e tyre duke parandaluar apo shmangur në çdo rast konfliktin e interesave në lidhje me vendimmarrjen.

Bashkërendon veprimtarinë e ZMR-së me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën përkatëse të inspektimit.

Siguron kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme për çështje që lidhen me përmbushjen e misionit të ZMR-së.

Raporton drejtpërdrejt te KMR-ja dhe te Kryetari i KMR-së, përveç rasteve kur KMR-ja ka përcaktuar shprehimisht me urdhër një njësi tjetër raportimi në aparatin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe informon Inspektorin e Përgjithshëm.

Nxjerr akte të detyrueshme për realizimin e funksioneve të ZMR-së, si dhe për rregullimin e marrëdhënieve të punës së punonjësve të ZMR-së.

Nxjerr akte të brendshme, të detyrueshme për menaxhimin administrativ dhe të burimeve njerëzore të ZMR-së.

Në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, mund të delegojë kompetencat, kur ligji i posaçëm e lejon shprehimisht delegimin e tyre apo zëvendësimin në rast të mungesës së tij në detyrë.

Koordinon veprimtarinë me Inspektoriatin Qendror bazuar në kërkesat e legjislacionit "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe për zbatimin e të gjitha akteve nënligjore të miratuara nga Inspektorati Qendror, të cilat rrjedhin nga ligji nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Cakton një person për publikimin e vendimit përfundimtar apo një përmbledhje të tij, në rastet kur është e nevojshme, apo informacioneve të tjera të detyrueshme dhe sipas përcaktimeve të ligjit të inspektimit.

Kryetari i ZMR-së drejton mbledhjet, të cilat duhet të mbahen me procesverbal. Merr të gjitha materialet që vijnë për ZMR-në dhe i siglon, duke i shpërndarë sipas rasteve. Në shënim përcaktohet dhe koha e përgjigjes në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Analizon informacionet. Kontrollon në praktikë dhe merr masa për moszbatimin e detyrave të ngarkuara, si dhe mosrealizimin e tyre në kohë. Rishikon gjobat e vendosura nga inspektorët, dhe ka të drejtën e dërgimit në KMR të kundërshtive. Mbi bazën e planeve të paraqitura nga ana e stafit, përcakton planet e ZMR-së. Ndjek zbatimin e detyrave nga stafi. Siguron raportimet në KMR dhe përgatit mbledhjet e KMR-së dhe ZMR-së. Ndjek zbatimin e rregulloreve dhe shikon përshtatshmërinë ligjore dhe teknike të dokumenteve të përgatitura. Ndjek palformat me IAEA-n ku është përgjegjës dhe projektet. Ndjek takimet teknike në IAEA-n. Bashkëpunon me organizmat kombëtare e ndërkombëtare, siç e kërkon ligji. Drejton proceset në ZMR, dhe kërkon zbatimin e legjislacionit në përputhje me kodin e menaxhimit.

Përshkrimi i punës: Specialist (Jurist)

Siguron ndihmën juridike për veprimtarinë në institucion, si dhe jep mendime kur i kërkohet për shkresat që i dërgohen drejtorit nga institucionet qendrore/vendore. Siguron ndihmën juridike për institucionin për trajtimin e problemeve me karakter juridik. Merr pjesë në hartimin e rregulloreve me karakter administrativ dhe teknik. Me autorizim të drejtorit të ZMR-së, përfaqëson institucionin në proceset gjyqësore në të cilat institucioni është palë. Ushtron kontroll administrativ të dokumenteve të paraqitura nga subjektet për proceset e aplikimit pranë ZMR-së. Në bashkëpunim me inspektorët që shqyrtojnë aplikimet për rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, ndjek procedurat e zhvillimit të aplikimit, për të garantuar kryerjen e tyre në përputhje me ligjin deri në finalizim të procesit për dhënie licence, aktmiratimi ose aprovim për import – eksport. Përpunon, vlerëson nga pikëpamja ligjore dhe siglon aktet administrative, dosjet e vlerësuara të subjekteve aplikuese dhe raportet që dërgohen dhe miratohen në KMR. Harton, shqyrton, përgatit aktet me karakter individual apo normativ gjatë korrespondencës shkresore me institucionet e linjës dhe personat privatë. Përbush çdo urdhër tjetër apo porosi të titullarit të ZMR-së.

Përshkrimi i punës: Specialist

Plotësimi sa më mirë i detyrave të ngarkuara, për mbarëvajtjen e proceseve dhe inventarizimin e dokumentacionit.

1. Në zbatim të dokumentit nr. 6097/7 protokolluar datë 24.10.2014 "Procedurat formati shpjegues i vlerësimit i aplikimit për pajisjen me aktmiratimi të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues, formati i vërtetimit". Person përgjegjës për pritjen dhe sqarimin e subjekteve që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues dhe që aplikojnë për pajisje me aktmiratimi nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

vlarrja në dorëzim e aplikimeve, përgatitja e listës me subjektet të cilat aplikohen dhe duhen hedhur të dhënat sipas formatit të miratuar, si dhe pajisja e subjektit me vërtetim. Raportet e SB-ve të cilat aplikohen si vlerësime të përbashkëta, iu shtohen kompanive përkatëse në listë. -Pasi vihet në dijeni shefi i ZMR-së, Stacionet Bazë iu shpërndahen inspektorëve për vlerësim. -Të dhënat e SB-ve të çdo aplikimi hidhen në inventarin e burimeve të rrezatimit jojonizues, sipas kompanive dhe datës së aplikimit.

Sistemimi i materialeve, vlerësimeve jojonizuese për mbledhjet e KMR-së dhe arkivimi i tyre në ZMR; në zbatim të Urdhrit nr.25 datë 14.12.2016. Sipas pikës 3 dhe 4 të urdhrit, marr në dorëzim SB-të nga inspektorët pasi është bërë vlerësimi, dhe i vendos në dosje të ndara sipas aplikimeve dhe inspektorit. SB-të që nuk janë në përputhje me legjislacionin vendosen në fund të çdo aplikimi. -Në zbatim të pikës 5, bëhet përgatitja e folderave elektronikë me vlerësimet jojonizuese të ndara sipas kompanive, datës së aplikimit, SB-ve në përputhje me legjislacionin në fuqi që nuk janë në përputhje dhe ky folder i çohet kryetarit të ZMR-së.

Në zbatim të pikës 6, mbasi zbardhet mbledhja e KMR-së përgatitet shkresë zyrtare me gjithë problematikat bashkëngjitur (komentet e inspektorit) për çdo kompani, dhe kur janë të përbashkëta, vë në dijeni kompaninë që i përket. -Përgatitja e dosjes (fotokopje) me vlerësimet jojonizuese në dy kopje dhe tabela përmbledhëse të lidhur me aplikimet e kompanive.

Përgatitja e materialeve të miratuara në mbledhjet e KMR-së jojonizuese, në zbatim të Urdhrit nr.29 datë 16.2017: -Mbas mbledhjes së KMR-së përgatitet lista me SB-të sipas formatit të miratuar, me SB të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, miratuar nga KMR-ja, e cila i bashkëngjitet raportit të mbledhjes. -Në zbatim të pikës 3, përgatitet shtojca jojonizuese me SB-të të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me të dhënat e paraqitura në vlerësimin e bërë nga inspektorët, pasi miratohen nga KMR-ja.

Përgatitja e shkresave shoqëruese për pagesë për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues në zbatim të Udhëzimit nr.445 datë 17.10.2016 "Për një ndryshim në udhëzimin nr.138 datë 3.4.2014 të Ministrisë të Shëndetësisë". Për miratimin e tarifave për pajisjen me aktmiratimi për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues. -Dërgimi i e-mail-it në kompanitë e transmetimit celular, listën me SB të cilat janë miratuar nga KMR-ja, për ndarjen e SB-ve sipas udhëzuesit, SB-ja i ri dhe riaplikim i të njëjtit SB. -SB të cilat janë riaplikim merren dosjet e fundit të cilat janë miratuar dhe verifikohen me dosjet e reja duke bërë ndarjen e SB-ve për pagesë. Përgatitet shkresa shoqëruese për pagesën drejtuar llogarisë së ISHP-së duke përcaktuar nr. e SB-ve dhe ndarjen e aplikimit të ri dhe të të njëjtit SB.

Inventari i burimeve të rrezatimit jojonizues. -Person përgjegjës për inventarin e burimeve të rrezatimit jojonizues. Hedhja e të dhënave të SB-ve të aplikuar në ZMR nga kompanitë e transmetimit celular. -Hedhja e të dhënave në sistem të SB-ve të cilat janë pajisur/ose jo me aktmiratimi. -Përgatitje e informacionit lidhur me burimet e rrezatimit jojonizues çdo fund viti për raportin vjetor të ZMR-së. -Hedhja e të dhënave në nënnyrë elektronike për ankesat jojonizuese që mbërrijnë në ZMR, përgatitja një folderi me shkresat që iu është kthyer përgjigje ankesave. Gjetja e informacionit për ankesën e ardhur, data e aplikimit, data kur është miratuar nga KMR-ja, duke ia vënë në dispozicion inspektorit që përgatit shkresën. Detyra 6. Zbardhja e materialeve të miratuara në mbledhjet e KMR-së, për subjektet që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues, në zbatim të Urdhrit nr. 34 datë 19.2.2019; -Sipas pikës 3, përgatit licencat, shtojcat për subjektet që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues me të dhënat ashtu si janë paraqitur në vlerësimin e inspektorit, pasi miratohen nga KMR-ja. -Sipas pikës 4, pasi zbardhet mbledhja e KMR-së, përgatiten shkresat shoqëruese për pagesë drejtuar llogarisë së ISHP-së, në zbatim të Udhëzimit nr.713 datë 11.10.2018

për tarifat e licencimit të veprimtarive, të cilët përdorin burime të rrezatimit jonizues. -Shpërndarja e licencave, shtojcave të subjektet.

Person përgjegjës për dokumentet e ZMR-së, dokumenti "Manuali i Menaxhimit cilësor të ZMR-ja". Dokumentet e miratuara vendosen në dosje dhe përshtaten dhe në mënyrë elektronike. -Rishikimi i faqes së internetit të ZMR-së, KMR-së, duke bërë ndryshimet për materiale të reja të miratuara, ekspertë të njohur, kompani etj. -E-maili i ZMR-së, hapja e e-mailit dhe vënia në dijeni e shefit për e-maillet e ardhura në adresë të zyrës.

2. Respektimi i kërkesave ligjore me qëllim rritjen e aftësive profesionale, në funksion të plotësimit me efektivitet të detyrave të ngarkuara, si dhe në funksion të progresit në drejtim të karrierës profesionale.

Përditësimin dhe mbajtjen e inventarit të burimeve të rrezatimit duke përfshirë të dhëna mbi subjektet, punonjësit dhe aparaturat apo burimet radioaktive në sistemin RAIS.

Përgjegjës për procesin e përgatitjes dhe reagimit në rast të një emergjence radiologjike bazuar në detyrimet dhe të drejtat e ZMR-së siç përcaktohen në vendimin nr.700 datë 21.11.2018 për miratimin e rregullores "Për Përgatitjen dhe Reagimin në Rast të një Emergjence Radiologjike për Mbrojtjen e Punonjësve dhe Publikut", si dhe siç përcaktohet në aktet e tjera ligjore e nënligjore.

Kontribut në procesin e përgatitjes, rishikimit dhe përafrimit të rregullores, udhëzimeve dhe dokumentacioneve të tjera me direktivat e Bashkimit Europian dhe ANEA-s, nëpërmjet bashkëpunimit me drejtorinë juridike në MSH.

Ilicit Trafficking Database (ITDB). Mbledhja, ruajtja dhe përpunimi i të dhënave të nxjerra nga arkivi elektronik për ITDB, bazuar në nenin 16 të vendimit nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për Sigurimin e Burimeve Radioaktive në Republikën e Shqipërisë".

Verifikimi i të dhënave në ITDB dhe Risk Report Database të subjekteve që aplikojnë për import-eksport të burimeve radioaktive, sipas nevojës dhe kërkesës, bazuar në nenin 16 të vendimit Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për Sigurimin e Burimeve Radioaktive në Republikën e Shqipërisë".

Gjenerimi në portalin unik e - Inspektimi i planit të muajit pasardhës mbështetur në Urdhrin nr. 25, datë 10.8.2018 për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ".

Gjenerimi në portalin unik e-Inspektimi i Autorizimeve të Inspektimit dhe njoftimi i subjektit, objekt i inspektimit në afatet e përcaktuara nga Urdhri nr. 25, datë 10.8.2018, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ", Udhëzimit nr. 1885/1 protokolluar, datë. 27.12.2016 "Për metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit nga inspektorët e ZMR – së".

Përgatitja e grafikut vjetor të inspektimit për vitin kalendarik pasardhës mbi bazën e rrezikut, frekuencës kohore dhe performancës së subjekteve, të klasifikuara me urdhër të brendshëm të ZMR-së nr. 18. datë. 14.7.2015, i ndryshuar, dalë në zbatim të Urdhrit të IQ, nr.6 datë 19.2.2015, "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të rrezikut".

Realizimi i inspektimeve të planifikuara sipas grafikut vjetor të inspektimeve të ZMR-së.

Rishikimi i listave të kontrollit të cilat përdoren gjatë procesit të inspektimit.

Plotësimi dhe përditësimi i moduleve në sistemin EPRIMS (Emergency Preparedness and Response Information Management System).

3. Puna në grup dhe në vazhdimësi, respektimi i kërkesave ligjore, me qëllim rritjen e aftësive tekniko-profesionale, në funksion të plotësimit sa më mirë të detyrave të ngarkuara dhe në funksion të karrierës profesionale.

Përgatitja e rregulloreve, bashkëpunimi me drejtorinë juridike në MSH në rishikimin e rregulloreve dhe përafrimin e tyre me direktivat e BE-së dhe dokumentet e ANEA-s. Ndjekja e procesit të dërgimit për komente në ministritë e linjës dhe më tej dërgimin për miratim.

Përgatitja/rishikimi i procedurave dhe udhëzuesve në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese.

Plotësimi i platformës së re RASIMS2, moduli TSA 1, futja e të dhënave në sistem. Azhurnimi i tij në varësi të ndryshimeve në legjislacion.

Sqarimi, verifikimi paraprak dhe pranimi i dokumentacionit për licencë nga subjekte të ndryshme, mbështetur në dokumentin "Procedurat formati shpjegues dhe vlerësimi i aplikimit për licencë të veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues, formati i njoftimit dhe vërtetimit" nr.490/7 datë 19.5.2020, si dhe dokumenteve. Aplikim "Për veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, gjenerator me rreze X, radiografi dentare për përdorim personal", nr. 4935, protokolluar datë 8.11.2013. Aplikim "Për licencë për veprimtari me gjenerator me rreze X", nr. 10, datë 7.1.2010. Aplikim "Për licencë për veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese", nr. 10 datë 7.10.2010.

Verifikimi i aplikimit për licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues në përputhje me legjislacionin si më poshtë:

Ligji nr. 8025 datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar.

VKM-ja nr. 10 datë 7.1.2010 "Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese". Rregullore nr.9 datë 7.1.2010 "Për kategorizimin e burimeve në RSH në funksion të mbrojtjes nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimit të burimeve të rrezatimit jonizues".

Rregullore nr.877 datë 30.10.2015 "Për sigurimin fizik të materialeve radioaktive në RSH". Rregullore nr.404 datë 18.6.2014 "Rregullat bazë të instalimeve radiologjike në mjekësi". Rregullore nr.638 datë 7.9.2016 "Për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në RSH". Rregullore nr.815 datë 16.11.2016 "Për transportin e sigurt të materialeve radioaktive". Rregullore nr.700, datë 21.11.2018 "Për përgatitjen dhe reagimin në rast emergjence radiologjike, për mbrojtjen e punonjësve dhe publikut".

Rregullore nr.801 datë 11.12.2019 "Për mbrojtjen e publikut dhe punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues, dhe sigurisë ndaj ekspozimeve mjekësore me burimet e rrezatimit jonizues". Procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, nr.490/7 protokolluar datë 19.5.2020. Udhëzues për Përgatitjen e Planit të Sigurimit të Objektivit nr.444/8, datë 20.2.2019, si dhe gjithë dokumenteve të tjera dalë në zbatim të tyre.

Verifikimi i dosjeve për personat fizikë, juridikë që aplikojnë për njohje në zbatim të udhëzuesit nr. 1526/1 datë 13.4.2012 mbi "Elementet për njohje nga ana e KMR-së për personat juridikë e fizikë që kryejnë matje me rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, kalibrim të pajisjeve radiometrike dhe matëse të rrezatimeve, trajnime, dhe shërbimin e dozimetrisë personale".

Verifikimi i dokumentacionit në lidhje me aplikimet si ekspert në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe fizikan mjekësor, pas dërgimit të raportit vlerësues nga IFBZ. Përgatitja e raportit për paraqitjen në KMR-së për vendimin përfundimtar.

Person përgjegjës për plotësimin e detyrimeve që lidhen me PKIE, Kapitulli 15. Përgatitja e raporteve përkatëse, raportimi sipas afateve ligjore, pjesëmarrja në takimet e grupeve të punës për këtë qëllim.

Përgatitja e raporteve të mbledhjeve të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi, në zbatim të VKM-së nr.123 datë 5.3.2014 “Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e organizimit, të funksionimit e të shpërblimit të komisionit të mbrojtjes nga rrezatimet”.

Përgatitja e shkresave në zbatim të vendimeve të KMR-së, shqyrtimi i ankesave të ndryshme të ardhura në ZMR, bashkëpunimi me institucionet e ndryshme etj.

Zbatimi i urdhrave të dalë në zbatim të ligjit nr. 10433 datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Ndjekja e projekteve rajonale ku jam përcaktuar si “counterpart”.

Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga konventa për sigurimin fizik të materialeve radioaktive dhe amendimit të saj. Përgatitja e raportit vjetor.

4. Puna në grup dhe në vazhdimësi, respektimi i kërkesave ligjore me qëllim rritjen e aftësive tekniko-profesionale, në funksion të plotësimit sa më mirë të detyrave të ngarkuara dhe në funksion të karrierës profesionale.

Vlerësimi i aplikimeve për pajisje me aktmiratimi të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues duke u bazuar në legjislacionin e mëposhtëm: ligji nr. 10469 datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, i ndryshuar, rregullore nr.743 datë 16.10.2012 “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”, si dhe gjithë dokumenteve të tjera dalë në zbatim të tyre.

Vlerësimi i kapaciteteve në lidhje me kompetencat (njohuri, aftësi dhe sjellje) për punonjësit e trupës rregullatore, përdorues, përgjegjësit e mbrojtjes nga rrezatimet dhe ekspertët e mbrojtjes. Rishikimi dhe vlerësimi i dokumenteve për të arritur kompetencën e nevojshme.

Studime për t’u thelluar mbi metodat dhe standardet e vlerësimeve të shpërndarjes dhe mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese.

Përgatitja e përgjigjeve të ankesave/shkresave të ardhura pranë ZMR-së, në lidhje me rrezatimet jojonizuese. Përgatitja e raportit vjetor.

5. Respektimi i kërkesave ligjore, edukimi në vazhdim, në funksion të ngritjes së nivelit profesional, mbarëvajtjes së punës dhe detyrave të ngarkuara.

Verifikimi paraprak dhe pranimi i dokumentacionit të subjekteve që aplikojnë për licencë të veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues bazuar në:

-Procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, nr.490/7 protokolluar datë 19.5.2020, -VKM-ja nr. 10 datë 7.1.2010 “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese”. -Kërkesë për licencë për veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese (gjeneratorë me rreze X). -Kërkesë për licencë për veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese (burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive). -Kërkesë për licencë për veprimtari me burime të rrezatimeve

jonizuese, gjenerator me rreze X, radiografi dentare për përdorim personal, nr. 4935 protokolluar datë 19.5.2013.

Vlerësim të dosjeve të subjekteve që aplikojnë për licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues në përputhje me legjislacionin si më poshtë: ligji nr. 8025 datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”- i ndryshuar, rregullore nr 10 datë 7.1.2010 “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese”. Rregullore nr.9 datë 7.1.2010 “Për kategorizimin e burimeve në RSH në funksion të mbrojtjes nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimit të burimeve të rrezatimit jonizues”. Rregullore nr.877 datë 30.10.2015 “Për sigurimin fizik të materialeve radioaktive në RSH”. Rregullore nr.404 datë 18.6.2014 “Rregullat bazë të instalimeve radiologjike në mjekësi”. Rregullore nr.638 datë 7.9.2016 “Për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në RSH”. Rregullore nr.815 datë 16.11.2016 “Për transportin e sigurt të materialeve radioaktive”. Rregullore nr.700, datë 21.11.2018 “Për përgatitjen dhe reagimin në rast emergjence radiologjike, për mbrojtjen e punonjësve dhe publikut”.

Rregullore nr.801 datë 11.12.2019 “Për mbrojtjen e publikut dhe punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues, dhe sigurisë ndaj ekspozimeve mjekësore me burimet e rrezatimit jonizues”. Procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, nr.490/7 protokolluar. datë 19.5.2020.

Udhëzues për përgatitjen e planit të sigurimit të objektit nr.444/8, datë 29.3.2019, si dhe gjithë dokumenteve të tjera dalë në zbatim të tyre.

6. Respektimi me rigorozitet i kërkesave ligjore me qëllim rritjen e aftësive teknike dhe profesionale, në funksion të plotësimit me efektivitet të detyrave të ngarkuara, mbarëvajtjes së punës në grup, si dhe në funksion të progresit në drejtim të karrierës profesionale.

Inspektimin e subjekteve që përdorin burime të rrezatimit jonizues dhe që janë të pajisur me licencë nga KMR-ja, mbështetur në zbatimin e grafikut të inspektimeve të ZMR-së, kontrollon dokumentacionin që lidhet me veprimtarinë e ushtruar nga subjekti, si dhe kryen matjen e dozave për nivelin e rrezatimit në vendqëndrimet e personelit dhe të publikut, bazuar në legjislacionin: ligji nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar: ligji nr. 10433 datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM-ja nr. 10 datë 7.1.2010 “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese”.

Përgatitja e protokollit të inspektimeve dhe komunikimi me anë të shkresave me IQ për programin e detajuar mujor të inspektimit mbi bazë subjektesh të ZMR-së, hartuar në bazë të frekuencës së rrezikut për muajin pasardhës. Gjenerimi në portalin unik e- inspektimi i planit të muajit pasardhës në bazë subjektesh. Gjenerimi në portalin unik e- inspektimi i autorizimit të inspektimit dhe njoftimi i këtij autorizimi subjektit, objekt i inspektimit, me anën e një shkrese në afatet e përcaktuara ligjore. Ezaurimi i plotë në mënyrë online i procesit të inspektimit si një proces i rregullt administrativ që përmban: Plotësimin e listave të kontrollit, hartimin e procesverbalit të inspektimit, vendimin përfundimtar të inspektimit. Njoftimi i të gjitha materialeve të kërkuara nga procesi i inspektimit, subjektit i cili është objekt i inspektimit. VKM-ja nr.696, datë 16.8.2013

Përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për miratimin dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi” -Urdhri nr. 25, datë 10.8.2018 për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ”. Udhëzimi nr.

1885/1 protokolluar, datë. 27.12.2016 "Për metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit nga inspektorët e ZMR-së".

Përgatitja e grafikut vjetor të inspektimit për vitin kalendarik pasardhës, hartuar brenda datës 15 tetor të vitit paraardhës, në bazë të performancës së subjekteve dhe të frekuencës së rrezikut. Ligji nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar. VKM-ja nr.10 datë 7.1.2010 "Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese". Urdhri nr. 25, datë 10.8.2018, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ".

Rishikimi i listave të kontrollit, duke u mbështetur në problematikat që janë ndeshur gjatë procesit të inspektimit, bëhet rishikimi i listave të kontrollit bazuar dhe në VKM-në nr.696, datë 16.8.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror, dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi".

Kodi i Praktikës "Për mbrojtjen nga rrezatimet në rëntgendiagnostikë" nr. 804/2 datë 15.3.2005. Kodi i Drejtimit për Sigurinë dhe Sigurimin e Burimeve Radioaktive nr 1388 datë 14.4.2004. Kodi i Praktikës në Radioterapi nr. 804/1 datë 15.3.2005. Kodi i Praktikës në Mjekësinë Bërthamore Radiodiagnostike dhe Radioterapi nr 5027/2 datë 2.12.2010.

Përgatitja e Raportit Vjetor, për pjesën e inspektimit ku do të jepet një pasqyrë e plotë e inspektimeve të kryera sipas grafikut të inspektimeve, inspektimeve jashtë programit dhe njëkohësisht masat e dënimeve administrative të marra ndaj shkeljeve të kryera nga subjektet. Ligji nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar. Ligji nr. 10433 datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Bashkëpunimi me Inspektoratin Qendror ku do të ndiqet e gjithë problematika në lidhje me procesin e inspektimit në portalin unik e-Inspektimi, ku të gjitha inspektimet do të kryhen online me anë të tabelave të inspektimit. VKM-ja nr.696, datë 16.8.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi".

7. Kontrolli i respektimit të kërkesave ligjore gjatë shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjektet, kërkimi i dokumenteve shtesë, kur është e nevojshme, zbatimin e të gjitha udhëzimeve, procedurave, kodeve e normave të tjera të miratuara nga KMR-ja.

Plotësimi i procedurave për import- eksport, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 158 datë 13.2.2008. Për import/eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues në Republikën e Shqipërisë, udhëzimin mbi import-eksportin dhe tranzitin e burimeve radioaktive të kategorive 1 dhe 2, nr.134 datë 12.4.2011, si dhe Kodin e Drejtimit nr.1388 datë 14.4.2004 për sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive. Përgatitja e aprovim import-eksportit për burime të kategorisë 3,4 dhe 5 nr.494/3 datë 7.2.2011. Përgatitja e aprovim import/eksportit për gjeneratorë me rreze X Nr.494/6 datë 7.2.2011. Përgatitja e aprovim import-eksportit për burime të kategorisë 1 dhe 2 Nr.494/2 datë 7.2.2011.

Plotësimi i procedurave për aprovim të transportit, transferimit dhe tranziti për burime radioaktive nr.276/22, datë 18.9.2017 mbështetur në: VKM-në nr. 815, datë 16.11.2016 "Për transportin e sigurt të materialeve radioaktive". VKM-në nr. 9, datë. 7.1.2010 "Për kategorizimin e burimeve radioaktive në Republikën e

Shqipërisë në funksion të mbrojtjes nga rrezatimet, për sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues”. VKM-në nr. 877, datë 30.10.2015 “Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”.

Përgatitja e shkresave shoqëruese për pagesat për aprovimet e import-eksportit, si dhe aprovim transporti të burimeve të radioaktive mbështetur në Udhëzimin nr. 713, datë 11.10.2018 “Tarifat e licencimit të burimeve me burime të rrezatimit jonizues”.

Përgatitja e kthimit të përgjigjeve të ankesave/shkresave të ardhura pranë ZMR-së, në lidhje me rrezatimet jonizuese bazuar në: ligjin “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese” nr. 8025 datë 9.11.1995, i ndryshuar. Arkiva e aprovimeve të import-eksportit dhe transportit për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues. Përgatitje e raportit vjetor.

8. Përgjegjësitë e procesit të inventarizimit, inspektimit dhe arkiva për subjektet që kanë në përdorim burime të rrezatimit jonizues, puna në grup, dhe rritja e nivelit profesional. Ligji nr 10433 datë 16.6.2011 “Për inspektim në Republikën e Shqipërisë”. VKM-së nr 696, datë 16.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror”, ku jam pjesë e grupit të inspektimeve në subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues.

Përgjegjëse për marrjen në dorëzim të dosjeve të subjekteve, të cilët aplikojnë për licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, pasi dosja siglohet nga shefi, bëj shpërndarjen e tyre tek inspektorët e ZMR-së.

Inventarin e dosjeve të subjekteve të cilat kanë në përdorim burime të rrezatimit jonizues.

Arkiva e aprovimeve të import-eksportit dhe transportit për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues. Në fund të çdo viti me procesverbal merren në dorëzim nga personi përgjegjës dhe arkivohen në ZMR. Korrespondenca me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor dhe Inspektoratin Qendror. Dërgimi i informacionit në lidhje me subjektet të cilat ushtrojnë aktivitetin për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Përgatitja e folderit me vlerësimin jonizues dhe tabelat përmbledhëse, informacioni sqarues për mbledhjen e KMR-së për subjektet që janë në përputhje, dhe ato që nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në zbatim të Urdhrit nr.34, datë 19.2.2019, pika 4 për subjektet të cilat kanë aplikuar për pajisjen me licencë për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues, 2-3 ditë pas zbardhjes së mbledhjes së KMR-së bëhet lajmërimi i subjekteve për të kryer procedurat e marrjes së licencës.

Dozimetria personale. Ndjekja e procedurave me IFBZ dhe ISHP-në për kryerjen e kontrollit dozimetrik personal të stafit të ZMR-së, inventarizimi i tyre.

Inventari i pajisjeve të cilat përdoren në inspektimin e subjekteve që kanë në përdorim burime të rrezatimit jonizues, dhe mbajtja e tyre në gatishmëri në punë.

Në zbatim të Urdhrit nr. 8, datë 10.12.2009, jam përgjegjës për protokollimin e shkresave hyrëse dhe dalëse në ZMR dhe vulën e ZMR-së. Inventari i librave dhe Cd në ZMR.

Rregullore nr. 865 protokolluar datë 28.2.2008 “Për Administrimin dhe Menaxhimin e Zyrës për Mbrojtjen nga Rrezatimet” në lidhje me zhvillimin e mbledhjeve të zhvilluara në ZMR, mbahet protokoll me detyrat e problematikës.

Neni 26

ZYRA E SISTEMIT KOMBËTAR TË TË DHËNAVE PËR DROGËN

Zyra e sistemit kombëtar të të dhënave për drogën (ZSKD) funksionon në përbërje të Institutit të Shëndetit Publik dhe është në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit të ISHP-së. ZSKD-ja është partneri zyrtar në vendin tonë për Qendrën Europiane mbi Drogat dhe të Varësisë nga Drogat (European Monitoring Center for Drugs and Drug Addiction).

Zyra e Sistemit Kombëtar të të Dhënave për Drogën ka si detyrë:

- ZSKD-ja mbledh informacione në fushën e drogës, të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr.8750 "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope", si dhe të dhëna të tjera sipas tabelave standarde të EMCDDA-së.
- ZSKD-ja është përgjegjëse për plotësimin dhe dërgimin në kohë të pyetësorëve në fushën e drogës që dërgohen për plotësim nga institucionet ndërkombëtare, si: UNODC, INCB etj., duke informuar edhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.
- ZSKD-ja çdo vit harton raportin vjetor mbi drogat në vendin tonë, i cili i vihet në dispozicion Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të Luftës Kundër Drogave në Shqipëri, Këshillit të Ministrave dhe Ministrive të linjës, si dhe institucioneve të tjera qeveritare dhe civile që janë drejtpërdrejt të përfshira në luftën kundër drogave në vend.
- ZSKD-ja nuk mbledh informacione që përmbajnë të dhëna personale.
- ZSKD-ja u dërgon të gjitha institucioneve shtetërore dhe civile, llojin dhe formatin e informacionit që kërkohet.
- ZSKD-ja përfshihet në konsultimin, hartimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave që kanë të bëjnë me sistemin e monitorimit të hershëm të substancave të reja psikotrope në vend.
- ZSKD-ja përfshihet në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës ndaj Drogave në vend.
- ZSKD-ja kryen studime në lidhje me përdorimin e drogave në vend, si dhe vlerëson efikasitetin e ndërhyrjeve parandaluese dhe trajtuese për problemet që lidhen me përdorimin e drogave në popullatë.
- ZSKD-ja bashkëpunon me institucione vendore dhe të huaja partnere në fushën e drogave.

KREU V: ADMINISTRATA E ISHP

Neni 27

DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Spektori i Administratës

Spektori i Burimeve Njerëzore

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse administrohet dhe menaxhohet nga Drejtori i Drejtorisë.

Drejtori organizon, drejton dhe përgjigjet për realizimin dhe mbarëvajtjen e punës brenda institucionit dhe ka këto detyra:

Siguron që protokollimi dhe arkivimi i dokumenteve, është kryer në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi.

Vëzhgëson dhe organizon procesin e analizës së punës, si dhe hartimin e përshkrimeve të punës.

Vëzhgëson dhe përgjigjet për shpërndarjen e sasive të karburantit për çdo automjet në përputhje të plotë me urdhërshërbimet dhe programin e punës së miratuar nga Drejtori i ISHP-së.

Studion dhe propozon rrugë e masa për përmirësimin e mjediseve të punës në ISHP, me qëllim që të sigurohen standardet bashkëkohore.

Merr masa për të siguruar mbrojtje sa më efektive për institucionin kundër zjarrit, sipas dispozitave në fuqi.

Organizon punën, merr masa dhe ndërton një sistem mbrojtës për ruajtjen e shëndetit të punonjësve.

Organizon punën dhe përgjigjet për të siguruar dhe kompletuar të gjitha zyrat me pajisjet, inventarin dhe kancelaritë e domosdoshme për nevojat pune, sipas kërkesave të bëra.

Siguron që burimet në dispozicion të drejtorisë të organizohen në mënyrë që objektivat e saj të realizohen me efektshmëri të lartë, tërësisht të rregullt dhe korrekte.

Drejtori i ISHP-së i delegon dhe detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit.

27.1. Sektori i Administratës

Sektori i Administratës varet nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe përgjigjet para tij, si dhe ndihet nga Shefi i Sektorit.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës sektori

Mbikëqyr ruajtjen e godinës së institucionit me shërbim roje 24 orë duke bashkërenduar punën me policinë e objekteve.

Organizon, kontrollon dhe përgjigjet për të siguruar pastërti shembullore dhe mjedis të kulturuar në institucion.

Organizon punën dhe përgjigjet për të siguruar gatishmërinë dhe funksionin normal të mjeteve të transportit. Organizon punën dhe përgjigjet për lëvizjen e automjeteve të institucionit vetëm për qëllime pune. Për këtë, siguron dhe përgjigjet për shpërndarjen e sasive të karburantit për çdo automjet në përputhje të plotë me urdhërshërbimet dhe programin e punës të miratuar nga Drejtori i ISHP-së.

Organizon punën dhe përgjigjet për të siguruar dhe kompletuar të gjitha zyrat me pajisjet, inventarin dhe kancelaritë e domosdoshme për nevojat pune, sipas kërkesave të bëra dhe urdhrave e prokurimeve të dhëna nga Drejtori i ISHP-së.

Merr masa për të siguruar mbrojtje sa më efektive për institucionin kundër zjarrit, sipas dispozitave në fuqi.

Organizon punën, merr masa dhe ndërton një sistem mbrojtës për ruajtjen e shëndetit të punonjësve. Merr masa rigoroze për të siguruar në shkallën më të lartë ruajtjen e të gjitha materialeve biologjike, toksike, radioaktive, të cilësuar tepër të rrezikshme për shëndetin e punonjësve, si dhe mospërhapjen e tyre jashtë institucionit. Informon sistematikisht me shkrim Drejtorin e ISHP-së për punën e kryer dhe detyrat që dalin.

Evidenton problemet që dalin nga veprimtaria e përditshme, si dhe problematikat e dala nga punonjësit e administratës, qytetarët, institucionet bashkëpunuese, si dhe grupet e interesit duke përcaktuar zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe t'ia propozojë këto Drejtorit.

Shpërndan dhe organizon punën në sektor sipas planit të përcaktuar/miratuar. Mbikëqyr dhe ndjek punën për gatishmëri teknike të pajisjeve elektronike dhe të automjeteve, nëpërmjet vendosjes së statusit të raportimit apo kërkesës për informacion.

Evidenton dhe koordinohet me strukturat/pozicionet përkatëse për plotësimin e nevojave të punonjësve për shërbime/pajisje të ndryshme pune, sipas procedurave standarde të punës (politika, procedura dhe rregulla) të vendosura nga eprorët/institucioni.

Përshkrimi i punës: Specialist

Të kryejë me përpikëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprorët e tij.

Të japë përgjigje ligjore dhe teknike për problemet specifike që mbulon sipas detyrave që i ngarkohen brenda sektorit, si dhe të përgatisë propozime lidhur me trajtimin e çështjeve të ndryshme me karakter profesional dhe teknik, sipas fushave që mbulon sektori.

Të ndjekë korrespondencën që i është dhënë për trajtim, duke respektuar rigorozisht afatet e përcaktuara. Të përgatisë materialin dhe pasi ta siglojë, ia paraqet përgjegjësit të sektorit dhe drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Të punojë në vazhdimësi për rritjen e aftësive vetjake tekniko-profesionale dhe të marrë pjesë në veprimtari trajnuese për këtë qëllim, në funksion të plotësimit sa më të mirë të detyrës së ngarkuar.

Të njohë legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë atë që lidhet me punën sipas specifikës së fushës që mbulon.

27.2. Sektori i Burimeve Njerëzore

Sektori i Burimeve Njerëzore varet nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtori i ISHP-së, përgjigjet për të gjitha problemet që lidhen me personelin e ISHP-së.

Sektori i Burimeve Njerëzore organizon, drejton dhe përgjigjet për realizimin dhe mbarëvajtjen e punës brenda institucionit dhe ka këto detyra:

- Klasifikimin dhe përshkrimet e punës;

- Procesin e rekrutimit;
- Vlerësimin e stafit, rezultatet dhe motivimin të cilat janë në thelb të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Procedurat për masat disiplinore;
- Procedurat e ristrukturimit të strukturës së ISHP-së

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Mban përgjegjësi për sistemimin dhe drejtimin e personelit, bën identifikimin e nevojave për personelin apo personelin e tepërt, rekrutimin, risistemimin e personelit në përputhje me legjislacionin, trajnimin e fillestarëve dhe atë të punonjësve të tjerë, ecurinë profesionale, motivimin e punonjësve dhe pagat, organizimin e strukturave, studion në ç' mënyrë dhe në ç' masë mund të përmirësohen strukturat organizative dhe funksionale duke i bërë ato sa më të thjeshta, të efektshme dhe eficiente.

Ka marrëdhënie ekuivalente e bashkëpunimi me të gjithë Shefat e Departamenteve Shkencore dhe të sektorëve të tjerë të ISHP-së, ndërsa për problemet e sistemimit dhe të menaxhimit të personelit, të departamenteve dhe sektorëve, ato janë në vartësi të Drejtorit të ISHP-së, i cili ia kalon për veprime të mëtejshme Përgjegjësit të Zyrës së Burimeve Njerëzore.

Ka përgjegjësi direkte për mbajtjen e gjithë dokumentacionit: -Libreza pune, -Kontrata pune, -Regjistër themeltar i punonjësve, -Dosje individuale për gjithë punonjësit e ISHP-së.

Përgatit projektin e organigramës, strukturat organizative duke u bazuar në misionin e përgjithshëm të ISHP-së.

Merr pjesë në hartimin e politikës shëndetësore në ISHP, zbërthen dhe ndjek zbatimin përcaktuar nga kjo politikë në fushën e personelit, drejton, planifikon trajnimet dhe ndjek ecurinë e punës së tyre.

Merr pjesë në planifikimin e përgatitjes dhe trajnimit të punonjësve të rinj.

Mbulon problemet e personelit të stafit të Institutit në përgjithësi, drejton dhe ndjek procedurat e menjhëjshme të kuadrit drejtues, kryen veprimet përkatëse për lëvizjet, transferimet, emërtimin e personelit dhe masat administrative etj.

Përgjegjësi për mbarrëvajtjen e të gjitha punëve brenda sektorit që mbulon dhe duhet të njohi mirë dhe dua bëjë të njohura rregullat e etikës punonjësve të tjerë dhe në mënyrë periodike të kontrollojë respektimin e tyre.

Shqyrton ankesat për shkelje të etikës dhe merr masa për mënjanimin e tyre. Kontrollon periodikisht zbatimin e rregullave të etikës në përgjithësi. Merr masa për pajisjen e të gjithë punonjësve me kartën e identifikimit të institucionit dhe kontrollon e përgjigjet që të gjithë punonjësit të zbatojnë rregulloren e brendshme për hyrje - daljet dhe lëvizjet brenda institucionit etj.

Përshkrimi i punës: Specialist

Specialisti i Sektorit të Burimeve Njerëzore është në varësi të drejtpërdrejtë nga përgjegjësi i Sektorit.

Specialisti kryen të gjitha veprimtaritë, sipas ndarjes së punës dhe pas marrjes së miratimit të Përgjegjësit të Sektorit.

Specialisti i Sektorit të Burimeve Njerëzore është përgjegjës për ruajtjen e dokumentacionit personal të punonjësve të ISHP-së.

Specialisti ruan kontakte të vazhdueshme me personelin e ISHP-së.

Kërkon dokumentacionin e plotë e të rregullt mbi të dhënat biografike, të kualifikimit të mëtijshëm të personelit të ISHP-së, duke i ruajtur në dosjet personale.

Grumbullon, verifikon formularët e vlerësimit të performancës duke i vendosur në dosjet përkatëse.

Ndjek afatet sipas urdhrave të komandimit për punonjësit, ose urdhra të tjerë dhe njofton eprorin në rastet e mbarimit të këtyre afateve.

Harton materiale në formë tabele për të gjithë punonjësit e institucionit, si dhe pasqyron ndryshimet në mënyrë periodike.

Plotëson kontratat individuale të punës. Punon për krijimin, unifikimin, standardizimin e dokumentacionit të sektorit të personelit. Plotëson dosjen e personelit me gjithë elementët e saj të nevojshëm. Nxjerr të metat dhe mangësitë e çdo dosjeje.

Kontrollon formalisht dhe logjikisht dokumentet që dorëzojnë fillimisht dhe periodikisht punonjësit e stafit të ISHP-së. Plotëson fletinventarin e dosjeve të personelit.

Përgjigjet dhe jep llogari periodike dhe rast pas rasti, për të gjitha çështjet e ngarkuara nga Përgjegjësi i Sektorit.

Përbush detyrat e tij funksionale brenda afateve të përcaktuara nga eprori i tij i drejtpërdrejtë.

Nuk mund të largohet nga detyra pa marrë leje apo miratim paraprak nga Përgjegjësi i Sektorit.

Neni 28

DREJTORIA E FINANCVE

Drejtoria e Financave:

Spektori i Buxhetit dhe Financës

Spektori i Prokurimeve dhe Çështjeve Juridike

Drejtoria e Financave administrohet dhe menaxhohet nga Drejtori i Drejtorisë.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës ka këto detyra:

Është përgjegjës dhe raporton para Drejtorit të Përgjithshëm për të gjithë veprimtarinë ekonomiko-financiare të Drejtorisë.

Harton dokumentin përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendon punën me të gjithë njësitë e ISHP-së (shëfat e departamenteve dhe sektorëve) gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit, në afate të caktuara, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ndjek zbatimin e detyrave dhe urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm dhe raporton për plotësimin e tyre.

Ndjek dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm, për realizimin e treguesve ekonomik-financiar sipas planit, në përputhje me ligjin organik të buxhetit. Ndjek realizimin e tij si dhe përdorimin e tyre.

Ndjek mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Financave.

Sistemi i kompjuterizuar i thesarit mund të përdoret për kontabilizimin dhe raportimin e transaksioneve financiare të njësisë publike, bazuar në kriteret e vendosura nga Ministria e Financave.

Mbi bazën e kontratave të lidhura, i ndjek ato deri në përfundim duke zgjidhur edhe çdo mosmarrëveshje sipas kushteve të kontratës.

Kërkon për zbatimin e rregullave gjatë marrjes në dorëzim dhe administrimit të mallrave.

Organizon punën për trajnimin dhe rritjen e nivelit profesional të punonjësve të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës.

Ndjek e pasqyron procedurat juridike për debitorët e kreditorët në bashkëpunim me Drejtoritë, Sektorin Juridik.

28.1. Sektori i Buxhetit dhe Financës

Sektori i Buxhetit dhe Financës administrohet nga Drejtori i Drejtorisë së Financave si dhe menaxhohet nga Përgjegjësi i Sektorit.

Sektori i Buxhetit dhe Financës organizon, drejton dhe përgjigjet për realizimin dhe mbarëvajtjen e punës brenda institucionit dhe ka këto detyra:

Të drejtojë, koordinojë dhe ndjekë veprimtarinë ekonomiko-financiare të ISHP-së në përputhje me ligjet në fuqi.

Të ruajë me rigorozitet të gjithë informacionet ekonomike të projekteve të ndryshme kërkimore e shkencore.

Të bëjë vlerësimin financiar të programeve të ndryshme kërkimore e shkencore apo iniciativave operative.

Të përgatisë nën drejtimin dhe në bashkëpunim me Zëvendëstitullarin Ekonomik planet financiare për programe të rëndësishme që mbulon dhe ndjek ISHP-ja.

Të përfaqësojë në mënyrë dinjitoze dhe profesionale ISHP-në në marrëdhëniet me institucionet vendase apo të huaja për problemet ekonomike dhe financiare.

Të raportojë tek Zëvendëstitullari Ekonomik situatat financiare.

Drejtori i ISHP-së i delegon dhe detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Koordinon punën në sektorin e financës për të përmbushur të gjitha detyrat e ngarkuara nga titullarët, në funksion të realizimit të objektivave të ISHP-së.

Mbanë dhe koordinonë zbatimin e legjislacionit financiar për kontabilitetin për regjistrimet në librat kontabël (në programin financiar Financ 5) deri në përgatitjen e Pasqyrave Financiare.

Regjistrimi i shpenzimeve dhe të ardhurave në ditarët përkatës (ditar i veprimeve ndërmodulare) të programit financës dhe kontrolli dhe rakordimi i tyre çdo muaj sipas ditarëve.

Mbyllja e pasqyrave financiare vjetore (bilanci) për aktivitetin ekonomik të ISHP-së në përputhje me legjislacionin në fuqi. Paraqitja dhe mbrojtja e tyre pranë MSHMS dhe Degës së Thesarit. Përgatitja e të gjitha statistikave që dërgohen në MSHMS, Degës së Thesarit dhe INSTAT në mënyrë periodike.

Pjesëmarrja në hartimin e Projektbuxhetit sipas legjislacionit në fuqi dhe kryesisht për fondin e pagave, sigurimeve shoqërore, të ardhurat dytësore, si dhe dhënia e informacionit të nevojshëm për plotësimin e pasqyrave të tjera të projektbuxhetit.

Kontrolli i dokumentacionit shoqëruar për kryerjen e pagesave sipas furnitorëve dhe kontratave.

Përshkrimi i punës: Specialist

Përgatitja e dokumentacionit financiar dhe kalimi në Degën e Thesarit i urdhërshpenzimeve.

Mbajtja dhe regjistrimi i shpenzimeve sipas llogarive analitike të strukturës buxhetore.

Ndjekja e llogarive analitike e debitorëve dhe kreditorëve.

Mbajtja, regjistrimi dhe inventarizimi i aktiveve të qëndrueshme të ISHP-së.

Nxjerrja e çmimit të vaksinave dhe mbajtja e procesverbalit përkatës me komisionin e marrjes në dorëzim.

Nxjerrja e çmimit të kontraktivëve dhe mbajtja e procesverbaleve përkatës.

Përgatitja e procesverbaleve të marrjes në dorëzim të materialeve të dhuruara nga donatorë të ndryshëm në favor të Institutit të Shëndetit Publik.

Mbyllja e llogarive vjetore që shërbejnë në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe dorëzimi te përgjegjësja e Sektorit të Financës.

Kryerja e çdo detyre tjetër shtesë që ngarkohet nga Titullarët.

Përshkrimi i punës: Specialist

Përllogaritja e pagave të punonjësve të Institutit Shëndetit Publik në zbatim të legjislacionit përkatës dhe urdhrave të nxjerrja nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Titullari.

Regjistrimi dhe deklarimi online i Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe të ardhurat nga punësimi sipas listëpagesave për çdo muaj.

Regjistrimi dhe Deklarimi për punonjësit e rinj dhe punonjësit e larguar tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në sistemin online të tatimeve.

Përllogaritja e raporteve të punonjësve të Institutit Shëndetit Publik, raporteve të zgjatura të invaliditetit dhe lejelindjesh, si dhe dorëzimin në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

Përgatitje vërtetim page (mujore & vjetore) sipas kërkesave të punonjësve drejtuar sektorit të Burimeve Njerëzore. Plotësimin e librezave të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Përllogaritja e dietave të punonjësve të ISHP-së dhe projekteve, përgatitja e përmbledhësve dhe listat sipas bankave, sistemimi dhe lidhja e tyre.

Dorëzimin e dokumenteve në Degën e Thesarit dhe shpërndarja e listave të dietave dhe pagave nëpër bankat përkatëse (BKT, RFZ, CREDINS) për pagesat që kryen sektori i Financës. Të kryej çdo detyrë tjetër shtesë që i ngarkohet nga Përgjegjësi i Sektorit dhe Titullari.

Marrja pjesë në komisionet e inventarizimit në fund të vitit në magazinë dhe përgatitja e relacionit për titullarin.

Regjistrimi i të Ardhurave Dytësore në sistemin e Financë 5 në modulën bankë e të ardhurave, si dhe kuadrimi i të ardhurave dytësore me Degën e Thesarit në mënyrë periodike çdo muaj (sistemimi dhe lidhja e tyre).

Përshkrimi i punës: Specialist

Kontrolli i dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik që operojnë me ISHP-në për furnizimin me materiale konsumi, kite dhe reagente, si dhe verifikimi i mallrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara në sasi, cilësi dhe çmim.

Kontrolli aritmetikor i fletëhyrjeve dhe hartimi i procesverbaleve përkatës. Marrja në dorëzim, sistemimi dhe mirëmbajtja e mallrave në magazinat përkatëse.

Mbajtja dhe regjistrimi i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve në mënyrë analitike në librat e magazinës, si dhe sistemi dhe firmosja e dokumenteve përkatës për çdo muaj.

Kontrolli i dokumenteve autorizues, urdhrave të dorëzimit dhe planshpërndarjeve. Mbajtja dhe regjistrimi i primeve financiare për magazinën e Konsumit në sistem, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Nxjerrja e të dhënave dhe kuadrimi për çdo muaj për magazinën e Konsumit, firmosja e dokumenteve përkatës, kryerja e inventarit vjetor.

28.2. Sektori i Prokurimeve dhe Çështjeve Juridike

Sektori i Prokurimeve dhe Çështjeve Juridike administrohet nga Drejtori i Drejtorisë së Financave, si dhe menaxhohet nga Përgjegjësi i Sektorit.

Sektori i Prokurimeve dhe Çështjeve Juridike në përbërje ka Përgjegjësin e Sektorit dhe Specialistët, të cilët ushtrojnë funksionin e tyre në zbatim të legjislacionit dhe akteve nënligjore lidhur me procedurat e prokurimit bazuar në Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik", VKM-në nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik. Bazuar në legjislacionin e mësipërm, sektori i prokurimeve dhe specialistët e tij kanë detyrimin të iniciojnë dhe të kryejnë procedurat e prokurimit për llogari të Autoritetit Kontraktor, duke përmbushur nevojat e këtij të fundit për punë, mallra, shërbime, të cilat janë të nevojshme për mbarëvajtjen normale të punës në institucion.

Përshkrimi i punës: Përgjegjës Sektori

Menaxhimi dhe mbikëqyrja e procesit për zhvillimin e procedurave të prokurimit për punë, mallra dhe shërbime që i nevojiten strukturave të Institutit të Shëndetit Publik sipas legjislacionit të prokurimit Publik. Hartimi dhe administrimi i procesverbaleve e procedurave të prokurimit, duke krijuar dosje të posaçme për secilin prej tyre dhe duke kontrolluar respektimin e legjislacionit në fuqi.

Mbledhja dhe administrimi i të gjithë dokumentacionit që lidhet me zhvillimin e procedurës deri në përcaktimin e fituesit, duke përfshirë dhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti.

Organizimi i punës për marrëdhëniet kontraktuale me operatorët ekonomikë dhe kontrollin e përmbushjes efektive të kushteve të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse.

Hartimi i raporteve periodike, ose sipas kërkesës, për APP-në mbi respektimin e procedurës dhe ecurinë e kontratave.

Koordinimi dhe mbikëqyrja e aktivitetit të sektorit për zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, për zbatimin e rregullave të prokurimit Publik.

Këshillon drejtoritë përkatëse të ISHP-së për çështjet juridike dhe administrative sipas kërkesave.

Administron kërkesa/ankesa në bashkëpunim me Drejtoritë Teknike të ardhura pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe kthen përgjigje brenda afateve të caktuara ligjore.

Përgjegjësi i Sektorit i realizon objektivat e pozicionit të tij të punës në kushte të përshtatshme dhe optimale, të cilat garantojnë produktivitetin dhe realizimin e qëllimit të tij institucional. Kur është e domosdoshme mund t'i kërkojë jashtë orarit zyrtar për realizimin e detyrave urgjente.

Shpërndan punën mes specialistëve të Sektorit në përputhje me legjislacionin dhe rregulloren e brendshme të institucionit. Qartëson stafin në varësi të tij për objektivat dhe detyrat e secilit, dhe organizon punën me qëllim realizimin në kohë, cilësi dhe sasi të objektivave të miratuara nga Drejtoria.

Përshkrimi i punës: Specialist

Garanton realizimin e procesit të prokurimeve dhe përfaqëson Insitutin e Shëndetit Publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Organizimi i punës për menaxhimin e procesit të prokurimit të mallrave, shërbimeve, punëve, si dhe ndjekjen e tyre në përputhje me kuadrin ligjor.

Organizimi i punës për marrëdhëniet kontraktuale me operatorët ekonomikë dhe kontrollin e përmirësimeve efektive të kushteve të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë.

1.Përgatit regjistrin e parashikimit dhe regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit Publik.

2.Në bashkëpunim me njësitë e tjera harton kushtet kryesore teknike të thirrjes së tenderave.

3.Merret me procedurat e prokurimit.

4.Organizon procesin e shqyrtimit dhe analizimit të ofertave.

5.Harton kriteret ligjore të kontratës përfundimtare.

6.Komunikon me fituesin e tenderit dhe monitoron realizimin e kontratës, përcjelljen pranë APP-së, të planit të zbatimit të kontratës, në rastet kur kërkohet, si dhe të raportimit përfundimtar të ekzekutimit të kontratës dhe të gjitha detyrat e tjera në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik" i ndryshuar.

Të përfaqësojë ISHP-në duke mbrojtur interesat e institucionit në çështjet gjyqësore dhe procedurat administrative ku është palë ndërgjyqëse në proces.

Formulon sugjerime për ndryshime apo përmirësime të akteve apo projektakteve dhe ia paraqet ato Përgjegjësit të Sektorit. Formulon raporte periodike ose mbi bazë kërkesë për Përgjegjësin e Sektorit. Jep informacione për çështje të ndryshme që mbulon mbi bazë kërkesë.

Drejtori i ISHP-së i urdhëron dhe cakton detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit, detyra të cilat duhet të realizohen me përgjegjshmëri.

Kushtet e punës të tjera

Përgjegjësit dhe specialistit të Sektorit të prokurimeve dhe Çështjeve Juridike, mund t'u kërkohej të punojnë jashtë orarit zyrtar të punës, në raste kur parashikohet se detyrat e caktuara nuk mund të realizohen brenda afatit.

Bazuar në nevojat e Sektorit dhe të Drejtorisë, specialistit mund t'i kërkohej që në çdo moment kur vlerësohet e domosdoshme nga eprori direkt apo më lart, të zbatojë përgjegjësitë kryesore dhe të përmbushë detyrat e caktuara ndaj një specialisti tjetër i sektorit të tij/saj ose sektorëve të tjerë paralelë, dhe/ose të bashkëpunojë me të në kryerjen e detyrave të caktuara, dhe të ndjekë çdo urdhër të brendshëm të titullarit, sipas legjislacioneve në fuqi.

Monitoron punën e sektorit dhe realizon vlerësimet periodike të stafit në varësi për të identifikuar nevojat për përmirësim. Përgjigjet për disiplinën në punë dhe respektimin e Kodit të Etikës në strukturën që drejton dhe ndërmerr veprimet e nevojshme në bazë të legjislacionit në fuqi.

Drejtori i ISHP-së urdhëron dhe cakton detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit, detyra të cilat duhet të realizohen me përgjegjshmëri.